

Pikë e përbashkët me Shqipërinë, Kosova duhet të presë

Fq.4



S'më lanë të marthohem me italian, Blerta arsyeton vrasjen e prindërve

Fq.5



Sport
Fillimi i fundit i Murinjos?

Fq.22



Koha

www.koha.mk

Gara për një copë byrek

Fq.15

E PËRDITSHME INFORMATIVE

Viti XII · Numri 3452 · e mërkurë, 5 shtator 2018

15°C | 24°C

15 DEN

EDITORIAL

"Semaforët" e mendimit politik



Opozita është pushteti moral i një shoqërie, kurse mendimi ndryshe është 'semafori' që e bën qarkullimin e ideve të ketë dinamikën e tyre të lëvizjes. Te ne ka shumë qarkullim, por 'semaforët' zakonisht qëllon ose të jenë 'në kontroll te mjeshtri', ose të mbajnë gabimisht gjatë gjithë kohës të kuqen ndezur. Në raste të tilla, pjesëmarrësit e ndërgjegjshëm në trafik e rregullojnë vetë...

Fq.2

FORUM

Beteja e Idlibit, masakër mbi katastrofën 7-vjeçare në Siri

Fq.11

RAJON

Marrëveshja për kufirin deri në fund të vitit

Fq.14



JEHONË VENDORE DHE VËMENDJE NDËRKOMBËTARE REFERENDUMIT

TRESHJA QË BETONON REFERENDUMIN



Vizita e kancelares Merkel dhe sidomos e kancelarit Kurz pritet të ketë efektin pozitiv në drejtim të ndikimit mbi VMRO-në opozitare, e cila aktualisht përmes marsheve protestuese po e kundërshton Marrëveshjen për emrin me Greqinë. Kjo, pasi në vitet e para të pushtetit të VMRO-së, kancelarja Gjermane ishte një mbështetëse e sinqertë e Qeverisë Gruevski në politikat e saj ekonomike dhe në Asamblenë Parlamentare të Këshillit të Evropës

Fq.3

Fëmijët lypsarë edhe sivjet jashtë mësimin!

Shkup, 3 shtator - Verë ose dimër, ditë jave e shkollës ose jo... këta fëmijë të mitur dhe shumë të tjerë moshatarë të tyre mund të shihen çdokund nëpër udhëkryqe apo kafene të qytetit duke shitur gjësende të ndryshme. Nëpër rrugë mund të shohim edhe foshnje dhe fëmijë nën moshën 6-vjeç, të cilët ecin gjysmë të zhveshur dhe të zbatshur. Edhe pse Ministria e Punës dhe Politikës Sociale (MPPS) nuk dispo-

non me shifër konkrete për numrin e fëmijëve në rrugë, supozohet se janë diku mbi 600 të tillë në nivel republikan, pjesa më e madhe në Shkup, Manastir, Prilep, Tetovë... kurse gjatë verës edhe në Strugë dhe Ohër. A dëshmojnë këta fëmijë për varfërinë e madhe në shtet, si dhe për lëshimet që i kanë bërë organet dhe institucionet kompetente që me vite të tëra nuk arrijnë të zgjidhin...

Fq.7



EDITORIAL

“SEMAFORËT” E MENDIMIT POLITIK



Emin AZEMI

Opozita është pushteti moral i një shoqërie, kurse mendimi ndryshe është ‘semafori’ që e bën qarkullimin e ideve të ketë dinamikën e tyre të lëvizjes. Te ne ka shumë qarkullim, por ‘semaforët’ zakonisht qëllon ose të jenë ‘në kontroll te mjeshtri’, ose të mbajnë gabimisht gjatë gjithë kohës të kuqen ndezur. Në raste të tilla, pjesëmarrësit e ndërjegjshëm në trafik e rregullojnë vetë qarkullimin. Kjo, për fat të keq te ne nuk ndodhë. Kultura e komunikimit politik me opozitën, është vetë thelbi i një demokracie. Opozita ka të drejtë edhe të gabojë në artikullimin e ideve politike, por pushteti nuk guxon të sillet me arrogancë dhe më së paku të injorojë zërat kritik në shoqëri. Një politikë është parimore vetëm atëherë kur toleron kritikën konstruktive, kurse pushtetarët gjithmonë janë treguar vizionarë atëherë kur e kanë projektuar pozitën e tyre si opozitarë të ardhshëm, që duhet ti shërbejnë me nder e respekt shoqërisë që i takojnë.

Kryeministri famëkeq jugosllav, Nikolla Pashiq, pasi i kishte urdhëruar ekspertët e partisë së tij në pushtet të hartojnë një draft ligj, ua kishte refuzuar me arsyetimin se fryma e ligjit nuk përmbante kritikë opozitare. Bashkëpartiakët të befasuara e kishin pyetur shefin e tyre se pse duhet të ketë patjetër frymë opozitare ligji, kur ata veç më ishin në pushtet. ‘Duhet të mendojmë kohën kur do të kthehemi në opozitë’, ishte përgjigjur politikani dinak serb, duke ua bërë me dije të vetëve se pushteti nuk është i amshueshëm dhe vjen një ditë që duhet të shkohet në opozitë, por me dinjitet.

Në shoqëritë postokomuniste, ku bën pjesë edhe kjo e jona, këto rregulla jo se janë të panjohura për politikanët, por praktika ka dëshmuar se të qenit në pushtet është përkthyer në njëfarë fuqie absolute të ndikimit publik, kurse të qenit opozitar është kuptuar apriori si kritikues frontal i të gjitha ideve e nismave që vinë nga pushteti. Rralë ndodhë te ne të votohet nga opozita ndonjë amendament i pu-

shtetit dhe anasjelltas, pushteti sipas një rregulli të pashkruar refuzon 99.9 për qind të amendamenteve të opozitës, ndonëse në radhët e të dy taborëve politike mund të ketë amendamente brilante që mund t’i shërbejnë për mrekulli interesit publik.

Ndoshta për faktin se as pushteti, as opozita, te ne nuk e luajnë rolin e tyre që iu takon, kjo edhe mund të jetë arsyeja që ‘enët komunikuese’ në relacionin pushtet-opozitë të kalojnë nëpër një ‘fushë të kontaminuar’ ku nuk përjashtohen devijime të natyrave të ndryshme për sa i përket pamundësisë së krijimit të një mendimi të konsoliduar publik.

Si ta kemi ne një qëndrim unik, bie fjala, rreth çështjes së referendumit, kur ende parapëlqejmë të luajmë vallen “njëri thumbit, tjetri patkoit”. Ato pak autoritete morale që janë brenda shoqërisë shqiptare, ose janë lodhur në rrugëtimin e tyre për të unifikuar mendimin dhe veprimin politik, ose nuk kanë arritur t’i kontekstualizojnë diskutet e tyre publike në rrafshin e politikave vendimmarrëse. Ndërkohë, skena politike e shqiptarëve i ngjan një rebusi me shumë enigma. Atje të pakënaqurit e paradites, i ke pushtetarë të pasdites, kurse opozitarizmi vjen në shprehje vetëm atëherë kur dështon ambicia për të qenë pjesë e pushtetit. Opozitarët e djeshëm, sot i ke çuna të shkapërderdhur nëpër livadhin e gjerë të kauzave, ndërkohë që i pari i Qeverisë si ujë i kërlëshur fut nën sqetull qengjin (opozitarin) e uritur për pushtet. Jo pak ‘zëra kritik’ në të kaluarën edhe pse mbanin ‘veladonin’ e ‘intelektualit të pavarur’ për një honorar në ndonjë bord, sa ora e kthenin gëzofin andej nga frynte interesi momental.

Por, rastet negative dhe devijime nuk duhet të merren për bazë kur duam të projektojmë një mendim të pjekur kritik, sepse të tillë ka pasur dhe do të ketë. Çështje e hapur mbetet si të shndërrohen në doktrinë këto mendime kritike të cilat hë për hë janë shumë aktive nëpër rrjete sociale dhe portale, por jo edhe në formë të një organizimi të mirëfilltë.

PATRIOTË SHQIPTARË ME ZJARR!

“Mitrovicë, sot herëet, e hënë 3 shtator 2018. Unë po frikësohem se në procesin e këmbimit territorial, Serbia më shumë do të na marrë se sa që do të na japë. A do të thotë kjo se jam pro serb dhe pro rus?!”

Unë po e shoh se Mitrovica është e ndarë fizikisht (ura e Ibriit e barrikaduar nga serbët) dhe ligjerisht (kemi dy komuna, Mitrovicën Jugore dhe Mitrovicën Veriore). Nuk ka erë të shtetit të Kosovës përtej urës së Ibriit, apo? A është kështu, apo nuk po mund e kuptoj realitetin, ashtu sikur nuk po arrij ta kuptoj mos padashur jam shndërruar në një serbo-rusofil dhe sytë e mi kanë marrë një dioptri tjetër që m’i turbullon pamjet?!

E tash, një gjë nuk po e kuptoj as nga perspektiva e patriotit dhe as nga ajo e tradhëtarit: (se ne shqiptarët që nga koha e xhaxhit Enver krejt spiu te dy, tre e katërfishtë jemi!!!) çfarë kuptojmë me zotimin e Kadri Veselit se Mitrovica nuk do të preket? Mitrovica është prekur, është ndarë dhe funksionon si e tillë tash e njëzet vite. Nëse ajo nuk do të preket për mua do të thotë se realiteti i krijuar prej njëzet vitesh nuk do të ndërrojë! A po e shihni edhe ju kështu si unë këtë çështje, apo edhe juve ju ka hëngër kafsha e zezë (si mua për shembull!) dhe jeni bërë serbo-rusofilë dhe tradhëtarë?! Pra, Mitrovica duhet të preket, sepse ajo duhet të bashkohet dhe jo të mbetet siç është, e ndarë! O patriotë shqiptarë, qofshi me zjarr, qofshi pa zjarr! A ka një marrveshje që nuk e legjitimon ndarjen?! Nëse ka dhe ju e arrini, atëherë na tregoni se si do ta arrini? Do me thënë se ne do ta marrim Preshevën, Medvegjen dhe Bujanvcin në këmbim të Zubin Potokut, Leposaviqit dhe Zveçanit (madje do t’i ruajmë edhe fshatrat e banuara me shqiptarë të këtyre tri komunave) dhe njëkohësisht do ta kthejmë Veriun e Mitrovicës?! Nëse ky është plani juaj na tregoni, që të mos ju mbesim kot në qafë! Por na tregoni se si do ta arrini këtë, me luftë a pa luftë? A keni një premtim nga administrata e Donald Trumpit, apo të paktën një mirëkuptim të Vladimir Putinut dhe Aleksandër Vuçiqit? Nëse e keni, na tregoni o burra që të tërhiqemi nga pozicionet tona “serbi-rusofilë”! Nëse në lojë është edhe Edi Rama dhe Erdogan, na e thoni efhe këtë! Të paktën të dimë se çfarë po ndodhë dhe ku e si do t’i lidhet nyja kësaj pune. A jeni ju ata që për pjesën më të madhe të pasluftës keni qenë dhe ende jeni në pushtet dhe megjithatë Mitrovica mbeti e ndarë? Njëzet vite nuk e gjetët çelësin e bashkimit, kurse tash për një moment e gjetët?! Ku kishte qenë? Kush ua dha? Por mos na thoni se projekti juaj konfirmon atë që “de facto dhe de jure” (shprehje e presidentit HTH) jemi duke e parë që njëzet vite, Mitrovicën e ndarë në Veriun serb dhe në Jugun shqiptar. Sepse, atëherë nuk e di kush çka është, patriot, dreq, a tradhëtar! Na tregoni që të punojmë të gjithë bashkë dhe të heqim dorë nga benefitet që mund të na jep apo premtun Rusia, Serbia e dreqi e i biri që nuk gjendet kundër tjetër pos ulur galuc në mendjet e sëmuara shqiptare!”, shkruan në profilin e tij në FB, shkrimtari nga Kosova, Liri Loshi.



MEDIA Citate

VLLASI E KËSHILLON VUÇIQIN TË MOS E IMITOJË MILLOSHEVIQIN

Askush në Kosovë nuk po i kushton rëndësi vizitës së presidentit të Serbisë, Aleksandar Vuçiq të paralajmëruar për në Zubin Potok, i ka thënë “Danasi” të Beogradit, Azem Vllasi, ish-politikan i Kosovës. Por ai ka shfaqur shpresën se fjalimi i Vuçiqit nuk do të jetë “imitimi i mitingjeve të çmendura të Millosheviqit, që u përplaseshin për kokë serbëve të Kosovës dhe atyre të Serbisë”.

Në Kosovë askush nuk është kundër dialogut për normalizimin e marrëdhënieve midis Serbisë e Kosovës, por janë kundër që në dialog të përfshihet çështja e rivizatimeve territoriale dhe ndryshimi i kufijve ekzistues, citon kjo gazetë Vllasin.

Duke komentuar shkrimin e igumenit të manastirit të Deçanit, Sava Janjiq, rreth ndarjes territoriale, Vllasi ka thënë se Janjiq e di që ndarja do të ishte mesazh për serbët në jug të Ibriit që të shpërngulen për në veri. Igumeni Sava do të duhej të mendojë për kishat, manastiret dhe për grigjën e tij dhe të mos përzihet në politikë dhe punë të shtetit. Ai ka të drejtë vetëm kur thotë se është kundër rivizatimeve territoriale, pavarësisht nga motivet, ka thënë Vllasi, transmeton Koha.net.

Siç është shprehur Azem Vllasi, në vazhdim dialogu duhet të përqendrohet në thelbin e çështjeve, që janë të drejtat njerëzore e etnike të serbëve në Kosovë, si dhe ato të shqiptarëve në Luginën e Preshevës. Ai konsideron se është e domosdoshme që Kosova dhe Serbia të njohin njëra tjetrën dhe vendosja e marrëdhënieve diplomatike, meqë dy shtete fqinje do të mund të merreshin vesh për korrigjime përkatëse të kufijve, por jo për zhvendosje të popullsisë në baza etnike dhe të nxitjes së tensioneve.

(Danas, 4 shtator)

NËSE NUK E KENI DITUR...

KUSH ISHTE HOLGER PEDERSEN?

Holger Pedersen (1867-1953) ishte gjuhëtar i shquar danez, indoevropianist me interesa shkencore të shumanshme, profesor në Universitetin e Kopenhagës, autor i një vargu veprash dhe studimesh me vlerë. I kushtoi vëmendje të veçantë gjuhës shqipe. Pedersen vizitoi Shqipërinë e Jugut më 1893 dhe për gjuhën shqipe ka botuar disa studime me vlerë, si “Kontribut

për historinë e gjuhës shqipe”, “Tingujt I të shqipes”, “Asnjëri i shqipes” etj. Me shumë interes është edhe vepra e tij “Tekste shqipe me fjalor”, ku janë botuar disa përralla dhe këngë popullore, të shoqëruara me shënime gjuhësore dhe me një fjalor. Pedersen i dha një rëndësi të veçantë studimit të zhvillimit historik të brendshëm të gjuhës shqipe.

Vizita e kancelares Merkel dhe sidomos e kancelarit Kurz pritet të ketë efektin pozitiv në drejtim të ndikimit mbi VMRO-në opozitare, e cila aktualisht përmes marsheve protestuese po e kundërshton Marrëveshjen për emrin me Greqinë. Kjo, pasi në vitet e para të pushtetit të VMRO-së, kancelarja Gjermane ishte një mbështetëse e sinqertë e Qeverisë Gruevski në politikën e saj ekonomike dhe në Asambleenë Parlamentare të Këshillit të Evropës

JEHONË VENDORE DHE VËMENDJE NDËRKOMBËTARE REFERENDUMIT

VJEN TRESHJA QË BETONON REFERENDUMIN



Kancelari Sebastian Kurz gjatë kohës sa ishte ministër i Punëve të Jashtme, njëhej si njëri ndër mbështetësit kryesor të ish-liderit të VMRO-së, Nikolla Gruevski sidomos gjatë Qeverisë teknike dhe implementimit të Marrëveshjes së Përzhinos

Koha Fatos RUSHITI

Shkup, 4 shtator - Njëzet e pesë ditë para mbajtjes së Referendumit, të gjitha ngjarjet dhe indikacionet çojnë drejt përfundimit me sukses të tij, më konkretisht ti thuhet "PO" Marrëveshjes për emrin me shtetin fqinj - Greqinë të lidhur muaj më parë mes qeverisë të të dyja vendeve. Brenda pak kohësh Shkupin priten ta vizitojë tre politikanë të rëndësishme, kancelarja gjermane Angela Merkel, kancelari austriak Sebastian Kurz, vendi i të cilit për këto gjashtë muaj udhëheq me Këshillin e Bashkimit Evropian, dhe Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg.

Vizita e kancelares Merkel dhe sidomos e kancelarit Kurz pritet të ketë efektin pozitiv në drejtim të ndikimit mbi VMRO-në opozitare, e cila aktualisht përmes marsheve protestuese po e kundërshton Marrëveshjen për emrin me Greqinë. Kjo, pasi në vitet e para të pushtetit të VMRO-së, kancelarja Gjermane ishte një mbështetëse e sinqertë e Qeverisë Gruevski në politikën e saj ekonomike dhe në Asambleenë Parlamentare të Këshillit të Evropës. Ndërkaq kancelari Sebastian Kurz gjatë kohës sa ishte ministër i Punëve të Jashtme, njëhej si njëri ndër mbështetësit kryesor të ish-liderit të VMRO-së, Nikolla Gruevski sidomos gjatë Qeverisë teknike dhe implementimit të Marrëveshjes së Përzhinos.

Ardhja e mergelit, Kurcit dhe Stoltenbergut pritet ti japë jehonë më të madhe kauzës pro Referendumit në vend dhe të merr vëmendje më të madhe në arenën ndërkombëtare. "Ajo që tre burrshtetas botëror këtë javë vijjnë në Maqedoni, është një sinjal pozitiv, mirënjohje dhe mbështetje për vendin tonë", tha kryeministri Zoran gjatë një tribune në qytetin e Berovës. "Të mërkurën vjen Stoltenberg për herë të dytë brenda

"POSHTËRIMI I KRISHTIT", FILM ME PRAPAVIJË POLITIKE

Kryeministri Zoran Zaev i pyetur për filmin "Tallja me Jezu Krishtin", deklaroi se ka kërkuar nga ministri i Kulturës dhe drejtori i Agjencisë për film t'i parandalojnë aktivitetet e tilla në të cilat promovohet gjuha e urrejtjes. "Nuk mund ta kthejmë kohën mbrapa, por i dhashë detyrë ministrit të Kulturës të bisedojë me drejtorin e

Agjencisë për film që t'i pengojnë dhe të gjejnë mënyrë ligjore për të gjitha aktivitetet e promovimit të veprave të tilla", theksoi Zaev, duke u përgjigjur në pyetje të gazetarëve në Qeveri. Ai shtoi se ajo që është financuar nga Agjencia për Film në vitin 2015 është absolutisht me prapavijë politike dhe i dënoi të gjitha porositë që përhapin gjuhë të urrejtjes.

gjashtë muajve, të premtën kancelari austriak Kurz, ndërsa të shtunën Merkel. Ata na shtrinë dorën që të ecim përpara", tha Zaevi. Sipas tij, opozita është e vetëdijshme se ky është momenti për BE-në dhe NATO-n, momenti kur të gjithë duhet të jemi së bashku për Maqedoninë Evropiane. Kryeministri Zoran Zaev, duke i komentuar dokumentet që i publikoi "Uikiliks" se që në vitin 2008 është pranuar emri "Republika e Maqedonisë së Veriut", deklaroi se kjo është edhe një arsye më shumë që të jemi tok dhe t'i sigurojmë ardhmëri të sigurt shtetit. "Besoj se dëshmitë e këtyra të cilat dalin në opinion do të jenë një arsye më

shumë që të jemi tok dhe t'i sigurojmë ardhmëri të mirë Maqedonisë", tha Zaev, duke u përgjigjur në pyetjen e gazetarëve pas nënshkrimit të sotëm të marrëveshjeve për mbështetje financiare për hapjen e biznes-akceleratorëve për të rinj. Shtoi se shumë qeveri janë përpjekur të gjejnë zgjidhje dhe se qeveria paraprake ka tentuar të gjejë zgjidhje dhe është mirë që tani është konfirmuar identiteti i Maqedonisë.

"E dini se i posedoja bisedat të cilat tani janë tek Prokuroria Speciale Publike. Shumë qeveri kanë tentuar të gjejnë zgjidhje edhe qeveria paraprake është përpjekur. Një pjesë e zgjidhjes në pjesën e

emrit dhe përdorimi i tij i përgjithshëm ose siç quhet 'erga omnes' është pranuar edhe në pjesën e Maqedonisë Veriore edhe në pjesën e Maqedonisë së Epërme dhe më vjen mirë që ne morëm konfirmim të identitetit tonë të përgjithshëm - gjuha maqedonase siç ishte pjesë e rëndësishme e vendosur në ekipin negociues", tha Zaev.

Ndryshe, Qeveria e Maqedonisë në vitin 2008 ka qenë e gatshme të pranojë emrin "Republika e Maqedonisë Veriore" apo "Republika e Maqedonisë së Veriut", përfshirë njohjen e gjuhës maqedonase dhe kombit, thuhet në një dokument të klasifikuar të ambasadës amerikane në Shkup, të publikuar nga

Uikiliks. Dokumenti i klasifikuar dhe i titulluar "Për çfarë kanë nevojë maqedonasit që ta zgjidhin çështjen e emrit", mban datën 29 korrik 2008. Në dokument, ambasadorja e atëhershme amerikane Xhulijen Milovanoviq shpreh konkluzionet e saj pas takimit me lidhshpimin në atë kohë, presidentin Branko Cërvenkovski dhe kryeministrin Nikolla Gruevski, duke thënë se kushtet janë të pranueshme për Maqedoninë, përfshirë siç citohet: "Emri Republika e Maqedonisë Veriore apo Republika e Maqedonisë së Veriut". Dokumentin e ka publikuar edhe e përditshmjia greke "Kathimerini". Në dokumentin e Ambasadës së SHBA-ve në Shkup që e publikoi "Uikiliks", thuhet se që në vitin 2008-të, Shkupi zyrtar ka dhënë pajtueshmëri për ndryshim të emrit "Republika e Maqedonisë së Veriut", me kusht që të pranohet identiteti dhe gjuha. Nga ana tjetër, kryetari i VMRO-së, Hristijan Mickoski, gjatë një takimi me Andriu Page, drejtorin e Drejtorisë për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë në Ministrinë për Punë të Jashtme të Britanisë së Madhe, tha se partia e tij në princip nuk mund ta mbështesë Marrëveshjen për emrin me Greqinë. "Në lidhje me gjendjen politike në Maqedoni, Mickoski e njoftoi Page për keqpërdorimin e shumta të pushtetit. Mickoski gjithashtu informoi bashkëbiseduesin se qëndrimi i VMRO-DPMNE-së për marrëveshjen me Greqinë ngelën i fortë dhe princip dhe se partia nuk mund të mbështesë përmbytjen e së njëjtës", thuhet në deklaratën e partisë për media.

MARRËVESHJA E PESPËS, SIMBOL I MIQËSISË SË POPUJVE

Marrëveshja e Pespës është me karakter historik, simbol i miqësisë së popujve dhe plotësisht e ndryshon pasqyrën e Ballkanit, thotë zëdhënësi i Qeverisë greke dhe ministër pa dikaster Dhimitris Xanakopulos në intervistë për radion greke "247". Duke u përgjigjur në pyetjen nëse Qeveria, për shkak të protestave të caktuara në Selanik dhe masivitetit eventual, do të mund që përsëri ta shqyrtojë Marrëveshjen, Xanakopulos thotë se Qeveria i respekton mospajtimet, reagimet, protestat, "por nuk ekziston kurrfarë mundësie, në kurrfarë rrethanash që t'i ndryshojë vendimet

tashmë të miratuara. "Mendoj se Marrëveshja me ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë është me karakter historik, simbol i miqësisë së popujve dhe për mënyrën në të cilën duhet të zgjidhen kontestet bilaterale dhe ndërkombëtare. Dhe mendoj se gjithnjë e më shumë njerëz, me kalimin e kohës, e kuptojnë veçantinë e Marrëveshjes", thotë Xanakopulos. Siç lajmëron korrespondentja e MIA-s nga Athina, zëdhënësi i Qeverisë greke dhe ministër pa dikaster, edhe një herë shfaqti bindje se Marrëveshja do të marrë shumicën e gjerë në Parlamentin grek.

Shqipëria do të jetë shteti i dytë me të cilin Maqedonia do të vendos kontrollin e përbashkët kufitar me një ndalje pas vendosjes me Serbinë. Institucionet shpresojnë se "One stop shop" me Shqipërinë do të ndikojë dukshëm në rritjen bashkëpunimit tregtar mes dy vendeve

Koha Zejnulla VESELI

Shkup, 4 shtator - Pas vendosjes së "One stop shop" me Serbinë, Shqipëria do të jetë shteti i dytë me të cilin Maqedonia do të vendos kontrollin e përbashkët kufitar me një ndalje. Ministri i Ekonomisë, Kreshnik Bekteshi, informoi se qeveritë e të dyja vendeve kanë dhënë pëlqimin për vendosjen e kontrollit kufitar, kështu që pritet shumë shpejt të fillohet me punët ndërtime për objektin e përbashkët të kontrollit të lëvizjes së lirë të qytetarëve dhe transportuesve.

Ministri Bekteshi njoftoi se vendosja e kontrollit të përbashkët kufitar do të ndikojë dukshëm në rritjen bashkëpunimit tregtar mes dy vendeve. "Maqedonia është plotësisht e angazhuar të rrisë bashkëpunimin me vendet e rajonit, duke krijuar një zonë të përbashkët ekonomike, e cila do të rrisë konkurrencën e kompanive tona", thotë

"ONESTOP SHOP" NË QAFËTHANË

PIKË E PËRBASHKËT ME SHQIPËRINË, KOSOVA DUHET TË PRESË



Bekteshi. Sipas tij, qëllimi i këtij projekti është të lehtësohet tregtia e lirë e mallrave, të përmirësohet menaxhimi i përbashkët i rrezikut dhe të rrit sa më shumë shkëmbimin tregtar midis dy vendeve.

"Fillimi i zbatimit të projektit për kontroll të përbashkët të kufijve, sipas sistemin 'one stop shop' ndërmjet Maqedonisë dhe Shqipërisë, si shtete nënshkruese të Konventës Ndërkombëtare për Thjeshtësimin dhe Harmonizimin e Procedurave Doganore, është

pjesë e planit të veprimit për krijimin e një Zone ekonomike rajonale të Ballkanit Perëndimor, të miratuar në Samitin e BE-së dhe gjashtë shteteve të Ballkanit Perëndimor në Trieste në vitin 2017-të", tha ministri Bekteshi. Në pyetjen se kur do të vendoset pikë e përbashkët kufitare edhe me Kosovën, deri në mbylljen e gazetë nuk morën përgjigje konkrete nga Ministria e Ekonomisë. Me miratimin e këtij vendimi, në seancën e fundit të Qeverisë së Maqedonisë,

Qeveria angazhon Drejtorinë e Doganave të Maqedonisë të përgatisë dokumentacion dhe të gjitha aktivitetet për vendosjen e pikës së përbashkët të kontrollit në kalimin kufitar Qafëthanë dhe të informojë organet përgjegjëse të Republikës së Maqedonisë dhe Republikës së Shqipërisë përmes Ministrisë së Punëve të Jashtme të Maqedonisë dhe, në afat prej 15 ditëve të formojnë një grup të përbashkët që do të vendosin për krijimin e "One stop shop" midis Maqedonisë dhe Shqipërisë.

Ndryshe, vendet e Ballkanit Perëndimor, sipas Bankës Botërore (BB), brenda një viti kalendarik humbin me miliarda euro për shkak të pritjeve të gjata nëpër kufi për transport mallrash.

Sipas BB-së, 80 për qind të kohës kamionët e humbin duke pritur të kalojnë kufirin nëpër rrugët e Ballkanit. Mirëpo, me vendosjen e përbashkët të kontrollit kufitar midis vendeve të Ballkanit Perëndimor, sipas BB-së, do të ketë import dhe eksport më të lirë të mallrave, do të rritet numri i kamionëve që shumë shpejtë do të kalojnë pikat kufitare të vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe do të parandalohen keqpërdorimet doganore. Nëse të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor do të zbatonin modelin e kontrollit të përbashkët kufitar, thotë Raporti i BB-së, atëherë vetëm me një ndalje do të kishte rritje të këmbimit tregtar për 3.5 për qind, ndërsa shpenzimet e firmave që importojnë dhe eksportojnë mallra do të zvogëloheshin për 10 për qind. Ndërkohë, të dhënat e Ministrisë së Punëve të Brendshme tregojnë se vetëm në pikën kufitare Bllacë-Hani i Elezit, brenda një viti nga të dyja anët kemi 2.7 milionë hyrjedalje të njerëzve.

BËHET GATI FESTIVALI I TEATRIT SHQIPTAR, KULTURA NUK JEP PËRGJIGJE

600 mijë denarë dhe shumë pikëpyetje për Festivalin e Dibrës

Për këtë manifestim, që për gati dy dekada mbledh së bashku për një javë rresht në qytetin e Dibrës trupa teatrore, aktorë, regjisorë e kritikë nga Shqipëria, Kosova, Mali i zi e të tjera, Ministria e Kulturës që është sponsori kryesor i këtij manifestimi, ka akorduar vetëm 600 mijë denarë. Gati një muaj përpara nisjes së festivalit (5-11 tetor), Ministria e Kulturës nuk ka asnjë përgjigje për ankesën e drejtuesve të festivalit për të shtuar buxhetin

Koha Evis HALILI

Shkup, 4 shtator - Peripecitë për realizimin e një prej manifestimeve më tradicionale në vend, Festivalit të Teatrit Shqiptar po ndjekin edhe edicionin e sivjetshëm, të 17-in me radhë. Për këtë manifestim, që për gati dy dekada mbledh së bashku për një javë rresht në qytetin e Dibrës trupa teatrore, aktorë, regjisorë e kritikë nga Shqipëria, Kosova, Mali i zi e të tjera Ministria e Kulturës, që është sponsori kryesor i këtij manifestimi, ka akorduar vetëm 600 mijë denarë.

Gati një muaj përpara nisjes së festivalit (5-11 tetor) nga ky institucion nuk ka asnjë përgjigje për ankesën e drejtuesve të festivalit për të korrigjuar buxhetin. Edhe pse bëhet fjalë për projektin që është pjesë e Programit vjetor për financimin e projekteve me interes nacional në kulturë, miratuar disa muaj më parë. Po ashtu, edhe sponsori tjetër, Komuna e Dibrës nuk ka dhënë pëlqimin ende për asnjë fond. Edicioni i vitit të kaluar,

për shkak të problemeve financiare, i quajtur i jashtëzakonshëm, u mbyll disa ditë përpara përfundimit. Probleme të ngjashme kishte edhe në vitin 2016, kur drejtuesit zgjodhën protesta dhe grevën e urisë për të zgjidhur problemet financiare. Drejtori Ylber Nuredini thotë se pavarësisht se për 16 vjet prezantohen si një festival serioz, mbështetja institucionale ka qenë në kufijtë minimalë. Praktika e injorimit të kërkesave të tyre vazhdon duke mos u marrë seriozisht, as kur hartohen politikat kulturore dhe as kur ndahet apo rishikohet buxheti.

"Për realizimin e festivalit kërkuam që Ministria t'na mbështeste me tre milionë denarë, kërkesa u refuzua duke na dhënë një të tetën e shumës që kërkuam, vetëm 600 mijë denarë. Justifikimet janë qesharake. Sërisht jemi drejtuar me një ankesë dhe jemi në pritje. Deri tani s'kemi përgjigje. Pavarësisht se çfarë përgjigje na vjen, mund të them se edhe këtë vit do ta mbrojmë këtë manifestim dhe

jam i bindur se do të bëjmë edicionin më të bukur, qoftë edhe pa përkrahje", thotë drejtori Nuredini. Shumat maksimale që ndahen për organizimet e ngjashme - festivale, variojnë nga 4 milionë denarë e deri në 200 mijë denarë. Për shembull, Festivali i Teatrit në Tetovë këtë vit financohet me 2 milionë denarë, "Vojdan Černodrnski" në Prilep me tre milionë denarë, Festivali Ndërkombëtar i Teatrit në Shkup (MOT) me 4.5 milionë denarë, Festivali i Komedisë në Kumanovë me 800 mijë denarë, Festivali i Monodramës në Manastir me 400 mijë denarë, e të tjera.

"Festivali i Dibrës është një prej manifestimeve më serioze në vend, që duhet përkrahur për vlerat që sjell dhe traditën që mundohet të ruajë, por edhe publikun e veçantë që ka. Këtë nuk e them unë, por e thonë ata që kanë qenë pjesë e këtij festivali, kritikë, aktorë, artistë... Por mesa duke fati i festivaleve, mbështetja, apo edhe shuarja, madje edhe hapja e atyre të rejave bëhet sipas lidhjeve par-



tiakë dhe jo meritave", thotë Nuredini.

Në programin e këtij viti, që është edhe Viti i Skënderbeut, si risi janë hapja e cila do të bëhet nga Ansambli shtetëror i këngëve dhe valleve "Shota" nga Kosova me një performacë kushtuar heroit kombëtar, ndërsa mbyllja e festivalit me pjesën e Teatrit Shqiptar të Shkupit "Gratë". Gjatë netëve të tjera, në skenën e këtij festivali do të ngjiten trupa nga teatrore nga Shqipëria, Kosova dhe nga vendi, ndërsa planifikohet që të organizohen edhe tryeza debati për dramaturgjinë dhe teatrin sot.

POLICIA ZBARDH KRIMIN E TREFISHTË NË DIBËR



S'MË LANË TË MARTOHEM ME ITALIAN, BLERTA ARSYETON VRASJEN E PRINDËRVE

“E akuzuar ka pranuar se vrasjen e organizuar pikërisht ajo, por jo edhe ekzekutimin. Po hetohet pistoleta, e cila ishte blerë nga 33-vjeçari nga Gostivari, ndërsa ishte në pronësi të dajës së tij, 66-vjeçarit nga Dibra, gjithashtu i akuzuar në këtë vrasje të trefishtë. Arsyetimi i 28-vjeçarës para punonjësëve policor ka qenë se, prindërit e kanë penguar të martohet me një italian”, thonë zyrtarë të policisë



Koha

Omer XHAFAERI

Shkup, 4 shtator - Policia e Maqedonisë ka arritur në përfundim të zbardhjes së shkaqeve që çuan 28-vjeçaren Blerta Pocesta të vret në mënyrë makabre babain, nënën dhe motrën 13-vjeçare në shtëpinë familjare në Dibër. Vrasja e tmerrshme që ndodhi më 27 gusht është organizuar pikërisht nga Blerta, e cila pas arrestimit të djeshëm nga policia e Maqedonisë, ka pranuar se është organizatore e vrasjes së trefishtë, por jo edhe organizatore. Burime zyrtare të Ministrisë së Punëve të Brendshme i kanë thënë gazetës KOHA se, pas hetimeve të pandërprera dhe pas marrjes në pyetje të të akuzuarës, 28-vjeçarja është arsyetuar se vrasjen e babait, Amid Pocesta, 55-vjeç, nënën Nazmije, 53-vjeçe dhe motrën e vogël, 13-vjeçaren Anila, e ka bërë pasi e kishin penguar të martohet me të dashurin e saj, shtetas italian.

“E akuzuar ka pranuar se vrasjen e organizuar pikërisht ajo, por jo edhe ekzekutimin. Po hetohet pistoleta, e cila ishte blerë nga V.M 33-vjeçar nga Gostivari, ndërsa ishte në pronësi të dajës së tij, F.G 66-vjeçar nga Dibra, gjithashtu i akuzuar në këtë vrasje të trefishtë. Arsyetimi i 28-vjeçarës para punonjësëve policor ka qenë se, prindërit e kanë penguar të martohet me një italian”, thonë zyrtarë të policisë. Megjithatë, policia ka konstatuar se është pikërisht Blerta ajo që ka lënë gjurmë në shtëpi,

ndërsa po hetohet nëse me të ka qenë edhe ndonjë person tjetër.

“Janë gjetur gjurmë të vajzës brenda shtëpisë ku u krye krimi, ndërsa po hetohet nëse e njëjta ka qenë e shoqëruar edhe nga ndonjë person tjetër. Po hetohet edhe pistoleta, ndërsa janë edhe gjetur doreza. Njëra dritare e shtëpisë ishte e hapur, me çka e akuzuar ka hyrë dhe ka dalë pasi është kryer krimi”, thonë për KOHA zyrtarë policor.

Gjurmët e Blertës se e njëjta është përfshirë në vrasjen e prindërve dhe motrës së saj janë zbuluar pikërisht me sistemin TIMS të policisë - sistem i hyrje-daljeve nga pikë kalimet kufitare të vendit.

Një ditë para vrasje, Blerta ishte futur në Maqedoni, ndërsa të nesërmen në mëngjes, ajo ishte nisur për në Itali, ku edhe qëndronte me prindërit e saj, tashmë të ndjerë. Një ditë më pas, Blerta sërisht kishte udhëtuar për në Maqedoni, kiu kishte marrë pjesë në varrimin e viktimave të saj, ndërsa kishte hapur dyert edhe për ngushëllime pas humbjes së prindërve dhe të motrës së vogël.

Policia ka konstatuar gjithashtu që 28-vjeçarja është konsumuese e narkotikëve, ndërsa ditën e krimit dhe më pas, ajo kishte qëndruar në një hotel në Strugë. Edhe Prokuroria Themelore Publike e Gostivarit ka njoftuar se tashmë i është vazhduar paraburgimi tre të arrestuarve për vrasjen makabre në

Dibër. “Në lidhje me vrasjen e trefishtë në Dibër, Prokuroria Themelore Publike e Gostivarit, si kompetente për të vepruar në lëndë, intensivisht i ka ndërmarrë të gjitha veprimet për konstatimin e përgjegjësisë penale dhe për mbledhjen e dëshmive. Deri në këtë moment, tre persona janë privuar nga liria dhe për të njëjtët është shqiptuar masa e vazhduar e paraburgimit”, kanë njoftuar nga Prokuroria e Gostivarit. Ndryshe, ditën e krimit, mediat shpejtuan që ta drejtojnë gishtin te dhëndri i shtëpisë, Rasim Findo, nga Dibra, pasi u raportuar se viktimat me Findon kishin një mosmarrëveshje pronësore. Në një prononcim për mediat, Rasim Fino ka deklaruar se në media u përfol se vrasësi ishte ai, por kjo nuk ishte e vërtetë pasi ata nuk kishin pasur probleme pronësie.

“Unë jam dhëndri i Amid Pocestës. Televizionet dhanë lajmin se unë jam vrasësi. Policia tha se e ka kryer vajza krimin. Unë isha në pyetje, më mbajtën për 24 orë në polici. Unë akuzohesha si vrasësi, por u zbulua hyrje-dalja e vajzës. Blerta kreu vrasjen, kishte qëllim paratë e prindërve. Motra tjetër e Blertës, Mukadesi, e pranoi në gjyq. Edhe motra e Blertës ka qenë në rrezik, ajo do ta vriste. Mukadesi është 26 vjeçe, ndërsa Blerta 28 vjeçe. Unë u dyshova i pari sepse jam në një gjyq prone me ta. Kanë dyshuar se e kam vrarë për gardhin. Ne këtu s’kishim probleme”, ka deklaruar Fino.

KRONIKË

31 vjeçari kapet duke vjedhur në qebaptore

Pjesëtarë të policisë nga Sektori për Punë të Brendshme në Tetovë - Stacioni policor i Gostivarit të martën në orët e para të mëngjesit kanë arrestuar 34-vjeçarim me iniciale N.I nga fshati Debresh i Gostivarit, i cili sipas policisë, më parë me dhunë kishte thyer derën e një qebaptoreje të lokalizuar në rrugën “Nikolla Parapunov”, në Gostivar. I arrestuari me inicialet N.I me ndihmën e një kaçavide ka hapur derën hyrëse të objektit dhe nga një sirtar në tavolinën e punës ka marrë para, dhe kur ka vërejtur pjesëtarët e policisë, ka filluar të ikë, por menjëherë është kapur. Pas arrestimit, N.I i cili ka kryer disa vjedhje të rënda, është mbajtur në stacionin policor të Gostivarit për zbardhjen e plotë të rastit njofton policia e Gostivarit.

Sulmohen dy të rinj tetovarë

23-vjeçari me inicialet F.A dhe 19-vjeçari me iniciale D.A nga Tetova, të hënën rreth orës 17.30 minuta kanë denoncuar se janë sulmuar fizikisht nga 55-vjeçari me iniciale N.M dhe 29-vjeçari me iniciale A.M, si dhe një person tjetër i panjohur gjithashtu nga Tetova, pas një zënke të shkurtër verbale rreth montimit të disa njehsorëve të energjisë elektrike në afërsi të shtëpive të tyre. Të denoncuarit janë thirrur në Sektorin për Punë të Brendshme në Tetovë për zbardhjen e të gjitha detajeve që ndërlidhen me rastin në fjalë njofton policia e Tetovës përmes një kumetese me shkrim.

Aksident në Bogovinë, lëndohet një person

Në rrugën lokale të Bogovinës, të hënën pasdite rreth orës 18.30 minuta ka ndodhur një aksident komunikacioni në të cilin janë përfshirë dy automjete me targa të Tetovës - një “Ford Transit” i drejtuar nga 57 vjeçari me iniciale A.J nga fshati Pirok, si dhe një “Golf”, të cilin e ka drejtuar 31vjeçari me iniciale E.M nga Bogovina. Vozitësi i lënduar i makinës Golf është dërguar në Spitalin klinik të Tetovës ku është mbajtur për shërim të mëtutjeshëm. Është kryer hetim në vendin e ngjarjes dhe po punohet në zbardhjen e shkaqeve dhe të gjitha detajeve të tjera që ndërlidhen me rastin në fjalë njofton Sektori për punë të brendshme në Tetovë.

Aksident në Gradsko, lëndohet rëndë kamionisti serb

Një shtetas serb, i cili ka drejtuar një kamion “Skania” me gjysmërimorkio, dje pasdite ka dalë nga rruga Gradsko-Prilep dhe ka rënë në greminë. MPB kumtoi se fatkeqësia ka ndodhur në orën 16, ndërsa shoferi 41-vjeçar S.P. ka marrë lëndime të rënda trupore dhe me automjetin e Ndihmës Mjekësore Urgjente është dërguar në Spitalin e përgjithshëm në Prilep ku është ndaluar për mjekim. Ekspertizë në vendin e fatkeqësisë kanë kryer prokurori publik dhe ekipi i Stacionit Policor të Prilepit.

Lëndohet 20 vjeçari, u aksidentua me motoçikletë

Të hënën rreth orës 12.30 minuta në bulevardin e “Ilindenit” në Tetovë deri më tani një veturë e panjohur ka goditur një motoçikletë të tipit “Jijing”, me targa të Tetovës e drejtuar nga 20-vjeçari tetovarë me iniciale N.A dhe menjëherë është larguar nga vendi i ngjarjes. Nga lëndimet e mara motoçiklisti me inicialet N.A menjëherë është dërguar në spitalin klinik të Tetovës, dhe pas kryerjes së ekspertizës në vendin e ngjarjes po punohet në zbardhjen e shkaqeve dhe të gjitha detajeve të tjera që ndërlidhen me këtë aksident. (U.H)

Paditet shkupjani që trafiko emigrantë

Shkup, 4 shtator - Qendra rajonale për punë kufitare Jug deri tek Prokuroria Themelore Publike Shkup ka parashtruar kallëzim penal kundër R.F. (41) nga Shkupi për shkak të dyshimit bazë për vepër të bërë penale "kontrabandim të emigrantëve". Nga gjykatësi për procedurën paraprake, të denoncuarit i është caktuar masë e paraburgimit në kohëzgjatje prej 30 ditëve. Siç informoi MPB-ja, më 1 shtator në orën 17:30 minuta në autostradën Gjevgjeli-Shkup, tek fshati Përdejci, nëpunësit policorë nga Stacioni policor për vendkalim kufitar dhe mbikëqyrje kufitare Bogorodicë kanë vërejtur një automjet motorik "Hjundai" me targa të Shkupit në të cilin ka pasur emigrantë. Automjeti me shpejtësi të madhe është nisur drejt Shkupit, ndërsa policët janë nisur pas tij. Pas rrugës Miravci, automjeti ka ndaluar, emigrantët kanë dalur nga ai, ndërsa automjeti ka vazhduar më tutje. Pas një kohe të shkurtër është ndaluar, ndërsa atë e drejtonte R.F. (41) nga fshati Hasanbeg i Shkupit. Janë gjetur edhe 14 persona-emigrantë nga të cilët 11 persona nga Afganistani dhe tre nga Pakistani.

"Trajektorja" vazhdon më 18 shtator

Shkup, 4 shtator - Më 18 shtator vazhdon gjykimi për lëndën "Trajektorja" të PSP-së, në të cilin do të dëgjohen një pjesë e 14 bombave që pasdite gjykatësi Goran Boshevski lejoi të dëgjohen në sallën gjyqësore në kërkesë të mbrojtjes, por pa praninë e opinionit. Në pjesën e pasdites të seancës, pas pauzës të dhënë që gjykata të japë vendim për kërkesën për (jo) dëgjimin e 14 bombave kontestuese, një pjesë e tyre megjithatë janë dëgjuar, po praninë e opinionit. Prokurorja Lile Stefanovska për këto "bomba" kontestuese mendoi se nuk duhet të shfrytëzohen si dëshmi, sepse kanë qenë biseda private, ndërsa disa janë zhvilluar edhe në gjuhë të huaj. Gjykimi për lëndën "Trajektorja" përndryshe vazhdoi pas pauzës dymuajshe. Në Gjykatën penale, të pranishëm ishin të akuzuarit Nikolla Gruevski, Vladimir Peshevski, Mile Janakievski dhe Lupço Georgievski, si dhe prokurorja Lile Stefanovska. Për "Trajektores" në sallën gjyqësore duhet të dëgjohen gjithsej 315 "bomba".

KËRKOHET NDIHMË PËR TRAJTIMIN E QENVE ENDACAK



NJË QENDËR RAJONALE PËR QENTË ENDACAK

"Për zgjidhjen e problemit do të ndërmerren hapa konkrete si dhe mbështetje financiare dhe teknike do të kemi edhe prej organizatës ndërkombëtare UNDP, ku parashihet përpilimi i dokumentacionit teknik për ngritjen e një Qendre rajonale për trajtimin e qenve endacak, si dhe sigurimin e një automjeti modern për kapjen e këtyre qenve", ka theksuar Teuta Arifi

Koha Urim HASIPI

Tetovë, 4 shtator - Problemi me qentë endacak tashmë nuk ka përfshirë vetëm Komunën e Tetovës, por edhe komunat rurale, ku

në disa prej tyre është më i theksuar prania e qenve të rrugës. Këtë e ka nënvizuar edhe kryetarja e Komunës së Tetovës, Teuta Arifi, e cila ka theksuar se kanë kërkuar ndihmë për ndërtimin e një Qendre rajonale.

"Prioritet të veçantë i është dhënë zgjidhjes së problemit për trajtimin e qenve endacak në nivel rajonal, problem me të cilin ballafaqohen të gjitha komunat që janë pjesë përbërëse e rajonit planor të Pollogut. Për zgjidhjen e problemit do të ndërmerren hapa konkrete si dhe mbështetje financiare dhe teknike do të kemi edhe prej organizatës ndërkombëtare UNDP, ku parashihet përpilimi i dokumentacionit teknik për ngritjen e një Qendre rajonale për trajtimin e qenve endacak, si dhe sigurimin e një automjeti modern për kapjen e këtyre qenve", ka theksuar kryetarja e Komunës së Tetovës, Teuta Arifi në mbledhjen e fundit të kryetarëve të Pollogut. Përndryshe, Komuna e Tetovës

kohë më parë ka hartuar program për trajtimin e qenve endacak, problem ky i kamotshëm dhe i pazgjidhur për qytetarët e Tetovës.

"Në vitin 2018 parashikohet kapja dhe trajtim i rreth 20 qenve në muaj, përkatësisht rreth 240 në vit. Trajtimi veterinar i qenve do të realizohet nëpërmjet mjekut të mjekësisë veterinerë. Aktivitetet do të kryhen në tre ndërrime. Në ndërrimin e parë dhe të dytë do të kryhen obligimet e zakonshme për kontrollin e brezave të qytetit, në përputhje me programin, por edhe do të intervenohet me kërkesë të qytetarëve. Ndërrimi i tretë në varësi të kushteve klimatike do të zhvillohet në mbremje dhe herët në mëngjes, gjatë kësaj parashikohet kontrolli i brezave tashmë të përpunuara dhe intervenime të serishme", sqarojnë nga Komuna e Tetovës.

Për këtë qëllim janë paraparë mjete në vlerë rreth 500 mijë denarë. Aktivitetet për zgjidhjen humane të problemit me qentë en-

dacakë në territorin e Qytetit të Tetovës nënkuptojnë kapjen e tyre, transportin deri te stacionari, pranimin dhe kontrollin nga veterinari i autorizuar, kontrollin laboratorik të qenve për sëmundje të caktuara, identifikimin dhe mbajtjen e evidencës, transportin e të njëjtëve deri në vend të caktuar të rregulluar me marrëveshje, eutanazi atyre me sëmundje të rëndë dhe të rrezikshme për ambientin jetësor", qëndron në programin e Komunës së Tetovës të hartuar kohë më parë.

"Financimi i Programit kryhet me mjete të parashikuara në buxhetin e Komunës së Tetovës për vitin 2018, në shumën prej 500 mijë denarëve. Çmimet për kapjen e qenve e endacakë, qëndrim në stacionar dhe për trajtimin veterinar të parashikuara me këtë program, definoohen nga ofertuesi më i mirë, i zgjedhur me furnizim publik nga Komuna e Tetovës", theksojnë nga Komuna e Tetovës.

Vihen themelet e sallës sportive në Saraj

Shkup, 4 shtator - Ministri i Arsimit dhe Shkencës, Arbër Ademi, së bashku me kryeministrin Zoran Zaev, liderin e BDI-së, Ali Ahmeti dhe kryetarin e Komunës së Sarajit, Blerim Bexheti dje shënuan fillimin e aktiviteteve për ndërtimin e sallës së re të sportit - që është në përbërje të shkollës së mesme "Saraj". Në ceremoninë e organizuar me këtë rast, ministri Ademi ka potencuar se ky investim, realizimi i së cilës korrespondon me fillimin e vitit të ri shkollor, konfirmon se një nga synimet parësore të kësaj Qeverie, në kuadër të politikave arsimore, është avancimi i kushteve infrastrukturore për realizimin e suksesshëm të procesit edukativo-arsimor dhe sporti dhe rekreacioni i më të rinjve. "Kjo sallë sporti do t'i përbushë të gjitha standardet



bashkëkohore për cilësi, si nga aspekti i materialit ndërtimor, po ashtu edhe nga aspekti i sporteve që do të mund të realizohen, si futboll i vogël, hendboll, basketboll, volejbol, gjimnastikë, pingpong - për të cilat do të vendoset pajisje adekuate dhe rekuizita sportive", theksoi ministri Ademi, duke sh-

tuar se ky objekt do të ketë sipërfaqe prej 1300 metra katrorë, me dhoma veshjeje, hapësira për rekuizita, hapësira/zyra për mësuesit, tualete dhe tribuna me kapacitet prej 500 karrigeve. Vlera e përgjithshme e këtij investimi, që arrin shumën 40 milionë denarëve dhe që realizohet tërësisht nga Mi-

nistria e Arsimit dhe Shkencës, është me mjete buxhetore dhe mjete nga Banka për Zhvillim pranë Këshillit të Evropës - në kuadër të projektit për ndërtimin e 145 sallave të sportit nëpër shkolla. Duke e uruar nxënësit, mësuesit dhe komunën, Ademi theksoi se salla do të duhet të përfundojë deri në fillim të vitit të ardhshëm shkollor dhe se përveç mbajtjes së orëve për sport dhe aktivitete sportive, objektin do të mund ta shfrytëzojnë edhe klubet e sporti dhe popullata lokale. Ministri Ademi ka shtuar se në kuadër të komunës së Sarajit, përveç fillimit të punimeve për ndërtimin e kësaj salle sporti, në rrjedhë e sipër është ndërtimi i sallës së sportit që është në përbërje të shkollës fillore në fshatin Gillumovë.

“MEGJASHI” ME APEL DREJTUAR INSTITUCIONEVE

FËMIJËT LYPSARË EDHE SIVJET JASHTË MËSIMIT!

Edhe pse Ministria e Punës dhe Politikës Sociale (MPPS) nuk disponon me shifër konkrete për numrin e fëmijëve në rrugë, supozohet se janë diku mbi 600 të tillë në nivel republikan, pjesa më e madhe në Shkup, Manastir, Prilep, Tetovë... kurse gjatë verës edhe në Strugë dhe Ohër



Koha

Aida XHONI

Shkup, 3 shtator - Verë ose dimër, ditë jave e shkollës ose jo... këta fëmijë të mitur dhe shumë të tjerë moshatarë të tyre mund të shihen çdokund nëpër udhëkryqe apo kafene të qytetit duke shitur gjësende të ndryshme. Nëpër rrugë mund të shohim edhe foshnje dhe fëmijë nën moshën 6-vjeç, të cilët ecin gjysmë të zhveshur dhe të zbathur. Edhe pse Ministria e Punës dhe Politikës Sociale (MPPS) nuk disponon me shifër konkrete për numrin e fëmijëve në rrugë, supozohet se janë diku mbi 600 të tillë në nivel republikan, pjesa më e madhe në Shkup, Manastir, Prilep, Tetovë... kurse gjatë verës edhe në Strugë dhe Ohër.

A dëshmojnë këta fëmijë për varfërinë e madhe në shtet, si dhe për lëshimet që i kanë bërë organet dhe institucionet kompetente që me vite të tëra nuk arrijnë të zgjidhin këtë problem? Dragi Zmijanac, nga Ambasada e parë për fëmijë në botë “Megjashi”, për gazetën Koha thotë se këta fëmijë, pjesa dërmuese e të cilëve janë nga etniteti romë, keqpërdoren nga prindërit e tyre ose persona tjerë.

Fëmijët në rrugë shpeshherë janë jashtë procesit edukativo-arsimor.

“Ata shfrytëzohen për punë në bujqësi, mbledhje të pemëve dhe të ngjashme, njëjtë edhe në forma tjera të keqpërdorimit të mundit të fëmijëve. Me shkëputjen e fëmijëve nga arsimimi, ata direkt kyçen në rrethin e varfërisë dhe analfabetizmit. Në këtë mënyrë, nuk u ndihmojmë fëmijëve të mbarojnë arsimimin e obligueshëm fillor. Fëmijët që nuk janë të kyçur në procesin arsimor rrjedhin nga familje të rrezikuara sociale, tek të cilët ekziston trashëgimia e varfërisë nga brezi në brez. Ato janë familje ku nikoqiri i shtëpisë shpeshherë nuk është i punësuar dhe nuk ka as kulm mbi kokë”, tha Zmijanac.

“Megjashi” apelon deri tek MPPS që perkujdesja ndaj këtyre fëmijëve të nis para se të arrijnë fëmijët moshën për të shkuar në shkollë. “Kjo kategori e rrezikuar e fëmijëve të fitojë benefite nga shteti që të shkojnë nëpër kopshte falas që nga moshën tre vjeçe. Vetëm në këtë mënyrë këta fëmijë mund ti largojmë nga rruga dhe nga keqpërdorimi i tyre. Njëkohësisht duhet të punohet edhe me prindërit e tyre, të

DRAGI ZMIJANAC

Me shkëputjen e fëmijëve nga arsimimi, ata direkt kyçen në rrethin e varfërisë dhe analfabetizmit. Në këtë mënyrë, nuk u ndihmojmë fëmijëve të mbarojnë arsimimin e obligueshëm fillor. Fëmijët që nuk janë të kyçur në procesin arsimor rrjedhin nga familje të rrezikuara sociale, tek të cilët ekziston trashëgimia e varfërisë nga brezi në brez. Ato janë familje ku nikoqiri i shtëpisë shpeshherë nuk është i punësuar dhe nuk ka as kulm mbi kokë

inkorporohen në procesin edukativo-arsimor të obligueshëm. Kërkojmë nga shteti që një person nga këta familje disfunktionale të rrezikuara ekonomisht të punësohet, të ndiqet procesi i tyre arsimor dhe të shfrytëzohen beneficinet e Qendrave për punë sociale. Gjithashtu kërkojmë nga shkollat të sigurojnë ushqim, pajisje shkollore dhe veshmbathje falas për këto

fëmijë”, u shpreh Zmijanac.

Vëzhgimet tregojnë se fëmijët në këso situatë janë viktimë të dhunës dhe varfërisë në familje, ndaj policia ka zbuluar disa prej prindërve që shtyjnë fëmijët të lypin. “Nga ana e Sektorit të Punëve të Brendshme (SPB në Shkup, nën nenin 201 të paragrafit 2 të Kodit Penal të RM-së (prind, tutor, birësues ose person tjetër që urdhëron një person të mitur të punojë moshë dhe fiziku i të cilit nuk përshtatet për punë apo për të kryer veprimtari tjera), gjatë vitit 2017 janë evidentuar tri vepra penale, ndërsa në vitin 2018 (deri në korrik), janë evidentuar dy vepra penale”, thanë për KOHA nga MPB.

Ndryshe, mbi 600 fëmijë në Maqedoni asnjëherë nuk kanë shuar në shkollë, derisa 500 e kanë braktisur arsimimin. Këto janë të dhëna të publikuara në janar të këtij viti nga Qendra maqedonase për arsimimin qytetar si pjesë e projektit për fëmijët jashtë procesit arsimor. Sipas këtij raporti, më së shumti fëmijë të pa regjistruar në shkollë vitin e kaluar kishte në Kumanovë, Manastir, Shuto Orizare dhe Koçanë.

Mërgimtarët rikonstruojn ë shkollën e Pallçishtit

Tetovë, 4 shtator - Nxënësit dhe mësime të ndryshme të shkollës fillore “Dervish Cara” këtë vit shkollor shkollën e kanë gjetur me kushte më të mira objektive për zhvillimin e procesit arsimor kjo falë kontributit të Rinisë së Pallçishtit në Diasporë dhe Shoqatës së Mërgimtarëve të fshatit Pallçisht që jetojnë, vepron dhe punojnë në Zvicër, si dhe vende të tjera të Evropës.

Me këtë rast, është kryer llyerja e fasadës së brendshme të shkollës, është riparuar i gjithë rrjeti elektrik nëpër klasa dhe korridore, është sanuar rrjeti i ujësjesit ku ka pasur nevojë, është rregulluar dhe janë zëvendësuar sanitaret e ndryshme në tualetet e kësaj shkolle, janë siguruar mjetet mësimore bashkëkohore dhe kështu me radhë. Drejtori i shkollës, Demirali Jonuzi, shprehu mirënjohjen e tij të thellë dhe falënderoi të gjithë ata të cilët kanë dhënë kontributin e tyre për përmirësimin e kushteve në shkollën fillore “Dervish Cara”.

Përfaqësuesi i Rinisë së Pallçishtit në Diasporë, Gzim Sulejmani, theksoi se kjo organizatë rinore që funksionon në diasporë që nga themelimi ka realizuar një sërë projektesh me karakter humanitar, ekologjik, kulturor, arsimor, si dhe gjithmonë do të jetë në shërbim të bashkëvendësve të tyre për të plotësuar nevojat që ata kanë.

Nga kjo organizatë rinore e fshatit Pallçisht dhe drejtorja e shkollës nënvizuan se do të bashkëpunojnë edhe në të ardhmen për të realizuar projekte nga më të ndryshmet që do të jenë në shërbim të qytetarëve. (U.H)

Eksporti shënon rritje prej 25.7 për qind

Shkup, 4 shtator - Shkëmbimi i përgjithshëm me vendet e huaja për periudhën janar - korrik të këtij viti është 9.102.394.000 dollarë amerikan, me ç'rast shënon rritje prej 24,3 për qind. Vlera e importit, sipas të dhënave të publikuara të Entit Shtetëror Statistikor, është 5.195.729.000 dollarë amerikan dhe ka rritje prej 23,3 për

qind, ndërsa vlera e eksportit është 3.906.666.000 dollarë amerikan dhe shënon rritje prej 25,7 për qind. Deficiti tregtar, në periudhën janar - korrik të vitit 2018, është 1.289.063.000 dollarë amerikan. Mbulimi i importit me eksport, në periudhën janar - korrik 2018, është 75,3 për qind. Sipas të dhënave të publikuara, Maqedo-

nia më së shumti eksportonte katalizatorë të bartësve me metale fisnike ose kompozimet e tyre, grupet e përcësve për ndezje dhe ngjashëm, për automjete, aeroplanë ose anije, pjesët e ulëseve nga nëngrupi 821,1 dhe automjetet motorike për transport të 10 ose më shumë personave, përfshirë edhe shoferin, me motor me

djegje të brendshme me ndihmën e kompresionit (dizel ose gjysmëdizel). Në import më së shumti preket platina ose legurat e platinave, të papërpunuara ose në pluhur, ose vajrat e naftës ose vajrave të fituara nga minerale bitumenoze nga hekuri ose çelik të joleguar, të joplatinuara ose zhvishen edhe metalet

tjera nga grupi i platinave dhe legurat e tyre, të papërpunuara ose në formë pluhuri. Në periudhën janar - korrik 2018, sipas vëllimit të përgjithshëm të shkëmbimit jashtë tregtar, Republika e Maqedonisë më së shumti ka tregtuar me Gjermaninë, Greqinë, Britaninë e Madhe, Serbinë dhe Bullgarinë.

Në bazë të nenit 21 paragrafi 1 të Ligjit për tokë bujqësore ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 135/07, 18/11, 148/11, 95/12, 79/13, 87/13 106/13, 164/13, 39/14, 130/14, 166/14, 72/15, 98/15, 154/15, 215/15, 7/16 dhe 39/16), ndërsa pas pëlqimit të marrë më herët nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë dhe Vendimit të sjellë për dhënie të pëlqimit të Shpalljes publike nr. 07/18 për dhënie me qira të tokës bujqësore në pronësi të shtetit për sipërfaqe deri në 3 hektarë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 157/18), ministri i bujqësisë, pylltarisë dhe ekonomisë së ujërave publikon:

SHPALLJE PUBLIKE nr. 07/18

Për dhënie me qira të tokës bujqësore në pronësi të shtetit për sipërfaqe deri në 3 hektar

I. LËNDË E SHPALLJES PUBLIKE

Jepet me qira tokë bujqësore në pronësi të shtetit me sipërfaqe të përgjithshme prej **834 ha 54 ar 90 m²** edhe atë për rajonet në vijim në Republikën e Maqedonisë:

Numri rendor	Rajoni	Ha	Ar	m ²
1	Manastir	77	27	51
2	Veles	186	80	87
3	Makedonski Brod	17	85	58
4	Gjevgjeli	347	16	65
5	Demir Hisar	2	53	25
6	Kriva Pallanka	34	42	69
7	Kratovë	12	76	42
8	Strumicë	9	23	82
9	Probishtip	102	3	50
10	Tetovë	44	44	61
GJITHSEJ		834	54	90

Të dhënat për tokën bujqësore nga kjo shpallje publike (për autorizimet dhe ngarkesa të tjera, për gjendjen e tokës, të dhënat e kadastrës të përmbajtura në listën pronësore) janë pajtim me evidencën ekzistuese të kadastrës dhe njohuri në ato të dhëna për secilën sipërfaqe mund të bëhet në ueb faqen e Ministrisë së bujqësisë, pylltarisë dhe ekonomisë së ujërave, në tabelën për shpallje në njësine periferike të Ministrisë ku gjendet toka bujqësore që është lëndë e shpalljes publike.

Toka bujqësore në pronësi të shtetit e cila jepet me qira me këtë shpallje publike është me qëllim për:

- ngritje të mbjelljeve shumëvjeçare (vreshta, pemishte, kmelj) dhe oranzheri për periudhë deri më 30 vjet,
- ngritje të mbjelljeve shumëvjeçare me lajthi për periudhë prej 70 vjetëve,
- ngritje të ullishtave për periudhë deri më 50 vjet,
- kultivim të kulturave të tjera bujqësore për periudhë deri më 15 vjet,
- livadheve për periudhë deri më 15 vjet,
- për kultivimin e drunjtë që rriten shpejt në tokë bujqësore e cila gjendet në lartësi mbidetare mbi 700 metra, për periudhë deri 30 vjet,
- baseneve të peshqve deri në 20 vjet dhe
- aktiviteteve sportive-rekreative dhe turizëm rural deri në 30 vjet

II. TË DREJTË PËR PJESËMARRJE NË SHPALLJEN PUBLIKE

Të drejtë për pjesëmarrje në shpalljen publike kanë subjektet e vendit fizike dhe juridike dhe subjektet e huaja juridike.

Subjektet fizike duhet të jenë realizues të regjistruar të veprimtarive bujqësore dhe/ose të regjistruar në regjistrin e vetëm të ekonomive bujqësore dhe/ose të jenë tregtar individual të cilëve prodhimitaria bujqësore ose përpunimi i prodhimeve primare bujqësore u është veprimtari kryesore.

Subjektet e huaja juridike, kanë të drejtë të marrin pjesë në shpalljen publike nëse kanë të regjistruara filiale në Republikën e Maqedonisë.

Subjekteve të vendit dhe të huaja juridike dhe filialeve të tyre prodhimitaria bujqësore ose përpunimi i prodhimeve primare bujqësore u jetë veprimtari kryesore ose toka bujqësore u është e nevojshme për kryerje të veprimtarive shkencore-hulumtuese.

Personat e lidhur në kuptim të personave juridik të lidhur, persona fizik të lidhur, person fizik i lidhur me person juridik dhe në mënyrë indirekte të lidhur në persona juridik kanë të drejtë të marrin pjesë në shpalljen publike dhe mund të dorëzojnë vetëm një ofertë për pjesëmarrje.

Të drejtë pjesëmarrjeje në shpalljen publike kanë personat të cilët nuk kanë të lidhur marrëveshje të vlefshme për qira me Ministrin e bujqësisë, pylltarisë dhe ekonomisë së ujërave.

Të drejtë për pjesëmarrje në shpallje publike nuk kanë personat të cilat nuk i kanë shlyer detyrimet në bazë të qira marrjes nga kontratat e mëparshme për qiramarrje të tokës bujqësore në pronësi të shtetit dhe obligimet tatimore dhe kontribute në bazë të: tatimit personal, tatimin e vlerës së shtuar, tatimin në fitim, kontribute për sigurim social.

Të drejtë për pjesëmarrje në shpalljen publike nuk kanë personat juridik për të cilët është hapur procedurë falimentuese, si dhe organizatat jofitimprurëse.

III. DOKUMENTACIONI I NEVOJSHËM PËR PJESËMARRJE NË SHPALLJEN PUBLIKE

Pjesëmarrësit në shpalljen publike për dhënie me qira të tokës bujqësore në pronësi të shtetit me qira të hapësirave deri në 3 hektarë me fletparaqitjen duhet të dorëzojnë:

- a) për subjektet juridike:**
- ofertë (formular nga njësia rajonale e Ministrisë së bujqësisë, pylltarisë dhe ekonomisë së ujërave ose nga ueb faqja e Ministrisë www.mzsv.gov.mk);
 - dëshmi (akt) të dhënë nga Regjistri qendror i Republikës së Maqedonisë për kryerjen e regjistrimit të regjistrin tregtar ose nga organ tjetër përgjegjës për regjistrimin e personave juridik;
 - dëshmi se janë paguar të gjitha obligimet në bazë të obligimeve tatimore dhe kontribute në bazë të: tatimit persona të të hyrave, tatimin e vlerës së shtuar, tatimin në fitim, kontribute të detyrueshme për sigurim social;
 - dëshmi për pajisje materiale-teknike (leje të qarkullimit, faturë, marrëveshje për shitblerje të vërtetuar në noter, vendim të plotfuqishëm gjyqësor ose akt të ndonjë organi kompetent) ose dëshmi për shfrytëzim të traktorit si mjet bazë për përpunimin e tokës bujqësore (kontratë për lizing apo kontratë për shërbim të vërtetuara në noter);
 - vërtetim nga Njësia periferike e Ministrisë se nuk ka të lidhur marrëveshje për qira;
 - deklaratë të dhënë me gjithë përgjegjësinë materiale dhe penale se oferta bëhet e pavarur pa marrëveshje me pjesëmarrësit tjerë në shpalljen publike dhe që është në kundërshtim me nenin 24 të Ligjit për tokë bujqësore, se nuk është person i lidhur në kuptim të personave juridik, persona të lidhur fizik, person fizik i lidhur me person juridik ose indirekt persona të lidhur në subjekt juridik;
 - deklarata të vërtetuar në noter për besueshmërinë e të dhënave të paraqitura në fletparaqitjen për pjesëmarrje;
 - biznes plan i cili përmban të dhënat bazë të pjesëmarrësit, qëllimin se për çka do ta përdorë tokën, implementimit të teknologjisë, numrin

e të punësuarve, aspektet e tregut, pritshmërinë për rezultatet prodhuese-ekonomike (biznes plani duhet të nënshkruhet në secilën faqe nga ana e drejtuesit të subjektit juridik ose nga personi i autorizuar për nënshkrim me bashkëngjitje të autorizimit të vërtetuar në noter);

-deklaratë (të vërtetuar në noter) nga themeluesit dhe personi përgjegjës në personin juridik se nuk kanë qenë themelues dhe drejtues të personit juridik që ka shfrytëzuar tokë bujqësore në pronësi të shtetit me qira dhe në të cilën nuk janë përbushur obligimet nga ajo marrëveshje.

b) për personat fizik:

- ofertë (formular nga njësia rajonale e Ministrisë së bujqësisë, pylltarisë dhe ekonomisë së ujërave ose nga ueb faqja e Ministrisë www.mzsv.gov.mk);

-dëshmi se janë paguar obligimet në bazë të obligimeve tatimore dhe kontributeve në bazë të: tatimit personal të të hyrave, tatimin e vlerës së shtuar, tatimin në fitim, kontribute për sigurim të detyrueshëm social;

- dëshmi për pajisje materiale-teknike (leje të qarkullimit, faturë, marrëveshje për shitblerje të vërtetuar në noter, vendim të plotfuqishëm gjyqësor ose akt të ndonjë organi kompetent) ose dëshmi për shfrytëzim të traktorit si mjet bazë për përpunimin e tokës bujqësore (kontratë për lizing apo kontratë për shërbim të vërtetuara në noter);

- fotokopje të letërnjoftimit;

- vërtetim për regjistrin në regjistrin e vetëm të ekonomive bujqësore, vendim si i regjistruar për veprimtari bujqësore ose dëshmi nga regjistri qendror për regjistrin si tregtar i vetëm;

- program për shfrytëzimin e tokës e cila përmban të dhëna bazë për familjen, pajisjen tekniko-teknologjike, qëllimi për të cilin shfrytëzohet toka, aspektet e tregut (programi duhet të nënshkruhet në secilën faqe nga ana e parashtruesit të ofertës);

- deklarata të besueshmëri të të dhënave të paraqitura me fletparaqitjen e vërtetuar në noter;

- vërtetim nga Njësia rajonale e Ministrisë se nuk ka të lidhur marrëveshje për qira;

-deklaratë të dhënë për përgjegjësi materiale dhe penale se oferta paraqitet si e pavarur pa marrëveshje me pjesëmarrësit tjerë në shpalljen publike dhe e cila është në kundërshtim me nenin 24 të këtij ligji, se nuk është person i lidhur në kuptim të personave të lidhur juridik, personave të lidhur fizik, person fizik me person juridik ose indirekt persona të lidhur në person juridik dhe

-deklarata të vërtetuar në noter se nuk ka qenë themelues ose person përgjegjës në personin juridik që ka shfrytëzuar tokë bujqësore në pronësi të shtetit me qira dhe e cila nuk i ka plotësuar detyrimet nga ajo marrëveshje.

Dokumentacioni i nevojshëm dorëzohet në origjinal ose fotokopje të vërtetuar në noter.

Formulari për pjesëmarrje në shpalljen publike (oferta) duhet të plotësohet tërësisht me të gjitha të dhënat e nevojshme, në të kundërtën oferta **nuk do të merret parasysh**.

IV. KRITERET PËR ZGJEDHJEN E OFERTUESIT MË TË VOLITSHËM

Zgjedhja e ofertuesit më të volitshëm në procedurën sipas shpalljes publike për dhënie me qira të tokës bujqësore në pronësi të shtetit deri në 3 hektarë bëhet në pajtim me Rregulloren për kriteret më të përafërta për zgjedhje të ofertuesit më të volitshëm të tokës bujqësore në pronësi të shtetit që mund jepet me qira dhe përcaktimin e madhësisë së sipërfaqes të tokës bujqësore që mund të jepet me qira ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë 12/08, 26/12, 2/13, 158/13, 110/15, 120/15,129/15 dhe 27/16). edhe atë në bazë të kriterëve në vijim:

- largësia nga vendbanimi, respektivisht qëndrimi i ofertuesit në raport me tokën bujqësore e cila ofrohet në shpalljen publike– 65 pikë;
- qiramarrja e ofruar vjetore për hektar– 25 pikë;
- statusi juridik i ofertuesit– 10 pikë.

Kriteri largësi nga vendi i jetesës, respektivisht vendbanimi i ofertuesit në raport me tokën bujqësore e cila ofrohet në shpalljen publike do të thotë se largësia nga vendi i jetesës, respektivisht selia e ofertuesit në raport me parcelën kadastrale që shpallet ndodhet në komunë të njëjtë kadastrale dhe vlerësohet me pikë maksimale të pikëve. Nëse ofertues është filiali i personit juridik vendas merret parasysh selia e personit juridik i cili e ka themeluar filialin.

Kriteri statusi juridik i ofertuesit fitohet me numër maksimal të pikëve për ofertues që është kryerës i regjistruar i veprimtarisë bujqësore ose i siguruar në Fondin për sigurim pensional dhe invalidor si bujk individual, tregtar individual ose subjekte juridike që përbushin kushtet nga neni 24 i Ligjit për tokë bujqësore.

Sipërfaqja maksimale për të cilën mund të aplikojë një ofertues nuk mund të jetë më e madhe se 3 hektarë, as më e vogël madhësia e një parcele kadastrale gjegjësisht blloku.

V. ÇMIMI FILLESTAR

Çmimi fillestar për hektar në procedurë sipas shpalljes publike përcaktohet varësisht nga klasa kadastrale dhe vendndodhja e tokës.

Çmimi fillestar për hektar në procedurë sipas shpalljes publike për sipërfaqe deri në 3 hektar është 25 euro në kundërvlerë denar për tokën bujqësore të klasës kadastrale prej I deri në IV dhe 15 euro në kundërvlerë denarë për tokën bujqësore të klasës kadastrale prej V deri në VIII, sipas kursit mesatar të Bankës popullore të Republikës së Maqedonisë në ditën e pagesës.

Nëse toka bujqësore gjendet në rajonin malor, çmimi fillestar i tokës së klasës kadastrale prej I deri në IV do të jetë 15 euro, ndërsa për tokën prej klasës V deri në VIII do të jetë pesë euro në kundërvlerë denarë, sipas kursit mesatar të Bankës popullore të Republikës së Maqedonisë në ditën e pagesës.

Nëse lëndë e shpalljes publike është bllok me kufij natyror i formuar nga më shumë parcela kadastrale me klasë të ndryshme kadastrale ose tërësi gjeografike e përbërë prej më shumë blloqeve me kufij natyror, përcaktohet çmim fillestar mesatar për hektar në proporcion me sipërfaqen e parcelave kadastrale me klasë të ndryshme kadastrale që e përbëjnë bllokun me kufij natyror, gjegjësisht tërësinë gjeografike të përbërë nga më shumë blloqe me kufij natyror.

VI. FORMULARI PËR PJESËMARRJE NË SHPALLJEN PUBLIKE (OFERTA)

Formulari për pjesëmarrje në shpalljen publike (oferta), mund të merret në Ministrinë e bujqësisë, pylltarisë dhe ekonomisë së ujërave njësiti rajonale të Ministrisë ose nga ueb faqja e Ministrisë dhe i njëjti duhet të plotësohet me të gjitha të dhënat e duhura dhe të dorëzohet me dokumentacionin e duhur në zarf të mbyllur, në të kundërtën oferta nuk do të shqyrtohen.

Ofertat të cilat nuk e përmbajnë dokumentacionin e plotë të duhur, e dorëzuar në origjinal apo kopje të vërtetuar në noter, ofertat që janë dorëzuar pas kalimit të afatit për dorëzim, zarf me shenjë e cila mund ta identifikojë ofertuesin,, oferta më të vogla se vlera më e vogël e qirasë vjetore, janë të dorëzuar nga person që nuk ka të drejtë të dorëzojë oferta, si dhe ofertat të cilat nuk janë të përpiluara sipas kushteve të vërtetuara në shpalljen publike, refuzohen si të pa kompletuara.

Ofertuesi i cili nuk është i kënaqur me zgjedhjen e realizuar në shpalljen publike mund në afat prej 15 ditë nga dita e pranimit të vendimit, të ngre procedurë para organit kompetent gjyqësor.

Ofertat tek të cilat komisioni do të vërtetojë se:

- nuk përmbajnë tërë dokumentacionin e nevojshëm;
- janë dorëzuar pas afatit të caktuar për tu dorëzuar;
- janë të dorëzuara në zarf të shënuar me të cilin do të mundej të identifikohet ofertuesi;
- janë të parashtruara nga personi që nuk ka të drejtë të parashtrroj oferta dhe
- nuk janë hartuar sipas kushteve të caktuara në thirrjen publike

komisioni i hedhë si të pakompletuara.

Oferta e cila do të dorëzohet me qira më të ulët të ofruar se qiraja minimale e përcaktuar në pajtim me Ligjin për tokë bujqësore nuk do të shqyrtohet dhe Komisioni do ta hedhë si të palësuar.

Ofertat e pakompletuara dhe të dorëzuara pas afatit në lidhje me thirrjen publike **nuk do të shqyrtohen**.

Kushtet e parapara në biznes planin (për personat juridik), respektivisht aspektet e tregut (te personat fizik) do të jenë pjesë përbërëse e marrëveshjes me ofertuesin e zgjedhur si obligime kontraktuale të cilat obligohet ti përmbush në vëllimin, afatet dhe mënyrën se si do të jenë të përshkruara në shpalljen publike.

Secili ofertues mund të parashtrrojë vetëm një ofertë origjinale për pjesëmarrje në shpalljen publike me dokumentacionin 3e nevojshëm nga pjesa II e kësaj shpallje publike.

Marrëveshja për qira e lidhur me ofertuesin e zgjedhur më të volitshëm futet në fuqi me ditën e futjes së pronësisë së qiramarrësit ndaj tokës bujqësore lëndë e marrëveshjes nga ana e qiradhënësit edhe atë vetëm për sipërfaqet për të cilët është futur në pronësi faktike.

VII. DORËZIMI I OFERTËS

Oferta dhe dokumentacioni tjetër i nevojshëm parashtrrohen në zarf të mbyllur në të cilin në pjesën e epërme të majtë duhet të shënojë "mos hap" "Ofertë në sipas Shpalljes publike 07/18 për tokë bujqësore me qira për sipërfaqe deri në 3 hektarë sipas rajonit (shënohet rajoni) dhe në mes "Ministria e bujqësisë, pylltarisë dhe ekonomisë së ujërave rr. Aminta Treti nr. 2 Shkup" në afat prej 30 ditëve nga dita e publikimit të shpalljes publike në gazetën ditore.

Zarf nuk duhet të përmbajë asnjë shenjë që do të mund të identifikojë ofertuesin, gjegjësisht dërguesin.

Ofertat e parashtruara në lidhje me këtë shpallje publike nr. 07/18 do të hapen publikisht në ditën e tretë të punës duke konsideruar nga dita e fundit për parashtrim të fletparaqitjeve për pjesëmarrje në shpalljen publike.

Hapja publike do të mbahet në sallën e madhe të takimeve në Ministrinë e bujqësisë, pylltarisë dhe ekonomisë së ujërave rr. Aminta Treti" nr. 2 Shkup me fillim në ora 10.

VIII. INFORMATA PLOTËSUESE

Për informata plotësuese ofertuesit mund të kontaktojnë në Ministrinë e Bujqësisë, pylltarisë dhe ekonomisë së ujërave në njësitë rajonale, të vizitojnë ueb faqen e Ministrisë www.mzsv.gov.mk ose në Sektorin për regjistrim dhe menaxhim me tokë bujqësore në telefonin: **02 313 44 77**.

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS

Shërbimi pedagogjik

Në bazë të nenit 16 paragrafi 1 të Ligjit për tekstet shkollore për arsim fillor dhe të mesëm ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 98/08, 99/09, 83/10, 36/11, 135/11, 46/12, 24/13, 120/13, 29/14, 146/15, 217/15, 30/16 dhe 21/18), drejtori i Shërbimit pedagogjik, publikon:

SHPALLJE PUBLIKE për recensentë të teksteve shkollore

1. Porositës: Ministria e Arsimit dhe Shkencës – Shërbimi pedagogjik, rr. "Sv. Kiril i Metodi" nr. 54- Shkup.

2. Publikohet Shpallje publike për recensentë në lidhje me lëndën:

- Gjuhë boshnjake për klasën e I të arsimit fillor nëntëvjeçar

3. Recensentët e paraqitur duhet të përmbushin kushtet në vijim:

- të jenë mësimdhënës nga fakultetet mësimdhënëse për lëndën mësimore për të cilin dedikohet teksti shkollor dhe me së paku 10 vjet përvojë pune në mësim dhe

- të jenë mësimdhënës nga shkolla fillore gjegjësisht e mesme përkatëse për lëndën mësimore për të cilin dedikohet teksti shkollor dhe me së paku 10 vjet përvojë pune në mësim.

Kandidatët e interesuar së bashku me fletëparaqitjen obligohen të parashtrojnë:

- certifikatë ose diplomë për arsimin e mbaruar përkatës në origjinal ose kopje të vërtetuar në noter (kandidatët të cilët kanë mbaruar arsimin jashtë vendit obligohen që të parashtrojnë diplomë të nostrifikuar nga Republika e Maqedonisë),

- deklaratë se i përmbushin kushtet në pajtim me nenin 11 të Ligjit për tekstet shkollore për arsim fillor dhe të mesëm.

- pasqyrë të të dhënave të regjistruara në evidencën amë të Fondit për sigurim pensional dhe invalidor të Maqedonisë

- vërtetim nga institucioni ku është punësuar.

Fletëparaqitja mund të merret nga ueb faqja e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës ose të merret në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës – Shërbimi pedagogjik, rr. Kiril i Metodi nr. 54, Shkup.

Fletëparaqitjen e plotësuar në rregull së bashku me tërë dokumentacionin parashtrohen në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës – Shërbimi pedagogjik në rr. Kiril i Metodi nr. 54, Shkup.

Afati përfundimtar për parashtrimin e fletëparaqitjeve është 14.09.2018.

Fletëparaqitjet e pakompletuara dhe të parashtruara pas afatit nuk do të shqyrtohen.



REPUBLIKA E MAQEDONISË
AGJENCIA E ADMINISTRATËS

Në bazë të nenit 35 të Ligjit të Nëpunësve Administrativë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 27/14, 199/14, 48/15, 154/15, 5/16, 142/16 dhe 11/18) dhe Rregullores së mënyrës së zbatimit të procedurës për punësim të nëpunësve administrativë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 27/18), lidhur me nenin 20-g të Ligjit të punësuarve në sektorin publik („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 27/14, 199/14, 27/16 dhe 35/18) dhe Rregullores së elementeve të obligueshme të shpalljes publike të plotësimit të vendit të punës në sektorin publik përmes punësimit dhe fletëparaqitjes për punësim, si dhe të formës, përmbajtjes dhe mënyrës së mbajtjes së regjistrit të personave që kanë dhënë të dhëna të rrejshme gjatë punësimit në sektorin publik („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 34/15), Agjencia e Administratës publikon

SHPALLJE PUBLIKE NUMËR – 171/2018

për punësimin e 1 nëpunës publik nga grupi I, nëngrupi II në „Institucionin Shkencor Publik Instituti i Kulturës së Vjetër Sllave Prilep” për vendet e punës në vijim:

1. OBN 0102V04002 Bashkëpunëtor më i ri për burime njerëzore, Sektori për punë të përgjithshme, juridike, profesionale-administrative dhe punë kontabiliste-financiare 1 realizues(ë)

Kushtet e përgjithshme:

- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- Ta njohë mirë gjuhën maqedonase,
- Të jetë i moshës madhore,
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës,
- Me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënime ndalese për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

Kushtet e posaçme:

- niveli i kualifikimeve VI B sipas komizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 180 kredi sipas ECTS ose të kryer shkallën VII/1, Shkencat Juridike
- me ose pa përvojë pune

Kompetencat e përgjithshme:

- zgjidhje të problemeve dhe marrje të vendimeve për çështje të sferës së tij
- mësim dhe zhvillim
- komunikim
- arritje të rezultateve
- puna me të tjerë/puna ekipore
- ndërgjegjësim strategjik
- orientim kah palët/palët e interesuara; dhe
- menaxhim financiar

Kompetenca të posaçme:

- njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë
- njohje aktive të një prej gjuhëve më të foltura të Bashkimit Evropian (anglisht, frengjisht, gjermanisht)

Orari i punës :

- Ditët e punës e hënë-e premtë
- Orët javore të punës 40
- Orari ditor i punës 07:00 - 15:00
- Rroga neto: 21.912,00 denarë

VËREJTJE: Sipas planit vjetor për punësim në institucionin përkatës për vitin 2018 janë të parapara: Maqedonas(e) 1.

Kushtet e lartpërmendura në shpallje kandidatët duhet t'i plotësojnë në momentin e aplikimit në formë elektronike nëpërmjet profilin të përdoruesit të krijuar në faqen e internetit të Agjencisë së Administratës.

Afati i aplikimit zgjatë 15 ditë, duke llogaritur nga dita e publikimit të shpalljes. Pas mbarimit të afatit për aplikim, shpallja do të jetë e larguar nga faqja e internetit e Agjencisë.

Pas kalimit të afatit të aplikimit, shpallja do të jetë e hequr nga faqja e internetit e Agjencisë.

Kandidatëve u kërkohet fletëparaqitjen ta plotësojnë në tërësi, të jenë precizë dhe të japin të dhëna të sakta. Kandidatët e paraqitur në shpalljen publike në faqen e internetit të Agjencisë së administratës do të informohen, për kohën dhe vendin e mbajtjes së çdo faze të ardhshme të procedurës për selektim të nëpunësit administrativ.

Faza e 1 – të: selektimi administrativ realizohet në një afat prej 15 ditësh pas mbarimit të shpalljes së publikuar.

Faza e 2 – të: provimi i nëpunësit administrativ realizohet në një afat jo më të shkurtër se 10, dhe jo më të gjatë se 30 ditë pas mbarimit të fazës së 1 – të. Ai inicohet dhe emetohet drejtpërdrejtë në faqen e internetit të Agjencisë së administratës.

Faza e 3 – të: kontrollimi i vërtetësisë së provave dhe intervista realizohet në një afat prej 10 ditësh pas mbarimit të fazës së 2 – të.

Në bazë të nenit 13 paragrafi 1 dhe 2 e vendimit për kushtet dhe mënyrën e dhënies me qira të pronës së patundshme në pronësi të Qytetit të Shkupit nr. 07-7450/1 të datës 30.10.2014 "Gazeta Zyrtare e Qytetit të Shkupit" nr. 12, ndërsa në pajtim me Vendimin për kushtet dhe mënyrën e dhënies me qira të pronës së patundshme në pronësi të Qytetit të Shkupit, ndërsa shfrytëzues i së cilës është SHMQSH "Zef Lush Marku" – Shkup, në pajtim me vendimin e sjellë nga Këshilli i shkollës së SHMQSH "Zef Lush Marku" – Shkup nr. 02-216/3 të datës 10.04.2018 dhe Pajtimin nga Kryetari i Qytetit nr. 08-4351/2 të datës 10.07.2018, SHMQSH "Zef Lush Marku" – Shkup publikon

Shpallje 01-2018

Për dhënie me qira të hapësirës së shkollës në katin përdhës për kryerje të veprimtarive hotelerike – bufë përmes ankandit publik

- Qiradhënësi:**
SHMQSH "Zef Lush Marku" – Shkup, me seli në rr. Llazo Trpovski pn Shkup, tel. 02 2634-312, faks 02 2634-311
- Ofertues:**
Të drejtë për të parashtruar kërkesë për qira të hapësirës së theksuar shkollore ka secili subjekt i interesuar juridik i cili është i regjistruar për kryerje të veprimtarisë në pajtim me lëndën për qira.
- Lënda për qira:**
3.1 Hapësirë në katin përdhës të shkollës për kryerje të veprimtarisë hotelerike – bufë me sipërfaqe prej **15,80 m2**
- Çmimi fillestar:**
4.1 Çmimi fillestar i ankandit publik për hapësirën e theksuar nga pika 3.1 është 5 euro për metra katror, në kundërvlerë denarë pa TVSH të përlogaritur sipas kursit mesatar të BPRM, plus shpenzimet materiale, ngrohje për m2, ujë-ujëmatës, rrymë me numëruar.
- Afati dhe mënyra e dorëzimit të dokumenteve:**
5.1 Shpallja për dhënie me qira të hapësirës së shkollë zgjatë 15 ditë nga dita e publikimit të saj.
5.2 Ofertat dhe dokumentet të dorëzohen në zafi të mbyllur me shenjë "mos hap" dhe me shenjë "për shpallje për dhënie me qira të pronës së patundshme" dhe numri i shpalljes. Dokumentet e nevojshme dorëzohen përmes postës në adresën rr. "Llazo Trpovski" pn, ose në arkivin e shkollës deri sa të zgjasë shpallja prej ora 09:00 deri në ora 14:00.
5.3 Oferta e cila nuk përmban dokumentet e nevojshme do të konsiderohet si e pakompletuar dhe si e tillë nuk do të shqyrtohet
5.4 Dokumentet e dorëzuara në shpallje nuk do të kthehen.
- Koha e fillimit dhe kohëzgjatja e ankandit publik:**
Ankandi publik do të fillojë më datë **19.08.2018** në ora 10, në lokalet e shkollës në kohëzgjatje prej një orë.
- Kushtet për pjesëmarrje në shpallje dhe dokumentacioni i domosdoshëm:**
Pjesëmarrësit në shpallje për ankandin publik me ofertën duhet të dorëzojnë edhe dokumentacionin në vijim
a) për subjektet juridike
-dokument për veprimtaritë të regjistruar, jo më të vjetër se 6 muaj
-vërtetimi për procedurë falimentimi, në origjinal ose kopje të vërtetuar në noter jo më të vjetër se 6 muaj të dhënë nga organi kompetent
-certifikatë për bilancin e gjendjes dhe të dhënat për bilancin e suksesit, në origjinal ose kopje të vërtetuar në noter jo më të vjetër se 6 muaj të dhënë nga organi kompetent
-certifikatë për tatime dhe kontribute të paguara, në origjinal ose kopje të vërtetuar në noter jo më të vjetër se 6 muaj të dhënë nga organi kompetent
-fletëpagesë për depozitë të paguar
Në ankandin publik përfaqësuesi i subjektit juridik duhet të dorëzojë letërnjoftim ose pasaportë dhe autorizim të vërtetuar në noter, ndërsa personi përgjegjës duhet të dorëzojë letërnjoftim ose pasaportë dhe dëshmi për cilësinë e tij në subjektin juridik.
b) për subjektet fizike
-numri i llogarisë transaksionale
-fletëpagesë për depozitë të paguar
Në ankandin publik përfaqësuesi i subjektit fizik duhet të dorëzojë letërnjoftim ose pasaportë dhe autorizim të vërtetuar në noter, ndërsa subjektin fizik duhet të dorëzojë letërnjoftim ose pasaportë.
8. **Depozitë**
8.1 Depozita për pjesëmarrje në ankandin publik është 5% nga çmimi i përgjithshëm fillestar për tërë sipërfaqen, në euro në kundërvlerë denarë sipas kursit mesatar të BPRM, i cili duhet të paguhet në ditën e përfundimit të llogarisë 785010400678716, shifra e të hyrave 723019, programi H2
8.2 Paga e realizuar pas kalimit të afatit llogarit si e vonuar dhe personat që kanë realizuar pagesë të vonuar në pajtim me afatin e caktuar nuk kanë të drejtë të marrin pjesë në ankandin publik.
8.3 Depozita e ofertuesve të cilat nuk kanë marrë statusin e ofertuesit më të volitshëm do të kthehet në tërësi në afat prej 15 ditëve nga dita e mbajtjes së ankandit publik, ndërsa depozita e ofertuesit më të volitshëm i kthehet i zvogëluar prej 10% në afat prej 15 ditëve nga dita e pagesës të qirasë së parë.
9. **Mënyra e realizimit të ankandit dhe zgjedhjes së ofertuesit më të volitshëm:**
9.1 Ankandi publik mund të fillojë me së paku një pjesëmarrës në ankandin publik i cili plotëson kushtet e theksuara në shpallje dhe e ofron çmimin fillestar.
9.2 Pjesëmarrësi i cili ka ofruar çmimin më të lartë merr statusin ofertues më i volitshëm
9.3 Komisioni pas ankandit të realizuar publik cakton ofertuesin më të volitshëm dhe propozimin e dorëzon deri tek drejtori i shkollës.
10. **Kohëzgjatja e qirasë.**
10.1 Hapësira jepet me qira për periudhë prej 1 vit.
10.2 Marrëveshja me ofertuesin më të volitshëm nënshkruhet në afat prej 5 ditëve pas pëlqimit të marrë nga Kryetari i Qytetit të Shkupit.
10.3 Nëse ofertuesi më i volitshëm nuk lidh marrëveshje, depozita e paguar nuk i kthehet.
10.4 Qiramarrësi është i obliguar që në llogari të tij të sigurojë të gjitha pëlqimet e nevojshme – lejet nga ana e organeve kompetente.
10.5 Qiramarrësi është i obliguar në realizimin e veprimtarisë së tij të mos pengojë funksionin, ecurinë dhe kualitetin e veprimtarisë edukativo-arsimore në shkollë.
10.6 Shpenzimet për mirëmbajtjen e vazhdueshme të hapësirës afariste nuk futen në qira gjegjësisht të njëjtat bien mbi barrën e qiramarrësit.
10.7 Qiramarrësi është i obliguar që të paguajë depozitë prej 500 euro në kundërvlerë denarë për mbulimin e dëmit të supozuar që mund të shkaktohet gjatë përdorimit të hapësirës në afat prej tre ditëve të punës nga dita e lidhjes së marrëveshjes dhe i njëjti do të kthehet tërësisht në afat prej 15 ditëve pas kalimit të marrëveshjes.

SHQSH "Zef Lush Marku" – Shkup

Komuna e Kërçovës

Në bazë të Ligjit për Taksa komunale ("Gazeta zyrtare e RM-së" nr. 61/2004, 64/05, 92/07, 123/12, 154/15 dhe 192/15,dhe 23/2016), përderisa në pajtim me Ligjin për procedurë të përgjithshme administrative ("Gazeta zyrtare e RM-së" nr. 38/05, 110/08, 51/11, 145/15), Kryetari i Komunës shpall:

THIRRJE PUBLIKE

Për të gjithë personat juridikë që kanë seli të firmës ose përfaqësisë në territorin e Komunës së Kërçovës, ndërsa për të cilët nuk është kryer dorëzim i rregullt i Aktvendimeve për vitin 2018, informohen që t'i ndërmarrin hapat vijuese:

1. Firmat që kanë seli ose përfaqësi në territorin e Komunës së Kërçovës, ndërsa për të cilat nuk është kryer dorëzim në rregull i Aktvendimit për TK, gjegjësisht titull i hapësirave afariste janë të obliguar që t'i marrin aktvendimet për TK, gjegjësisht titull të hapësirave afariste për vitin 2018, në hapësirat e Komunës së Kërçovës.

2. Obligimet në pajtim me Aktvendimin për TK, gjegjësisht titull i hapësirave afariste jeni të obliguar të bëni shlyerjen e obligimeve që janë të parapara me të njëjtin.

Obligimet mund t'i paguani në fletëpagesat vijuese:

Pranues	Llogaria e thesarit
Banka e pranuesit	Banka popullore e RM-së
Llogaria	10000000063095

Nr. rend.	Lloji i tatimit	Llogaria e pagesës	Shifra e të ardhurave
1.	Për titull të hapësirave afariste	840-134-03210	717112
2.	Për njësi afariste	840-134-03210	717112

Kjo thirrje hyn në fuqi me ditën e shpalljes dhe llogaritet se pala është e njohur me shkrim për punën juridike. Për pasojat negative (pagesa e kundërvullnetshme, dënim me mjete financiare, shpenzime shtesë etj.), që eventualisht mund të shkaktohen, do të duhet t'i bartë vetë pala.

Në qoftë se keni realizuar pagesë, ndërkaq ende nuk janë të evidentuara, ose duhet të vijojë nivelizimi i tyre mbi bazën e tatimit, Ju lutemi që të drejtoheni në Komunën e Kërçovës, Njësia për Tatim dhe Taksa komunale, zyra nr. 22, për të dorëzuar provë për pagesën e realizuar, ose na kontaktoni në e-mail adresën vijuese:

Rr. "Boris Kidriç" nr.1

E-mail: kercova2013@yahoo.com

Nëse do të sundosh shqiptarët, manipulo ndërkombëtarët



Nga
Fatos LUBONJA

Në të njëjtën ditë kur mësuam se Kryeministri ynë, pasi ka mbyllur me nxitim mbledhjen e qeverisë, paska marrë një helikopter Vlorë - Rinas dhe pastaj një charter Rinas-Torino për të parë ndeshjen Juventus-Lazio e për të bërë një fotografi me Ronaldon, mësuam edhe se qeveria na paska vendosur të bëhet zgjidhëse e krizës Itali-BE rreth emigrantëve të anijes "Diciotti". Ajo paska vendosur të marrë në Shqipëri 20 nga 170 emigrantët e lënë në det nga ministri i Brendshëm italian Salvini, ndaj të cilit, për këtë, Prokuroria e Agrigentos ka lëshuar akuzën për sekuestrim personash.

Salvini ishte i pari që e dha lajmin, duke falënderuar Shqipërinë, të cilën ia kundërvuri një Europë që "fa schifo" (të bën për të vjellë) sipas tij. "Bravo Albania", - thanë shumë italianë. Por, po të dëgjosh analistë që flasin për krizën e shkaktuar nga Salvini, shumica pajtohen në mendimin e Europës se Italia nuk ka një alarm emigracioni, sepse zbarkimet në brigjet italiane janë ulur shumë, se ka shumë më tepër zbarkime në Greqi dhe në Spanjë - duke shtuar se këtë alarm Salvini e ka si kalë beteje elektorale. Rastin në fjalë, sipas së përditshmes "Il Fatto Quotidiano", ai e përdori për t'i rrëmbyer skenën mediatike partnerit kundërshtar në qeveri, Cinque Stelle, që ia kishte rrëmbyer me rastin e tragjedisë së urës "Morandi" në Genova. Analistët seriozë italianë thonë po ashtu, se alarmet e vërteta të Italisë janë të tjera nga alarmi emigracioni; janë alarme që kërkojnë një punë serioze të qeverisë dhe jo fushata elektorale permanente, që mbulojnë paaftësinë për t'u marrë seriozisht me alarmet e vërteta dhe për t'i zgjidhur ato.

Dhe ja ku dalim te Kryeministri ynë dhe vendi ynë. Po ai, pse e mori dhe si e mori këtë vendim? Italianët jo, por ne që e njohim siç njohin ata Salvinin, e dimë se e mori për të mbuluar alarmet e vërteta që ka Shqipëria, ndër të cilët, paradoksisht, kryesori lidhet me faktin se në qeverinë Rama, që po pret emigrantë, numri i shqiptarëve që braktisin vendin ka një rritje dramatike. Ashtu si Salvini, edhe ai po manipulon me dramën e emigrantëve eritreas. Por midis manipulimeve të Salvinin dhe atyre të Ramës ka një diferencë interesante. Salvini manipulon drejt, Rama me spond. Salvini synon të manipulojë italianët kundër Europës, duke shfrytëzuar pakënaqësitë e akumuluar prej tyre gjatë viteve sikur fajin ua ka Europa, kurse Rama synon të manipulojë ita-

lianët dhe europianët për të manipuluar pastaj shqiptarët sipas parimit: nëse do të sundosh shqiptarët, manipulo ndërkombëtarët. Ç'kuptoje me këtë? Duke ndjekur në "Facebook"-un e ministrit Bushati komentet e lajmit, nuk mund të mos të të binte në sy ndarja midis italianëve dhe shqiptarëve. Italianët falënderonin për solidaritetin, kurse shumica e shqiptarëve e konsideronin një akt "hipokrizie". Një komentues shkruante: "Nuk bën fare sens logjik që ju të ofroni ndihmë për emigrantët e huaj, ndërkohë që me dhjetëra bashkëkombës lënë Shqipërinë çdo ditë. Dhe mos thoni se ata e lënë Shqipërinë nga zgjedhja e tyre personale. Ju e dini shumë mirë se ata ikin sepse Shqipëria ua ka kështu shpresat me të madh e me të vogël, sepse kanë një të ardhme të pashpresë e të mbytur me skamje, shtypje e padrejtësi". Një tjetër i përmendte Bushatit fëmijët shqiptarë, që prindërit i braktisin qëllimisht në Itali dhe që po i mbajnë Caritaset italiane, duke i bërë thirrjen: "Lëri fasadat e shikoje realitetin në sy... mos u bëni gazi i botës!" Ishin të shumta edhe komentet e papranueshme raciste kundër sjelljes në Shqipëri të të zinjve, dhe, duke e ditur se shqiptarët janë më racistë se italianët në këtë drejtim, nuk është vështirë të mendosh se jashtë "Facebook"-ut këta janë

edhe më të shumtë. Megjithatë, Rama nuk e përfill elektoratin që përfaqësojnë gjithë këta komentues. Si ka mundësi, do të pyeste dikush. Sepse Edi Rama vazhdon të aplikojë parimin: nëse do të sundosh shqiptarët, manipulo ndërkombëtarët, të cilin e ka çuar në shkallën më të lartë të suksesit. Ai vazhdon të mendojë se kompleksi i inferioritetit të provincialit, kombinuar me mungesën e besimit në institucionet dhe elitën e vendit, i bën shqiptarët të përlulen përpara vlerësimit të të huajve, i bën kundërshtarët të mbyllin gojën dhe dyshuesit të anojnë nga zgjedhja ndërkombëtare. Kështu, ai mendon se ky akt do të ushqejë imazhin, për të cilin ka kohë që punon në Itali, se nga vend eksportues emigracioni, Shqipëria është kthyer në vend pritës emigracioni (madje dhe italianësh). Të nesërmen e lajmit, "Corriere della Sera" vërtetoi se ky manipulim funksionon, paçka se mediat franceze, gjermane, holandeze e jo vetëm kanë kohë që shkruajnë për azilkërkuesit e panumërt shqiptarë në rritje (Che schifo da vero këto mediat italiane). Pastaj, imazhi i rremë i Shqipërisë që ka ndryshuar mund ta ndihmojë në hapjen e negociatave dhe gjithë ky vlerësim do t'i mbulojë alarmet e vërteta të Shqipërisë, të cilat manipulatori jo nuk mund, por


A do të ketë sukses manipulimi me këta gjynahqarë që, në vend se në Perëndim, do ta shohin veten në një nga vendet me numrin më të madh të azilkërkuesve në vendet Perëndimore (që tani do të kenë një motiv më shumë për t'i kthyer azilkërkuesit shqiptarë), më raciste ndaj të zinjve dhe krejt jashtë standardeve europiane? Ndoshta edhe po, por edhe dyshoj sepse më duket se qoftë brenda, qoftë jashtë vendit "rrogozi" i Ramës: 'manipulo ndërkombëtarët për të sunduar shqiptarët', po fut shumë ujë, shumë



nuk do t'i zgjidhë, pasi zgjidhja e tyre kërkon largimin e tij dhe të njerëzve të kimit rreth tij nga push-teti. A do të ketë sukses manipulimi me këta gjynahqarë që, në vend se në Perëndim, do ta shohin veten në një nga vendet me numrin më të madh të azilkërkuesve në vendet Perëndimore (që tani do të kenë një motiv më shumë për t'i kthyer azilkërkuesit shqiptarë), më raciste ndaj të zinjve dhe krejt jashtë standardeve europiane? Ndoshta edhe po, por edhe dyshoj sepse më duket se qoftë brenda, qoftë jashtë vendit "rrogozi" i Ramës: 'manipulo ndërkombëtarët për të sunduar shqiptarët', po fut shumë ujë, shumë.

(Panorama)

KOHA PËR KARIKATURËN E DITËS



Themelues: Arben Ratkoceri dhe Lirim Dullovi

Botues: Koha Production SHPK | Adresa e botuesit dhe redaksisë: Bul. Goca Delçev nr.11, | Q.T. Mavrovashja lok.14 - përdhës, Shkup | Gazetë ditore - botohet çdo ditë përveç të dielës | Shtypi dhe distribuimi: "Adria Media Balkan" - rr. 852 nr.62, Shkup, 5000 kopje | Data e shtypjes e martë 4 shtator | Numri i parë i gazetës doli më 22 Nëntor 2006
Drejtor: Lirim DULLOVI | Kryeredaktor: Vedat MEMEDALIU | Redaktor përgjegjës: Emin AZEMI | Ndihmëskryeredaktor: Evis HALILI | Redaktor teknik: Halil BERISHA
E-mail: koha@koha.com.mk | Tel: 02 3179 - 904; Tel: 02 3179 - 905; Tel: 02 3179 - 906; Fax: 02 3118 - 060; | MARKETING: Bekim SHAQIRI • marketing@koha.com.mk; Tel: 02 3179-904; Mob: 071 372 222 | Përgjegjës për distribuim: Afrim DULLOVI - Tel: 071 372 221
Përfaqësues ligjor: Shtëpia e avokatëve Inter Partes - Shkup

NPK "Koha Production" Num. i xhironlogarisë: 210063340670177; Tutunska Banka -Shkup; Numri tatimor 4030008022772

BETEJA E IDLIBIT. Masakër mbi katastrofën 7-vjeçare në Siri

Nga Margaret Coker,
Hwaida Saad and Carlotta Gall

Në terren, qeveria siriane po grumbullon mijëra rekrutë për të forcuar forcat e saj të dobësuar. Në det, një flotilje detare ruse është shumë pranë brigjeve, gati për të ndërhyrë me një forcë të jashtëzakonshme në rast nevojë. Ndërkohë, në provincën e Idlibit, miliona civilë i frikësohen asaj që mund t'iu ofrojë e ardhmja e afërt.

Palët ndërluftuese në luftën civile tejet të gjatë dhe të pamëshirshme po përgatiten për një tjetër ofensivë brutale, e ndoshta kjo mund të jetë e fundit. Sulmi kanosës në provincën e Idlibit është ajo që qeveria në Damask shpreson t'i japë goditjen e fundit ushtarake luftëtarëve rebelë dhe mbështetësve të tyre mes civilëve, të cilët u ngritën mbi 7 vite më parë me kërkesën për ndryshimin e regjimit. Por, aty ku Siria dhe aleatët e saj, Rusia e Irani, shohin një mundësi për të rrëmbyer kontrollin e pozicioneve të fundit të rebelëve, udhëheqësit perëndimorë paralajmërojnë për një fatkeqësi humanitare në Idlib, ku besohet të jetojnë rreth 3 milionë civilë.

Shumë prej civilëve të gjendur tashmë në Idlib janë zhvendosur nga pjesë të tjera të Sirisë, duke ia mbathur brutalitetit të forcave qeveritare të presidentit Bashar al-Assad. Dhjetëra mijëra madje u zhvendosën atje me autobusë, si pjesë e marrëveshjeve për dorëzim me qeverinë. Ofensiva e afërt qeveritare, ndaj atyre që besohet të jenë rreth 30 mijë luftëtarë rebelë, është një "stuhë perfekte që po shfaqet para syve tanë", tha i dërguari special i Kombeve të Bashkuara në Siri, Staffan de Mistura.

Turqia gjithashtu ka shprehur shqetësim të thellë mbi sulmin, mes frikës se do të mbajë barrën e fatkeqësisë humanitare dhe të sigurisë. Ankaraja ka dërguar trupa në terren në Idlib, me synimin për të ndarë forcat siriane nga ato rebelë, por ushtarët turq mund të gjenden në mesin e stuhisë ofensive. Turqia aktualisht mban mbi 3 milionë refugjatë nga lufta civile, e duke pasur parasysh krizën ekonomike dhe pakënaqësinë në rritje kundër sirianëve që ka në vend, vështirë se do të pranojë të tjerë. Gjatë vizitës së fundit në Moskë, ministri i Jashtëm turk, Mevlut Cavusoglu bëri thirrje për më shumë kohë ndaj një plani turk për negociata me rebelët në Idlib, përfshi edhe grupet islamike radikale. "Një zgjidhje ushtarake do të ishte fatkeqësi për atë vend", tha Cavusoglu në një konferencë për shtyp,



teksa qëndronte në krah të homologut të tij rus, Sergey Lavrov. "Të sulmohet Idlibin në tërësi për të eliminuar disa grupe radikale do të thotë të shkaktosh vdekjen e qindra mijëra njerëzve, e t'i lesh të pastrehë rreth 3.5 milionë njerëzit që jetojnë atje, sërish", shtoi Cavusoglu.

Përgjatë dy viteve të fundit, ushtria siriane, falë mbështetjes së fuqishme nga Rusia dhe Irani, ka marrë kontrollin e zonave të tëra të territorit të vendit. E teksa shumica e vendit është futur në "shinat" e forcave qeveritare, ato mund ta kthejnë vëmendjen bindshëm në Idlib. Nëse qeveria do t'ia dalë me sukses të marrë provincën, bastioni i fundit i madh i rebelëve, fitorja do të shënonte në thelb fundin e opozitës së armatosur brenda Sirisë. Por, vështirë se do të sinjalizonte fundin e konfliktit apo vuajtjeve të shkaktuara prej saj. Rreth një e katërta e vendit do të vijonte të ishte jashtë kontrollit qeveritar, ndërsa kontrolli i rivendosur në disa zona është ende i diskutueshëm, pasi kryengritësit e armatosur janë ende të aftë të ndër marrin sulme të vogla. Duke parë rrënimin infrastrukturor, miliona njerëz të zhvendosur dhe kontrollin e kurdëve në territorin në lindje të lumit Euftrat, lufta siriane mund të dojë ende shumë kohë për t'u zgjidhur, edhe nëse Idlibi bie në duart e qeverisë. Mposhtja e forcave rebelë

Edhe pse Rusia ka mohuar që këto manovra janë të lidhur me betejën e mundshme në Idlib, zyrtarët rusë kanë pasur një ton vrasës kur kanë folur mbi nevojën e ndërhyrjes në provincë. Lavrov, javën e kaluar e përshkroi Idlibin si një "ezkemë" që duhej të thahej. Presidenti turk, Recep Tayyip Erdogan do të takohet me homologët rusë e iranianë, Vladimir Putin dhe Hassan Rouhani, këtë të premte për të diskutuar mbi Sirinë, në raundin e fundit të diskutimeve të tyre mbi këtë temë në atë që njihet edhe si "Procesi i Astanës". Takimi pritet të jetë i fundit përpara një ofensive të mundshme



në Idlib pritet të "zyrtarizojë" barrën shkatërrimtare të viktimave mes civilëve, të cilët kanë duruar vuajtje nga më mizoret që prej shpërthimit të konfliktit në vitin 2011 në Siri. Më shumë se 350 mijë njerëz janë vvarë, ndërsa mbi 11 milionë kanë braktisur shtëpitë e janë larguar. Sulmi mbi Idlib do të ishte një "katastrofë e vetme mbi një luftë katastrofike", sipas grupit "Soufan", një kompani me seli në Nju Jork që ofron analiza sigurie për qeveritë dhe organizatat.

Sekretari amerikan i Shtetit, Mike Pompeo paralajmëroi për një katastrofë të shkallës së gjerë mbi civilët në Idlib. "Tre milionë sirianët që janë detyruar të braktisin shtëpitë dhe strehohen tashmë në Idlib do të pësojnë edhe më shumë nga ky agresion", shkroi ai në Tëitter gjatë së premtes. "Aspak mirë. Bota po vëzhgon!". Në një tjetër postim të së njëjtës ditë, Pompeo ftoi homologun e tij rus të mos mbështeste ofensivën e ardhshme. "Sergey Lavrov po mbron sulmin sirianor mbi Idlib, – shkroi ai. – Rusët dhe Assad ranë dakord të mos e lejonin këtë. Shtetet e Bashkuara e shohin këtë si përshkallëzim të një konflikti edhe kështu siç është tejet i rrezikshëm".

Departamenti i Shtetit paralajmëroi gjithashtu të premtën, përmes një deklarate, se "Shtetet e Bashkuara do t'i përgjigjeshin në mënyrë proporcionale ndonjë sul-

mi me armë kimike nga regjimi sirian". Pavarësisht thirrjeve ndërkombëtare, zyrtarët sirianë e rusë u panë gjatë fundjavës të përgatisnin hapur goditjen e forcave rebelë, ende aktive në provincën në fjalë. E ndërsa qeveria duhet ende të deklarojë një datë fillimi për ofensivën, ushtria siriane ka dërguar mijëra forca tokësore, si dhe dhjetëra njësi të blinduara përgjatë kufirit jugor me Idlibin. Në fundjavë, Rusia nisi edhe stërvitjen e fuqishme detare në Mesdhe, vetëm pak qindra milje nga linjat e mundshme të frontit, duke përfshirë 26 luftanije dhe mjete mbështetëse, sikurse edhe 36 avionë, përfshi bombarduesit strategjikë.

Edhe pse Rusia ka mohuar që këto manovra janë të lidhur me betejën e mundshme në Idlib, zyrtarët rusë kanë pasur një ton vrasës kur kanë folur mbi nevojën e ndërhyrjes në provincë. Lavrov, javën e kaluar e përshkroi Idlibin si një "ezkemë" që duhej të thahej. Presidenti turk, Recep Tayyip Erdogan do të takohet me homologët rusë e iranianë, Vladimir Putin dhe Hassan Rouhani, këtë të premte për të diskutuar mbi Sirinë, në raundin e fundit të diskutimeve të tyre mbi këtë temë në atë që njihet edhe si "Procesi i Astanës". Takimi pritet të jetë i fundit përpara një ofensive të mundshme.

(New York Times)



Verbëria mund të shërohet, shkencëtarët bëjnë zbulimin e madh

Për herë të parë në histori të njerëzimit, shkencëtarët kanë arritur t'ua rikthejnë shikimin minjve të verbëruar duke i shëruar qelizat në retinën e syve. Rreth tre milionë amerikanë kanë shikim tejet të dobët, ndërkaq 1.3 milionë janë krejtësisht të verbër. Numri i njerëzve që verbërohen nga degjenerimi makular si pasojë e moshës pritet të dyfishohet deri në vitin 2050, duke arritur shifrën prej 22 milionëve. Nëse ky trajtimi i ri që është zhvilluar rezulton i suksesshëm edhe të njerëzit, atëherë shumica e njerëzve do të mund ta rifitojnë shikimin e tyre. Këtë gjë shkencëtarët e Institutit Nacional të Shëndetësisë e kanë arritur duke e përdorur një injeksion gjenetik për t'i riprogramuar neuronet e mirëmbajtjes në struktura të cilat e pranojnë dritën në sy.



Mjekët: Prindërit i ulin gabimisht fëmijët në makinë

Studimet e reja sugjerojnë se shumica e prindërve dëmtojnë qafën e fëmijëve dhe shtyllën kurrizore duke i ulur në mënyrë të gabuar. Fëmijët e vegjël duhet të vendosen me fytyrë nga pjesa e prapme e automjeteve, e jo siç e bëjnë prindërit ata zakonisht duke i lënë me pamje nga shoferi. Kjo vlen për fëmijët deri në moshën katër vjeçare, sugjeruan mjekët. Mënyra korrekte e vendosjes së fëmijëve në ulëse, mund të ndihmojë uljen e rrezikut të ndryshëm i cili pa pararendim mund të vije. Përplasjet e makinave janë shkaku kryesor i vdekjes për fëmijët mbi moshën katër vjeçare në SHBA.



Është një vend strehimi për 236 lloje zogjsh, 30 prej të cilave janë specie të mbrojtura. Përveçse është një pikë kyçe për zogjtë migrues, çdo lloj aktiviteti njerëzor, përfshirë plazhin, është i ndaluar

Plazhi i kuq i Kinës, vendstrehimi për 236 lloje zogjsh

Ky plazh ndodhet rreth 30 km në juglindje të qytetit të Panjinit. Në lagunat e deltës së lumit Liao, që ndodhet në Kinë dhe që është lumi kryesor i Maçurisë jugore. Ky mjedis natyror është një vend unik, sepse në vjeshtë ai mbulon të gjithë gjerësinë e tij, rreth 3.500 hektarë, me një ngjyrë të kuqe intensive. Por, pse kjo ngjyrë? Arsyeja për këtë ngjyrë karakteristike është një algë detare e pranishme në plazh, sargadilla detare. Këto alga dalin me një ngjyrë të gjelbër që

kthehet rozë derisa të arrijë një të kuqe të thellë në muajin shtator. Në këtë vend, përveç algave të kuqe, ka më shumë se 236 lloje zogjsh. Për më tepër, kjo rezervë natyrore është një habitat i përsosur për zogjtë migrues që udhetojnë midis Azisë dhe Australisë. Është një vend strehimi për 236 lloje zogjsh, 30 prej të cilave janë specie të mbrojtura. Plazhi i kuq i Kinës është një bukuri e natyrës, është pjesë e rezervatit natyror Hekou Shuangtai, i përbërë nga



rreth 600.000 hektarë. Përveçse është një pikë kyçe për zogjtë migrues, çdo lloj aktiviteti njerëzor, përfshirë plazhin, është i ndaluar. Megjithatë, një zonë e vogël

për turistët lejohet, por pjesa tjetër është e kufizuar. Për këtë arsye, janë ndërtuar një varg vendesh druri që ju lejojnë të shijoni këtë mrekulli të natyrës.

Mënyra për ta bërë baterinë e smartphone-it tuaj të zgjasë

Edhe pse telefonat celularë janë përmirësuar ndjeshëm në shumë aspekte, bateria e tyre nuk ka fuqinë e dikurshme. Ditët kur njerëzit prisni që bateria e celularit të tyre të zgjaste një ditë të tërë kanë kaluar, pasi në ditët e sotme ne i përdorim ato shumë më shumë se normalisht. Por ekzistojnë disa mënyra që mund ta bëjnë telefonin tuaj të rrijë i ndezur për një kohë më të gjatë. Sipas Stuff, njerëzit duhet të mbajnë ni-



velin e baterisë mbi 50 për qind, të kenë më shumë se një karikues dhe të rregullojnë parametrat e

telefonit. Normalisht, njerëzve iu thuhet që para se të karikojnë telefonin e tyre duhet ta lënë që ba-

teria të bjerë plotësisht, por faqja e internetit Stuff thotë se kjo mënyrë nuk është e duhura. Një nga këshillat kryesore është që telefoni të karikohet nga pak, por rregullisht, në mënyrë që bateria të zgjasë sa më shumë. Rekomandohet gjithashtu që njerëzit të investojnë në blerjen e disa karikuesve. Çdo përdorues duhet të ketë një karikues për në shtëpi, një për vendin e punës dhe një për ta mbajtur në makinë.



Kush tha që nuk duhet ngrënë lëkura e pulës?!

Lëkura e pjekur e pulës është një ndër pjesët më të shijshme për ata që preferojnë të kripurat. Por, nëse deri dje nuk e keni konsumuar prej kalorive të tepërta, tani është momenti të merrni frymë dhe ta konsumoni lehtësisht. Është e vërtetë që një gjoks pule pa lëkurë ka pak kalori, por pas hulumtimeve që ka bërë shkolla për shëndetin publik në Harvard, do e kuptoni që nuk ka asgjë të gabuar në kon-

sumimin e lëkurës së pulës, pasi në të gjenden yndyrna të pangopura. Këto të fundit janë të dobishme për organizmin tonë dhe mund të ndikojnë në uljen e nivelit të presionit të gjakut dhe uljen e kolesterolit të keq. Në lëkurën e pulës gjendet acidi oleik, i njëjtë me atë vajit të ullirit. Acidi oleik ka efekte pozitive për sëmundjet kardiovaskulare, inflamatore dhe autoimmune. Studimi më i ri thotë se kthi-

mi tek një dietë mesdhetare me yndyrna të mira bën që diabetikët e tipit 2 të reduktojnë përdorimin e insulinës. Por lëkura e pulës ndihmon gjithashtu që pula të mos thahet shumë gjatë pjekjes. Lagështia e lëkurës bën që të kurseni kaloritë të tjera nga marinatat me vaj dhe kripë. Mos harroni se lëkura e pulës nuk është aq e keqe sa keni menduar por është e lartë në kalori prandaj konsumojeni, por jo gjithmonë.

VENDET MË JETËGJATA, MAQEDONIA DHE SHQIPËRIA TË FUNDIT

Më jetëshkurtër janë njerëzit në Europën Lindore, vendet ish-socialiste, ku normën më të ulët e kanë Lituania dhe Bullgaria, Maqedonia dhe më pas Shqipëria

Europa meriton emërtimin "Kontinenti i Vjetër" pasi ka një popullsi me moshë mesatarisht më të madhe se kontinentet e tjera. Sot në Europë ka rreth 32 pensionistë për çdo 100 punëtorë të moshës 20-64 vjeç, pra rreth tre punëtorë për një pensionist. Ky raport pritet të bjerë në dy punëtorë për një pensionist në mesin e shekullit të XXI. Studimi thekson se sidomos Europa Jugore kombinon shpopullimin me plakjen e popullsisë. Në vende të tilla si Greqia dhe Italia, ka një numër në rritje të atyre që lënë në tregun e punës për të dalë në pension, se të rinj që hyjnë në tregun e punës. Një seri faktorësh sociale, ekonomike dhe psikologjikë kombinohen për të nxitur çiftet sidomos në Europën Jugore që të mos kenë shumë fëmijë si më parë: të ardhura më pak të disponueshme, liri personale, dëshira për të



ndjekur karrierën profesionale, norma të larta të divorcit, çmtizim të martesës dhe familjes. Italia është vendi në Europë ku gratë kanë moshën mesatare më të lartë, fëmijën e parë e lindin pothuajse në 31 vjeç.

Në vende si Spanja çiftet e reja nuk mund të përballojnë krijimin familjes dhe të kenë një fëmijë

para moshës 30 vjeç. Në bazë të analizave të Eurostatit, vlerësohet se të paktën dy të tretat e vendeve evropiane do të kërkojnë kontributin e emigrantëve nga vendet jo-europiane për të siguruar stabilitetin demografik në Europë deri në vitin 2050. Në aspektin e jetëgjatësisë ka një ndarje mes Europës Lindore dhe asaj Veriore. Eu-

ropianët me jetëgjatësi më të madhe jetojnë në Italinë veriore, në veri të Spanjës, në rajonet bregdetare të Francës, dhe zona të Zvicrës dhe Norvegjisë. Më jetëshkurtër janë njerëzit në Europën Lindore, vendet ish-socialiste, ku normën më të ulët e kanë Lituania dhe Bullgaria, Maqedonia dhe më pas Shqipëria.



Hani djathë, ju mbron mëlçinë!

Shumë njerëz shmangin konsumimin e rregullt të djathit nga frika se ndikon në belin e tyre. Por, nëse konsumoni djathë jo të ri, mund ta përmirësoni shëndetin e mëlçisë. Djathi i ndenjtur përmban substancën e njohur spermidine, që parandalon dëmtimin e qelizave në mëlçi. Sëmundjet e mëlçisë janë shkaktoi i pestë më i madh i vdekjeve në Britaninë e Madhe. Hulumtuesit nga "A&M University" në Teksas kanë analizuar efektin e spermidines te minjtë. Hulumtime të tjera mbetet të bëhen duke shqyrtuar mundësitë që kjo substancë të merret si supremet.



Samsungu po përgatit telefonin me katër kamera

Samsungu raportohet se është duke bërë gati një telefon me katër kamera prapa dhe ai nuk do t'i takojë linjës Galaxy Note ose Galaxy S. Sipas "Ice Universe", telefoni do të lansohet sivjet, teksa nuk janë dhënë informacione tjera. Telefoni mund të jetë pjesë e linjës Galaxy A dhe mund të lansohet në fund të vitit, pikërisht kur pritet lansimi i Galaxy A9.

Probleme me shtyllën kurrizore? Ja sa duhet të peshojë çanta e shkollës

Çanta e shkollës vitet e fundit duket se është bërë një shqetësim për prindërit, kjo për faktin se pasha e saj sjell shumë probleme për shëndetin e fëmijëve. Më 17 shtator të gjithë nxënësit e shkollave 9-vjeçare dhe të mesme do të fillojnë vitin e ri arsimor e sigurisht nuk jemi herët nëse themi që prindërit e fëmijët kanë filluar nga përgatitjet! E pikërisht në këtë periudhë, posturologia dhe

fizioterapistja Jeannie Baer gjen rastin për të këshilluar të gjithë prindërit që çanta e fëmijëve të mos jetë shumë e rëndë, pasi kjo ndikon drejtpërdrejt në qëndrimin dhe shëndetin e kockave të tyre. Ai sugjeron se çanta e shpinës duhet të jetë sa 10 për qind e peshës së trupit. Kjo është pesha më e sigurt që mund të mbajë një fëmijë, pa rrezikuar nga problemet me shtyllën kurrizore. Por,

orari i ngarkuar, librat e trashë dhe mjetet e tjera shkollë shojnë peshën e çantës duke arritur deri në 20% të peshës së fëmijës, duke e bërë atë shumë të rëndë për t'u mbajtur. Kjo është veçanërisht e rrezikshme për fëmijët e vegjël, trupi i të cilëve është ende në zhvillim. Çantat e rënda shkaktojnë tendosje mbi supet dhe muskujt e sipërme të qafës, probleme të cilat në kohë afatgjatë

te mund të shoqërohen me jo pak efekte të padëshirueshme.

Por ekziston një zgjidhje për të lehtësuar presionin fizik që ushtrohet nga çantat e rënda. Ajo këshillon mbajtjen e çantave me dy rripa për të patur një mbështetje dhe shpërndarje të barabartë të peshës. Për fëmijët e vegjël rekomandohen gjithashtu çantat në formën e valixheve që tërhiqen.

Ministrja ulet në shkallë të vagonit pasi nuk kishte vend të mjaftueshëm

Të gjithë udhëtarët e rregullt të trenave me siguri se janë ballafaquar me lloj-lloj peripeçish në trenat e stërmbushur me njerëz, por një gjë e tillë i ka ndodhur edhe ministres Doris Leuthard gjatë udhëtimit të saj në Cyrih.

Në të vërtetë, këshilltarja federale, e ngarkuar për Ministrinë e Transportit, është dashur të udhëtojë e ulur në shkallët e trenit që do të dërgonte në SRF, për shkak të mungesës së vendit në vagon, shk-

ruan "20 Minutes". Incidenti ndodhi mbrëmjen e së premtes, njofton televizioni zviceran në një Tweet me foto, ku shihet shpina e saj dhe përpjekja për të klasifikuar dosjet e saj me një bashkëpunëtoresh femër.

Doajneja e Këshillit Federal është dashur të merrte pjesë në programin e famshëm debatit "Arena". Tema e këtij debati ka qenë çështja e biçikletave për të cilën zviceranët duhet të vendosin

më 23 shtator. Një ekip i medias sociale e ka fotografuar politikanen nga Aargau, duke e përshkruar foton si "jashtëzakonisht simpatike" dhe duke shtuar komentimin: "Herën tjetër është më mirë të vini me biçikletë në "Arena", apo jo Zonja këshilltare federale?". Në Twitter, nga ana tjetër, shumë përdorues të internetit kanë konstatuar se ky është vetëm një veprim i pastër komunikimi nga ana e Doris Leuthardit.





MARRËVESHJA PËR KUFIRIN DERI NË FUND TË VITIT

Mogherini, para ambasadorëve të BE-së, përmendi edhe ngjarje të tjera që kanë ndodhur në rajon muajve të fundit, duke u ndalur te marrëveshja për emrin e Maqedonisë me Greqinë dhe mundësia e hapjes së negociatave të Shqipërisë për anëtarësim në Bashkimin Evropian. Të gjitha këto ngjarje duhet të shfrytëzohen, tha Mogherini

Shefja e politikës së jashtme të Bashkimit Evropian, Federica Mogherini, paralajmëroi mundësinë që Kosova dhe Serbia të arrijnë marrëveshje për normalizimin e marrëdhënieve deri në vitin e ardhshëm. "Mendoj se ekziston mundësi reale që presidenti (i Serbisë, Aleksandar) Vuçiq dhe (ai

i Kosovës, Hashim) Thaçi të arrijnë marrëveshje për të gjitha çështjet e hapura midis Beogradit dhe Prishtinës - marrëveshje gjithëpërfshirëse, e obligueshme ligjërish, për normalizimin e marrëdhënieve midis dy palëve, marrëveshje që është plotësisht në përputhje me të drejtën ndërkombëtare dhe që mund të ndihmojë në stabilizimin e gjithë rajonit", tha Mogherini në një takim me ambasadorët e BE-së në Bruksel, raporton Shërbimi i Ballkanit i Radios Evropa e Lirë. Sipas saj, viti i ardhshëm është i rëndësishëm sepse është 20-vjetori i luftës në Kosovë, andaj, siç u shpreh, "është koha që përfundimisht t'i jepet fund këtij konflikti".

Mogherini, para ambasadorëve të BE-së, përmendi edhe ngjarje të tjera që kanë ndodhur në rajon muajve të fundit, duke u ndalur te marrëveshja për emrin e Maqedonisë me Greqinë dhe mundësia e hapjes së negociatave të Shqipërisë për anëtarësim në Bashkimin Evropian. Të gjitha këto ngjarje duhet të shfrytëzohen, tha Mogherini.

Ndërkohë, Milan Nic, ekspert i Shoqatës Gjermane për Politikën e Jashtme (DGAP) dhe i ngarkuar për studime në Qendrën Robert

DAÇIQ KËRKON "DAYTON 2" PËR KOSOVËN

Shefi i diplomacisë serbe Ivica Daçiq tha se një zgjidhje për "nyjën e Kosovës" mund të vijë në një konferencë ndërkombëtare. Sipas tij, parakushti për këtë është se qëndrimet e të dy palëve të afrohen. Ai tha për Telegrafin serb se pozicionet aktuale të të dy palëve janë larg. Sipas gazetës, duke iu referuar ministrit, kjo mund të quhet "Dayton 2", një zgjidhje sipas modelit të korigjimit të kufijve në një konferencë të madhe ndërkombëtare që do të mbahet para majit të 2019-ës. Kreu i diplomacisë serbe thekson se korigjimi i kufijve me shqiptarët do të ishte çështja e vetme e kufijve në agjendë në rastin e Daytonit të ri.



Bosch për Europën Qendrore dhe Lindore, në një intervistë të dhënë për DW, për herë të parë ka zbuluar edhe rolin e ministres së Jashtme të BE-së Mogherini dhe komisionierit Hahn, në lojën që është hapur për ndarjen e Kosovës. Nic, i cili po kryeson një fushatë ekspertize për Ballkanin Perëndimor ka zbuluar, se Berlino zyrtar është mjaft i zhgënjyer dhe i shqetësuar nga roli që kanë marrë përsipër dy zyrtarët e lartë të BE-së, Hahn dhe Mogherini, duke inkurajuar presidentët Vuçiq dhe Thaçi në rrugën e rrezikshme që kanë nisur.

"Më duhet të shtoj se Berlino është gjithashtu i zhgënjyer me rolin që kanë luajtur kohët e fundit komisionieri Hahn dhe përfaqësuesja e lartë e politikës së jashtme, Mogherini dhe presidenca austriake, duke e inkurajuar Serbinë dhe krerët e Kosovës të ecin në këtë rrugë. Ata thanë se një marrëveshje historike mes Serbisë dhe Kosovës është më e rëndësishme se detajet, pra, kufijtë. Por ky nuk ishte qëndrimi i unifikuar i BE-së. Ata thjesht prezantuan vijën diplomatike të Austrisë e jo atë të presidencës", ka deklaruar ai për DW.

Han nuk hedhë poshtë këmbimin e territoreve

Bruksel, 4 shtator - Komsuari i Bashkimit Evropian për zgjerim dhe fqinjësi të mirë, Johannes Han, në intervistë për Radion Evropa e Lirë, përsëriti se cila do që të jetë zgjidhja për Serbinë dhe Kosovën, nuk guxon të jetë në dëm të stabilitetit të Ballkanit Perëndimor. "Unë jam për zgjidhje të çdo konflikti bilateral, por secila zgjidhje duhet të kontribuojë për stabilitet më të gjerë t[ë këtij rajoni, kështu që ajo zgjidhje bilaterale të mos shkojë në llogari të të tjerëve në rajon. Tani duhet ta shohim fotografinë më të gjerë, që do të thotë se, pa marrë parasysh atë se çfarë është zgjidhja, ajo duhet të jetë e tillë që të mos jetë në dëm të të tjerëve", tha Han. Në pyetjen nëse nuk përjashton këmbim të territoreve, Han u përgjigj se duhet t'u lihet atyre të diskutojnë. "Mendoj se kjo duhet t'u lihet atyre, ata le të diskutojnë për atë. Tani shumë qartë e dinë se cilat janë kornizat tona kushtëzuese dhe konsideroj se, nëse dëshironi të arrini diçka, duhet të mendohet edhe jashtë kutisë", shtoi Han. Duke folur për atë se cila është korniza kushtëzuese e BE-së, Han tha të ketë më shumë stabilitet në rajon dhe secila zgjidhje individuale, secila marrëveshje për zgjidhje të konflikteve bilaterale të duhet të kontribuojë për stabilitetin e përgjithshëm dhe zhvillimin e rajonit sepse, siç cekti, qëllimi është të gjitha gjashtë vendet të bëhen anëtare të BE-së. Në pyetjen nëse frikësohet se kjo do të mund të ketë efekt negativ ndaj BeH-së, Maqedonisë, madje edhe vendeve nga partneriteti lindor, komisar Han u përgjigj se është tejet herët të flitet për atë.

Shqiptarët në Itali, të tretët për vepra penale

Numri i veprave penale të kryer nga shtetasit shqiptar në 2016-n në Itali ishte 7575, të renditur pas rumunëve, me rreth 16348 krime dhe marokenëve me 6115 denoncimeve. Në raport me numrin e shqiptarëve që kanë emigruar në Itali, Il Sole përlogarit se në çdo 100 emigrantë, rreth 1.23 ka kryer një veprë penale. Ndërsa krimet nga vetë italianët, sipas të dhënave të publikuara nga "Infodata e Il Sole 24", është 66.477, ku sipas përlogaritjeve në çdo 100 italianë, 0.11 kanë kryer një veprë



penale. Ky përpunim të dhënash nga portali italian u nxit prej de-

batit mbi emigrantët dhe "pushtimit" që i kanë bërë Italisë. Për sa i

përket renditjes më poshtë, për numrin më të lartë të denoncimeve bazuar mbi kombësinë, renditet Tunizia me 2233 denoncime, Moldavia me 1400 dhe Bosnja me rreth 1300 denoncime. Megjithatë Il Sole në analizën e saj jep dy sqarime të rëndësishme. E para, lidhet me faktin se një emigrant që kryen një krim nuk i bën kriminelë të gjithë emigrantët, me të njëjtën kombësi, shkruan "Monitor".

E dyta është e natyrës juridike. Supozimi i pafajësisë në fakt do

të thotë se, kur flitet për krime, vetëm ato për të cilat ka një person është dënuar me vendim të formës së prerë janë marrë në konsideratë. Të dhënat që janë në dispozicion në faqen e internetit të Institutit italian të Statistikave, por përdorimi i të cilave krijon disa probleme nga pikëpamja kronologjike.

Grupi i të dhënave të institutit kombëtar të statistikave, në fakt, i klasifikon të paraburgosurit në bazë të vitit në të cilin emri i tyre është futur në dosjen penale.

Dështimi i qeverive të njëpasnjëshme për të integruar policinë në strukturën formale të sigurisë ka çuar në disa grupe që forcojnë pozicionin e tyre në kryeqytet - dhe kudo tjetër - ku kontrollojnë terminalët e naftës, aeroportet, kazernat ushtarake dhe infrastruktura të tjera vendimtare

Tripoli mbërthehet nga dhuna vdekjeprurëse fisnore ndërsa policitë sulmojnë për kontrollin e fondeve shtetërore të Libisë dhe burimeve të mëdha natyrore. Përplasjet e përsëritura midis grupeve rivale të armatosura në Tripoli kanë zhytur Libinë në një kaos akoma më të thellë, duke shkakuar dyshime serioze në lidhje me atë nëse vendi i shkatërruar nga lufta është gati të mbajë zgjedhje të planifikuara më vonë këtë vit. Më 27 gusht, luftimet e ashpra shpërthyen në rrethet jugore të kryeqytetit pas Brigadës së Shtatë, një grup i armatosur i vendosur në Tarhouna, 65 km në juglindje të Tripolit, filloi një ofensivë të papritur kundër policive rivale. Deri tani janë vrarë të paktën 39 njerëz, përfshirë 18 civilë në betejat e armëve dhe granatimet që godasin zonat me popullsi të dendur. Qindra të tjerë janë plagosur.

Armëpushimi u arrit më 28 gusht, por përplasjet rifilluan pak më vonë, duke detyruar autoritetet të mbyllin aeroportin e vetëm funksional të Tripolit. Brigada e Shtatë

VAZHDON KAOSI I LIBISË



TË GJITHË GAROJNË PËR NJË COPË BYREK

që atëherë ka marrë kontrollin e aeroportit. Qeveria e OKB-së e mbështetur nga Kombet e Bashkuara në Tripoli shpalli gjendjen e jashtëzakonshme të dielën, duke thënë në një deklaratë se ishte e nevojshme "të mbrohej dhe të siguronte civilët, pasuritë publike dhe private dhe institucionet vitale". Ndarjet përgjatë linjave rajonale, fisnore dhe gjuhësore kanë komplikuar tranzicionin e vendit të Afrikës së Veriut në demokraci që

nga rrëzimi i udhëheqësit të vjetër Muamar Gadafit gati shtatë vjet më parë.

Grupet e armatosura tani përplasen rreth kryeqytetit ku luajtën një pjesë integrale në misionin e mbështetur nga NATO për të rrëzuar Gaddafin. Dështimi i qeverive të njëpasnjëshme për të integruar policinë në strukturën formale të sigurisë ka çuar në disa grupe që forcojnë pozicionin e tyre në kryeqytet - dhe kudo tjetër - ku kontrol-

lojnë terminalët e naftës, aeroportet, kazernat ushtarake dhe infrastruktura të tjera vendimtare. Ekzistenca e dy legjislativëve rivale - GNA e njohur ndërkombëtarisht dhe Dhoma e Përfaqësuesve në lindje (HOR) - secila me bankën e vet qendrore dhe kompaninë kombëtare të naftës - thekson një sfidë tjetër në gjendjen e vendit për të zbatuar reformat e nevojshme dhe në fund të fundit zgjedhjeve. Në maj, kryeministri Fayed al-Serraj

i GNA dhe gjeneral Halif Haftar i vetë ushtrisë libiane të Libisë, që kontrollojnë pjesën më të madhe të Libisë lindore, u takuan në Paris dhe ranë dakord për një afat kohor për të mbajtur sondazhe anëmbanë vendit deri në fund të viti.

Me një afat deri më 16 shtator për të krijuar një bazë kushtetuese dhe ligjore për sondazhet, Al Jazeera shqyrton grupet e ndryshme që garojnë për pushtet dhe perspektivat për zgjedhjet e këtij viti.

Bangkoku mund të fundoset deri në vitin 2030

Rritje e nivelit të detit, erozion i bregdetit, urbanizim galopant, Bangkoku, që pret më 4-9 shtator mbledhjen për COP-24, konferenca e radhës e OKB-së për klimën, po fundoset pa pushim dhe deri në vitin 2030 një pjesë e tij mund të jetë nën ujë. "I ndërtaur në moçale që janë 1,5 metra mbi nivelin e detit, ky metropol prej më shumë se dhjetë milionë banorë zhytet një deri në dy centimetra në vit dhe rrezikon të përballet me përmbytje të fuqishme në të ardhmen e afërt", thotë Tara Buakamsri, drejtori i "Greenpeace Tajlandë". Gjatë përmbytjeve

të mëdha të vitit 2011, më shumë se një e pesta e qytetit u përmbyt, ku më shumë ishin prekur zonat periferike, ndërkohë që zonat e biznesit shpëtuan falë digave që u ngritën menjëherë. Një skenar që pritet të ndodhë gjithnjë e më shpesh. Gati 40% e qytetit mund të përmbytet deri në vitin 2030, sipas parashikimeve të Bankës Botërore, që e klasifikon metropolin si një nga më të rrezikuarit në Azi bashkë me Xhakartën. Bangkoku, "një qytet obez me skeletin e një fëmijë" sipas shprehjes së gjeologut Thanawat Jarupongsakul, është

fillimisht viktimë e zhvillimit të tij të shfrenuar. Pësha e qiellgërvishtëse, që nuk pushojnë së rrituri drejt qiellit në një transformim të pandërprerë, po shkakton një fundosje të vazhduar. "Ndërsa kanalet e shumta që përshkruanin kryeqytetin, që dikur quhej Venecia e Orientit, pjesa më e madhe janë zhdukur, të mbuluar nga një rrjet gjigant rrugor. Në fakt ato përbënin një sistem të kullimi natyror shumë të mirë", thotë Suppakorn Chinvano, ekspert mbi klimën në Universitetin "Chulalongkorn" të Bangkokut.



2.6 milionë votues britanik ndryshojnë qëndrimin mbi Brexit

Mbi 2,6 milionë votues britanikë kanë ndryshuar idenë mbi Brexit dhe tani janë kundër daljes së Britanisë së Madhe nga Bashkimi Europian, sipas një sondazhi të gazetës "Focldata". Sipas të dhënave që sjell kjo e pavarur, nëse këta votues do të votonin për të qëndruar në BE, në referendun-

min e 23 qershor 2016, sot nuk do të diskutoheshin këto tema. Shumica e votuesve që kanë ndryshuar idenë janë laburistët, mesa shihet në sondazhe, dhe kjo duhet të rritë presion tek kreu i partisë, Jeremy Corbyn dhe ta nxisë atë të marrë një pozitë më të ashpër kundër Brexit.



Më 31 gusht 1918, Dora Kaplan u përpoq të vriste Leninin. U pretendua se kjo ishte pjesë e komplotit britanik për të përmbysur qeverinë bolshevike. Xhërxhezinski urdhëroi arrestimin e agjentëve britanikë në ambasadën Britanike në Petrograd. Atasheu detar, Frensis Kromi u vra pasi i rezistoi arrestimit

Në dhjetor 1917, Vladimir Iliç Lenin emëroi Feliks Xhërxhezinski si Komisar për Punë të Brendshme dhe kreun e Komisionit të Jashtëzakonshëm të të Gjithë Rusisë për Luftën ndaj Kundërrivolucionit dhe Sabotazhit (Cheka). Xhërxhezinski deklaroi në korrikun e 1918-ës: "Ne mbështesim terrorin e organizuar - kjo duhet të pranohet me sinqeritet. Terrori është një domosdoshmëri absolute gjatë kohërave revolucionare. Synimi ynë është të luftojmë kundër armiqve të qeverisë sovjetike, dhe të rendit të ri të jetës. Gjykimi i shpejtë, në shumicën e rasteve, kërkon vetëm një ditë ndërmjet kapjes së kriminelit dhe dënimit të tij. Në rast se përballen me prova, kriminelët në pothuajse çdo rast pranojnë fajin e tyre, dhe cili argument mund të ketë peshë më të madhe, se sa vetë rrëfimi i një kriminelit?".

Një nga bashkëpunëtorët e ngushtë të Xhërxhezinkit, Viktor Serzh, deklaroi më vonë: "Unë besoj se formimi i Çekës, ishte një nga gabimet më të rënda dhe më të palejueshme që liderët bolshevikë bënë në vitin 1918, kur komplotet, sabotazhet dhe ndërhyrjet, i bënin ata të humbnin arsyen. Të gjitha provat tregonin se gjykatat revolucionare, duke funksionuar në transparencë dhe duke pranuar të drejtën e mbrojtjes, do të kishin aritur të njëjtën efikasitet, me abuzime dhe keqtrajttime shumë më të vogla. A ishte vërtet e nevojshme të riktheheshin procedurat e Inkuzicionit?". Më 31 gusht 1918, Dora Kaplan u përpoq të vriste Leninin. U pretendua se kjo ishte pjesë e komplotit britanik për të përmbysur qeverinë bolshevike. Xhërxhezinski urdhëroi arrestimin e agjentëve britanikë në ambasadën Britanike në Petrograd. Atasheu detar, Frensis Kromi u vra pasi i rezistoi arrestimit.

Agjenti tjetër britanik, Robert Brus Lokhart, u zgjua nga një zë i vrazhdë që e urdhëroi të çohet urgjent nga shtrati. Lokhart u dërgua në Burgun e Lubjankas. Lokhart, që ishte zyrtarisht një diplomat i akredituar, u ankua për trajtimin e tij. Por një nga drejtuesit e ÇEKA, Jakov Piters i shpërfilli këto komente, dhe e pyeti nëse e njihnte Dora Kaplan. Kur i tha se nuk kishte dëgjuar kurrë për të, Piters e pyeti për vendndodhjen e agjentit

KOMPLOTI BRITANIK

NUK PËRMBYSEJ DOT REGJIMI BOLSHEVIK RUS



FELIKS XHËRXHEZHINSKI

Ne mbështesim terrorin e organizuar - kjo duhet të pranohet me sinqeritet. Terrori është një domosdoshmëri absolute gjatë kohërave revolucionare. Synimi ynë është të luftojmë kundër armiqve të qeverisë sovjetike, dhe të rendit të ri të jetës. Gjykimi i shpejtë, në shumicën e rasteve, kërkon vetëm një ditë ndërmjet kapjes së kriminelit dhe dënimit të tij

komploti anglo-francez, që përfshinte agjentë dhe diplomatë të fshehtë.

Një shkrim i "Pravda", deklaroi



Agjentët e saj, kishin furnizuar me inteligjencë të vlefshme Shërbimet Sekrete të një numri të vendesh antibolshevike, dhe ishte i bindur se nuk ishte nën kontrollin e Shërbimit Sekret rus. I panjohur për Rajlim, ishte fakti që Bojsi ishte në listë-pagesën e Çekës. Sidni Rajli e dinte që Uinston Çerçill ishte një përkrahës i apasionuar i ndërhyrjes në Rusi. Ai i tha atij, se Boris Savinkov ishte njeriu më i mirë, për të koordinuar një përmbysje të bolshevikëve nga pushteti. Ndërkës kryeministri Dejvid Lloid Xhorxh kishte dyshime rreth këtij plani. Më 10 gusht 1924, Savinkovi u nis për në Rusi. Nëntëmbëdhjetë ditë më vonë, gazeta "Izvestia" njoftoi arrestimin e tij. Gjatë muajve të ardhshëm gazeta njoftoi se ai ishte dënuar me vdekje; dënim i ndryshuar në 10 vjet burgim, ndërsa në fund u raportua se ishte liruar. Sipas burimeve zyrtare, ai jetonte në një shtëpi të rehatshme në sheshin Lubjanka.

se Lokhart ishte organizatori kryesor i komplotit, dhe u etiketua si "një vrasës dhe konspirator kundër qeverisë sovjetike". Të nesërmen ai u arrestua dhe u akuzua për vrasje, vrasje në tentativë dhe planifikim të një grushti shteti. Për të tria krimet parashikohej dënim me vdekje. Jakov Piters, mori në pyetje Lokhart për disa ditë. Pas pesë ditësh burgim në Lubjanka, britaniku u transferua në Kremlin. Shtypi vazhdoi të ngrinte akuza kundër tij. Xhërxhezinski ishte i vetëdijshëm se britanikët vazhdonin të komplotonin kundër qeverisë bolshevike. Dy figurat kryesore në këtë komplot ishin Boris Savinkov një ish-terrorist rus dhe anëtar i Partisë Revolucionare Socialiste dhe Sidni Rajli, një agjent i MI6. Xhërxhezinski vendosi të krijojë organizatën e tij antibolshevike, Unionin Monarkist të Rusisë Qendrore (i njohur edhe si "Trusti").

Savinkovi i kërkoi Rajlit të kryejë hetime mbi "Trustin". Rajli kontaktoi me Ernest Bojsin, kreun e seksionit rus të MI6. Ky konfirmoi se organizata ishte me sa duket një lëvizje e fuqishme brenda Rusisë.

Savinkovi i shkroi Sidnej Rajlit, se kishte ndryshuar pikëpamjet e tij mbi bolshevikët: "Sa iluzione dhe përralla kam varrosur këtu në Lubjanka! Nuk mund ta mohoj se Rusia sot po rilind". Rajli besonte se letra ishte shkruar nga GPU. Boris Savinkov vdiq më 7 maj 1925. Sipas qeverisë, ai kreu vetëvrasje, duke u hedhur nga një dritare në burgun e Lubjankas. Megjithatë, burime të tjera pohojnë se ai u vra në burg nga agjentët e Administratës Politike të Shteteve të Bashkuara (GPU). Rajli këmbënguli se Savinkovi u vra në që në gushtin e vitit 1924, kur u përpoq të largohej nga Rusia. Ernest Bojsi, shefi i degës së MI6 në Helsinki, i shkroi Sidnej Rajlit duke i kërkuar atij të takohej me udhëheqësit e Unionit Monarkist të Rusisë Qendrore në Moskë. Rajli kaloi kufirin finlandez më 25 shtator 1925. Në një shtëpi jashtë Moskës dy ditë më vonë, ai pati një takim me udhëheqësit e MUCR, ku u arrestua nga policia sekrete.

Atij iu tha se do të ekzekutohej, për shkak të përpjekjeve të tij për të përmbysur qeverinë bolshevike në vitin 1918. Sipas dosjes sovjetike të marrjes në pyetje të tij më 13 tetor 1925, Rajli i shkroi Feliks Xhërxhezinkit, duke i thënë se ishte gati të bashkëpunonte dhe të jepte informacion të plotë për shërbimet e inteligjencës britanike dhe amerikane. Apeli i tij ra në vesh të shurdhër, dhe ai u ekzekutua më 5 nëntor 1925.

(Marrë më shkurtime nga Spartacus Educational)

VULLKANI QË I SHKAKTOI HUMBJE NAPOLEON BONAPARTIT NË VATERLO!



Në lidhje me humbjen e Napoleonit në Vaterlo, Viktor Hugo, në romanin e tij "Të mjerët", shkruante se "një qiell jashtëzakonisht i mbuluar me mjegull, ishte i mjaftueshëm për të shkaktuar shembjen e një bote". Natyrisht ai nuk e imagjinonte, se gjithçka kishte nisur me një shpërthim vullkanik në anën tjetër të Tokës

Nga Analiza Lo MONAKO

Matematikani dhe meteorologu amerikan Eduard Lorenc, mbajti në vitin 1972 një konferencë me një titull, që më vonë do të bëhej i famshëm: "A mundet që rrahja e flatrave një fluturë në Brazil, të shkaktojë një tornado në Teksas?". Dhe sinteza e asaj që përkufizohet nga atëherë si "Efekti Flutur", ishte përmendur tashmë që në vitin 1950 nga njëri prej matematikanëve më të mëdhenj të shekullit të kaluar, Alan Turing, i konsideruar si "babai i shkencës kompjuterike", dhe që kreu vetëvrasje kur ishte vetëm 41-vjeç, për dënimin dhe poshtërimet që vuajti në Britaninë e Madhe, për shkak të homoseksualitetit të tij. Sigurisht, shpërthimi i vullkanit Tambora në Indonezi në vitin 1815, nuk mund të krahasohet me rrahjen e lehtë të flatrave të një fluturë. 19 prilli i vitit 1815 (edhe pse tashmë shpërthimi i parë kishte ndodhur më 11 prill), krijoi një ferr të vërtetë, 20 herë më shkatërrues se ai që shkatërroi Pompein në vitin 79 Pas Krishtit.

Prej tij, nuk vdiqën vetëm njerëzit e zonës përreth. Në kushtet kur shpërthimi hodhi në ajër një sasi aq të madhe hiri, sa që kishte aftësinë për të errësuar diellin për disa ditë me radhë në të gjithë rajonin, efektet më të dukshme, si shpërthimet dhe dridhjet e tokës, u sinjalizuan deri në 1600 kilometra larg. Por jo vetëm kaq: siç ndodh gjithmonë në rastet e shpërthimeve të fuqishme, pati një ndryshim

të klimës, që shkaktoi një rënie globale të temperaturës, duke sjellë zi buke, dhe çuar në vdekjen e mijëra njerëzve, përveç rreth 60.000 viktimave të katastrofës natyrore.

Hiri vullkanik, i hedhur në atmosferën e sipërme, e bëri 1816 "viti pa verë", gjatë të cilit i ftohti, dëborat dhe akulli dëmtuan rëndë bujqësinë në verilindje të Shteteve të Bashkuara dhe Europën Veriore. Pikërisht gjatë asaj vere, shumë banorë të Shteteve të Bashkuara pushtuan pjesën perëndimore, duke u përpjekur t'i shpëtojnë mjerimit që kishte prekur shumë sektorë të popullsisë, ndërsa në Europë pati revolta të shumta nga mungesa e ushqimit. Por edhe para këtyre efekteve shkatërruese, shpërthimi i Tamborës mund të ketë ndihmuar në ndryshimin e historisë së

Europës. Në orët e hershme të mëngjesit të 18 qershorit 1815, Napoleon Bonaparti po sa andej-këndej nën një shi të pandërprerë, që mbushi terreshin ku disa orë më vonë, ai do të kishte zhvilluar betejën epike, që do të vuloste humbjen e tij të fundit pranë Vaterlosë në Belgjikë.

Shiu pengoi planet e Napoleonit, që mbështetej shumë tek përdorimi i artilerisë së rëndë për të mposhtur forcat britanike, para se aleatët prusianë të mbërrinin në ndihmë të tyre. I shqetësuar se një terren plot baltë do të ngadalësonte, në mos do të pengonte avancimin e topave, kuajve dhe burrave, gjenerali priti disi tepër për të nisur sulmin. Pikërisht falë kësaj vonese, prusianët e marshallit Blyher, arritën t'i vijin në ndihmë ushtarëve britanikë, të ko-



Në orët e hershme të mëngjesit të 18 qershorit 1815, Napoleon Bonaparti po sa andej-këndej nën një shi të pandërprerë, që mbushi terreshin ku disa orë më vonë, ai do të kishte zhvilluar betejën epike, që do të vuloste humbjen e tij të fundit pranë Vaterlosë në Belgjikë

manduar nga gjenerali Uellington, që ndodheshin në prag të disfatës. Sipas Metju Genxh, profesor i "Im-

perial College" në Londër, ishte pikërisht shpërthimi i Tamborës, ai që ndikoi tek klima në Europën e largët. Hiri i hedhur në atmosferë, ngarkoi në maksimum korrentet elektrike në jonosferë, ku dhe formohen retë. Studimi i dr. Genxh, botuar nga "Shoqëria Gjeologjike të Amerikës", paraqet një teori, që në kundërshtim me atë që është menduar më parë, hirit vullkanike janë në gjendje të mbërrijnë në atmosferën e sipërme, duke krijuar anomali të motit, që mund të ndikojnë në klimën e gjithë botës.

Pa të dhëna klimatike për vitin 1815, teoria e profesor Genxhe nuk është shkencërisht e vërtetueshme, por moti me shumë shira që preku Europën në muajt pas shpërthimit, mund të shpjegohet me një formacion të jashtëzakonisht të shkatërrues nga lartësia e madhe e arritur nga hiri vullkanik. Genxh pastaj përmend në hulumtimin e tij pikërisht Betejën e Vaterlosë: "Moti i lagësht në Europë, është përmendur nga historianët si një faktor që kontribuoi në humbjen e Napoleon Bonapartit në Vaterlo".

Në lidhje me humbjen e Napoleonit në Vaterlo, Viktor Hugo, në romanin e tij "Të mjerët", shkruante se "një qiell jashtëzakonisht i mbuluar me mjegull, ishte i mjaftueshëm për të shkaktuar shembjen e një bote". Natyrisht ai nuk e imagjinonte, se gjithçka kishte nisur me një shpërthim vullkanik në anën tjetër të Tokës. (VanillaMag)



Jeta dhe vdekja në një anije shpëtimi në Mesdhe. Kriza e emigrantëve në foto

Juan Medina, një fotoreporter me agjencinë e lajmeve Reuters, kaloi 29 ditë në bordin e një anije shpëtimi nga Libia, duke dokumentuar kërkimin e atyre që humbën në det. "Krahët e Hapura" është një anije në pension e drejtuar nga organizata bamirëse spanjolle, "Proactiva Open Arms". Ajo patrullon një zonë ku qindra mijëra njerëz kanë hyrë në kalime të pabesa në Europë, në vitet e fundit. Pothuajse 1.8 milionë njerëz kanë migruar në të gjithë Mesdheun nga Lindja e Mesme dhe Afrika që nga viti 2014, sipas shifrave të OKB-së. Një moment dramatik gjatë kohës së fotografit Medina në bordin e Krahëve të Hapura ishte shpëtimi i Josephas. Ajo ishte e vetmja e mbijetuar e një varke ku gjendeshin edhe trupat e pajetë të një gruaje tjetër dhe një djali 4-

vjeçar. Josepha ishte në një gjendje shoku, kur ajo u mor në bord dhe u trajtua nga mjekët më 17 korrik. Ajo tha se ishte nga Kameruni dhe e kishte kaluar natën duke u kapur me copa dërrase, duke kënduar himne dhe duke i thirrur Perëndisë. Ahmed, 38 vjeç, u shpëtua me djalin e tij 13-vjeçar në fillim të gushtit. Ai i tha fotografit Medina se ai dhe djali i tij kishin udhëtuar nga Darfur, Sudani. Në qytetin libian të Sabratak, në perëndim të Tripolit, ata dhe të tjerët u rrëmbyen dhe u mbajtën robër për shtatë ditë. Duke arritur të ikin përmes një dritareje, ata shkuan në qytetin e Garabullit, rreth 130 km në lindje dhe pritën për pesë javë të paguajnë 2000 dinarë (1438 dollarë) secili dhe hynë në një anije gome. Pas lundrimit për 15 orë varka u mbyt dhe ata notuan për

tre orë. Gjatë natës panë se drita po afroreshin. Ahmed i tha Medines: "Kishte një moment frike dhe nervozie të madhe, sepse nuk shihnim mirë dhe gjëja më e keqe që mund të ndodhte ishte se mund të ishte patrullimi libian që do të na gjente, i cili do të na detyronte të ktheheshim në atë ferr".

"Por pastaj dëgjuam nga një prej dy anijeve të shpejta që nga u drejtuan: "Ne jemi miq, ne jemi një anije shpëtimi spanjolle. Fil-luam të bërtisim me gëzim".

Ahmed vazhdoi: "Disa nuk e kuptuan mesazhin, ndoshta sepse nuk flasin anglisht, dhe mendonin se një nga dy anijet ishte roja bregdetare libiane dhe u hodhën në ujë, duke preferuar të rrezikonin mbytjen sesa të ktheheshin në Libi". "Për fat të mirë jemi të gjallë, kemi një mundësi të re".



KUQEZINJTË E PANUÇIT ZBRESIN NË FUSHË

Fillimisht Panuçi grumbulloi të gjithë lojtarët, për të bërë edhe përshëndetjen zyrtare, ndërsa më pas i orientoi drejt një stërvitjeje të lehtë dhe shtrydhëse, nën vëzhgimin e ndihmësve të tij



Kombëtarja Shqiptare, nën drejtimin e Christian Panuçit, ka filluar në Durrës stërvitjen e parë, në kuadër të përgatitjes së dy ndeshjeve të Nations League, ndaj Izraelit më 7 dhe Skocisë më 10 Shtator. Fillimisht Panuçi grumbulloi të gjithë lojtarët, për të bërë edhe përshëndetjen zyrtare, ndërsa më pas i orientoi drejt një stërvitjeje të lehtë dhe shtrydhëse, nën vëzhgimin e ndihmësve të tij. Më pas tekniku italian priti presidentin e FSHF-së, Armando Duka, me të cilin shkëmbeu një bisedë të shkurtër në cepin e fushës, për t'iu rikthyer edhe njëherë drejtimin të seancës stërvitore.

Ndërkohë në konferencën për shtyp janë paraqitur para mediave, sulmuesi i Oostendes, Sindrit Guri dhe mesfushori i Arisit të Selanikut, Migjen Basha, ky i fundit i rikthyer në planet e Panuçit, pas mungesës në miqësoret e qershorit. Guri, i cili pritet të krijojë dyshen e sulmit me shkodranin

tjetër, Bekim Balaj, duket se do të ketë përgjegjësi më të larta për të çuar topin në rrjetë, tani që mungojnë Sadiku dhe Roshi në repartin e avancuar, për shkak lëndimesh. Shkodrani pranoi se ky është momenti më i mirë në karrierë dhe premtos se do të jap më të mirën dhe maksimumin me kombëtaren. "Nuk vij në kombëtare që të them se është një xhiro. Unë vij që të jap maksimumin. Duam të ecim sa më shumë dhe parësore nuk është goli im, por arritja e objektivave me kombëtaren. Roli im kryesor është sulmues qendror. Nëse kërkesat janë që të luaj në një pozicion tjetër, do të ndihmoj ekipin patjetër. Për kombëtaren luaj në çdo rol që do trajneri", u shpreh sulmuesi i Oostendes.

Curi theksoi se nuk është i kënaqur për dëmtimin e bomberit Sadiku dhe Roshit. "Do rrinë 6-7 muaj jashtë fushave dhe është gjëja më e keqe për një futbollist. Nuk gëzohem, se më krijohen më tepër hapësira. Gjithkush ka vendin e vet në kombëtare. Do të mundohem të jap maksimumin dhe ta meritoj fanellën kuqezi. Gjithsecili që fiton kombëtaren, ka peshën dhe duhet të japë maksimumin me të. Duam të fitojmë çdo ndeshje me kombëtaren dhe ky është synimi. Lojtari duhet të jetë sa më i qetë dhe goli do të vijë. Trajneri në Belgjikë më ka ndihmuar shumë në këtë aspekt", tha Guri. Në krahun tjetër Migjen Basha është ngacmuar nga gazetarët për zgjedhjen e tij për luajtur në

kampionatin grek dhe është përgjigjur duke thënë se ishte i detyruar për të pasur sa më shumë aktivizime, në mënyrë që të mos humbiste kombëtaren.

"Sigurisht që kalimi te Arisi është një motivim shumë i madh. Kam pasur oferta nga disa klube, por rrezikoja të humbja Kombëtaren. Synimi im është ta mbaj Kombëtaren deri në maksimumet e viteve të mija. E kam pranuar Arisin për të qenë pranë Kombëtares", tha Basha. Ai gjithashtu ka rrëfyer se interesi nga Arisi për Mërgim Mavrajn është konkret, por edhe dëshira nga ana e mbrojtësit kuqezi për t'iu bashkuar në aventurën greke. Sa i përket rikthimit në kombëtare, Basha tha se "është një nder që jam

rikthyer, pasi kam munguar për një periudhë gati njëvjeçare". "Fillimisht kam pasur një dëmtim dhe më pas trajneri vendosi që t'iu japë mundësinë dhe disa lojtarë të rinj që të veshin fanellën e Kombëtares. Për është çdo herë nder mua është sikur të vi për herë të parë, ndaj jam i gëzuar që rikthehem sërisht në Kombëtare. Nuk duhet të vlerësojmë shumë miqësoret. Ne kemi reaguar gjithnjë kur kemi pasur probleme, kujtojmë këtu rastin pas humbjes së Luksemburgut. Duhet të reagojmë sa më parë, pasi nuk jemi Kombëtarja që kemi qenë dikur. Secili duhet të mbajë përgjegjësitë e tij. Kemi dhe lojtarë të rinj që trajneri ka dashur t'i provojë dhe mund të them se nuk ka qenë kombëtarja e plotë. Në Kombëtare vlen eksperiencia e gjithkujt jo vetëm e imja. Nuk është se vetëm një lojtar e ndryshon gjithë ekipin", u shpreh mesfushori.

Ai theksoi se kombëtarja ka ndryshuar shumë në raport me atë të Europianit dhe se lojtarë e rinj duhet të ndihmohen nga veteranët si ati, që të integrohen me skuadrën. "Ne jemi t'i gatshëm që t'i ndihmojmë. Do vijë një ditë që do largohemi nga Kombëtarja. E rëndësishme është që lojtarët të jenë gati të japin më të mirën e tyre në çdo moment për Kombëtaren. Jam i sigurt që edhe këtë herë do t'ia dalim. Shumica e lojtarëve nuk jemi në formë të mirë. Na duhet dhe pak fat e eksperiencë për të marrë një rezultat të mirë ndaj Izraelit", theksoi Basha.

Shkëndija nuk luan në kupë, ka 6 lojtarë me përfaqësueset



Shkëndija e Tetovës duhet të presë para se të nisë mbrojtjen e trofeut të Kupës së Maqedonisë. Ndashja me Kozhufin e Gjevgjeli, që ishte parashikuar të zhvillohej të mërkurën, është shtyrë për datën 12 shtator për arsye të thjeshtë se Shkëndija ka të përfshirë gjashtë futbollistë në eki-

pet përfaqësuese (Musliu dhe Bejtullai janë grumbulluar me Maqedoninë, Shefiti dhe Zjenullai me Shqipërinë U-21, Leard Sadriu me Kosovën U-21 dhe Ensar Luma me Maqedoninë U-19). Është hera e dyta që shtyhet kjo ndeshje, pasi fillimisht ishte përcaktuar të luhej me 22 gusht, por

për shkak të pjesëmarrjes së kuqezinjve në kupat e Europës kjo është e pamundur. Shtyrja për herë të dytë e takimit ka ndryshuar edhe planin stërvitor të Shkëndijës. Stafi teknik u ka dhënë futbollistëve dy ditë të lira, kështu që skuadra në stërvitje kthehet të enjten.

Challandes pret Shabanin e Hadërgjonajn te Kosova



Përzgjedhësi i Kosovës, Bernard Challandes, beson se Meritan Shabani dhe Florent Hadërgjonaj do të luajnë për Kosovën. Ai thotë se me të dy futbollistët ka kontakte të rregullta. Për Shabanin e Bayern Muenchenit është e interesuar edhe Shqipëria, kurse Hadërgjonaj priste një ftesë të Zvicrës për ndeshjet e këtij muaji, që nuk e mori. "Jam në kontakt me familjen e Meritan Shabanit. Me Shabanin shihen probleme me kombëtaren e Shqipërisë, por është familja e cila ka marrë një vendim. Kam biseduar me babanë dhe vëllanë e tij. Kemi

drekuar me ta dhe është përgatitur ardhja e tij. Do t'ia lëmë kohë që ai të përgatitet dhe të na bashkohet. Jam edhe me shumë lojtarë të tjerë në bisedime për të ardhmen e Kosovës. Jam edhe me Florent Hadërgjonajn. Ai ka pritur një ftesë nga përfaqësuesja e Zvicrës, por nuk e ka marrë atë ftesë. Dhe tani më mbetet nga ky moment të nisi punën intensive që ta bindi të na bashkohet në përfaqësuese. Kam qenë në kontakt edhe me menaxherin e tij Erdin Shaqirin. Po punojmë shumë ta kemi Hadërgjonajn", ka thënë Challandes.



Republika e Maqedonisë
Ministria e Financave

MFRM.PE.750.347/1



MINISTRIA E FINANCAVE

Ministria e Financave në bazë të nenit 22 paragrafi 1 alinea 2, paragrafi 3 dhe paragrafi 8 të Ligjit për të punësuarit në sektorin publik ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 27/14, 199/14, 27/16 dhe 35/18), neni 22 paragrafi 1 pika 1, neni 23, neni 24, neni 25, neni 26 dhe neni 27 të Ligjit për marrëdhënie pune ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 62/05, 106/08, 161/08, 114/09, 130/09, 50/10, 52/10, 124/10, 47/11, 11/12, 39/12, 13/13, 25/13, 170/13, 187/13, 113/14, 20/15, 33/15, 72/15, 129/15, 27/16 dhe 120/18) dhe Rregullores për sistematizim të vendeve të punës në Ministrinë e Financave, publikon:

SHPALLJE NUMËR 3/2018 PËR PUNËSIM NË MINISTRINË E FINANCAVE

I. Ministria e Financave publikon shpallje për punësim të 1 (një) personi për afat të caktuar kohor, për shkak të zmadhimit të përkohshëm të punës, për periudhë prej një viti, në vendin e punës në vijim edhe atë:

1. Këshilltar për analiza në lidhje me politikën doganore, Njësi për analiza, Sektori për politikë tatimore dhe doganore – (1 realizues)

Kualifikime të nevojshme:

- së paku 240 kredi sipas sistemit të ECTS ose të mbaruar shkallën VII/1 shkencat ekonomike, shkencat organizative dhe menaxhimi (menaxhment) ose shkencat juridike;
- së paku 3 vite përvojë pune në profesion;
- njohje aktive e programeve kompjuterike për punë në zyrë;
- njohje aktive të një nga gjuhët më të përdorura në Bashkimin Evropian (gjuhë angleze, gjuhë frengje, gjuhë gjermane);
- të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë;
- orari ditor i punës nga ora 7:30 dhe 8:30 deri në orën 15:30 dhe 16:30, orari javor i punës 40 orë – nga e hëna deri të premtën;
- paga neto 25.002,00 denarë.

Për vendin e shpallur të punës, kandidatët është e nevojshme ti posedojnë kompetencat e përgjithshme të punës në vijim:

- zgjidhjen e problemeve dhe vendimarrjen për çështje nga fushëveprimi i tij;
- mësim dhe zhvillim;
- komunikim;
- arritje të rezultateve;
- punim me të tjerët/ punë me ekip;
- ndërgjegjësime strategjik;
- orientim ndaj klientëve/ palë të prekura; dhe
- menaxhim financiar.

II Ministria e Financave publikon shpallje për punësim të 4 (katër) personave për afat të caktuar kohor, për punë në projekt, për periudhë prej 5 (pesë) vite, në vendet e punës në vijim edhe atë:

1. Edukator, Njësi projektuese për përkujdesje dhe edukim të fëmijëve të moshës parashkollore - Kopsht për fëmijë- (1 realizues);

Kualifikime të nevojshme:

- 240 kredi sipas sistemit të ECTS ose të mbaruar arsim të lartë shkalla VII/1 profesor i diplomuar i edukatës parashkollore, edukator i diplomuar për fëmijë të moshës parashkollore dhe pedagog i diplomuar për edukim parashkollor ose të mbaruar arsim sipëror përkatës për edukator;
- së paku 1 vitë përvojë pune në profesion;
- licencë të vlefshme për edukator;
- të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë;
- orari ditor i punës nga ora 7:30 dhe 8:30 deri në orën 15:30 dhe 16:30, orari javor i punës 40 orë – nga e hëna deri të premtën;
- paga neto 20.441,00 denarë.

2. Pedagog i diplomuar, Njësi projektuese për përkujdesje dhe edukim të fëmijëve të moshës parashkollore - Kopsht për fëmijë- (1 realizues);

Kualifikime të nevojshme:

- 240 kredi sipas sistemit të ECTS ose të mbaruar arsim të lartë shkalla VII/1 pedagog i diplomuar;
- së paku 1 vitë përvojë pune në profesion;
- licencë të vlefshme për punëtor profesional;
- të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë;
- orari ditor i punës 4 orë nga e hëna deri të premtën, respektivisht orar i shkurtuar i punës - 20 orë në javë;

- paga neto 10.220,00 denarë.

3. Psikolog i diplomuar, Njësi projektuese për përkujdesje dhe edukim të fëmijëve të moshës parashkollore - Kopsht për fëmijë- (1 realizues);

Kualifikime të nevojshme:

- 240 kredi sipas sistemit të ECTS ose të mbaruar arsim të lartë shkalla VII/1 psikolog i diplomuar;
- së paku 1 vitë përvojë pune në profesion;
- licencë të vlefshme për punëtor profesional;
- të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë;
- orari ditor i punës 4 orë nga e hëna deri të premtën, respektivisht orar i shkurtuar i punës - 20 orë në javë;
- paga neto 9.562,00 denarë.

4. Defektolog i diplomuar, Njësi projektuese për përkujdesje dhe edukim të fëmijëve të moshës parashkollore - Kopsht për fëmijë- (1 realizues);

Kualifikime të nevojshme:

- 240 kredi sipas sistemit të ECTS ose të mbaruar arsim të lartë shkalla VII/1 defektolog i diplomuar;
- së paku 1 vitë përvojë pune në profesion;
- licencë të vlefshme për punëtor profesional;
- të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë;
- orari ditor i punës 4 orë nga e hëna deri të premtën, respektivisht orar i shkurtuar i punës - 20 orë në javë;
- paga neto 9.562,00 denarë.

Kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë dëshmi për plotësimin e kushteve të cilat kërkohen për vendin e punës për të cilin aplikojnë,

përkatësisht: biografi të shkurtër – CV detyrimisht me kontaktin e telefonit dhe adresën; fotokopje nga dëshmia për nivelin e përfunduar të arsimit për vendin e punës që kërkohet; vërtetim nga Fondi për sigurim pensional dhe invalidor i RM-së (FSPI) si dëshmi për përvojën e kërkuar të punës (periudhë e evidentuar në Agjencinë për punësim si stazh pune); fotokopje të licencës përkatëse që kërkohet për vendin e punës; fotokopje të vërtetimit të nënshtrimit; fotokopje të dëshmisë për njohjen e një nga gjuhët më të përdorura në Bashkimin Evropian (gjuhë angleze, gjuhë frengje, gjuhë gjermane) dhe fotokopje të dëshmisë për njohjen e programeve kompjuterike për punë në zyrë.

Dokumentacioni i nevojshëm të dorëzohet në zarf të mbyllur në këtë adresë:

**Ministria e Financave
rr. Dame Gruev nr. 12, 1000 Shkup
(me emërim "për shpallje për punësim")**

Në zarf të shënohet numri i shpalljes dhe vendi i punës për të cilin aplikon, me vërejtje: "Mos hap". Afati për dorëzimin e dokumentacionit të nevojshëm është tre (3) ditë pune duke llogaritur ditën e publikimit të shpalljes në gazetën ditore.

Fletëparaqitja dhe dokumentacioni me vonesë, i paplotësuar dhe i pakompletuar nuk do të shqyrtohet.

Pas selektimit të fletëparaqitjeve, kandidatët të cilët kanë dokumentacion të rregullt do të thirren në intervistë në hapësirat e Ministrisë së Financave.

Ministria e Financave do të kryejë përzgjedhjen në afatin e përcaktuar në pajtim me nenin 23 paragrafi 2 të Ligjit për marrëdhënie pune.

Persona për kontakt:

Verica Stoilova – tel. 02/ 3255 619;
verica.stoilova@finance.gov.mk
Lilijana Stojanovska - tel. 02/ 3255 624;
lilijana.janevska@finance.gov.mk

Në bazë të nenit 8v të Vendimit për dhënie me qira të sallave dhe hapësirës tjetër numër 0201-89 të datës 31.1.2012, nr. 0202-1286 të datës 6.10.2016, Vendimit të dekanatit të sjellë në mbledhjen e mbajtur më 30.8.2018 numër 0202-796/2 të datës 30.8.2018, Komisioni publikon:

SHPALLJE

Për dhënie me qira të terminëve në sallë përmes ankandit publik

I. **Qiradhënës: Universiteti "Shën Kirili dhe Metodi" – Shkup, Fakulteti i edukatës fizike, sportit dhe shëndetit – Shkup, me seli në rr. "Dimçe Mirçev" nr. 3 – Shkup, tel 02 3 113 654 lok. 103.**

II. Lënda e qirasë përbëhet prej:

1 Dhënie me qira të sallës së fizkulturës Makedonski Heroi,

- për terminë prej ditës së hënë deri ditën e premtë në periudhë prej ora 17- 22, termini gjatë ditës së shtunë dhe të diel në periudhë prej ora 8 - 10 dhe prej ora 20 - 22 përcaktohet për 60 minuta, një orë. Çmimi fillestar për ankandin publik përcaktohet në shumë prej 1500.00 denarë për një termin prej 60 minutave,
- Për terminët prej ora 10 deri më 16, gjatë ditës së shtunë dhe të diel një termin prej dy orë për garë, çmimi fillestar për ankandin publik përcaktohet në shumë prej 2500.00 denarë
- Për terminët prej ora 16 deri në ora 20, një termin prej dy orëve, çmimi fillestar për ankandin publik përcaktohet në shumë prej 3000.00 denarë. Hapi minimal për rritje të vlerës për dhënie me qira është 10% nga çmimi fillestar për ankand.

2. Afati dhe kushtet të cilat duhet ti përmbushin pjesëmarrësit:

2.1. Shpallja zgjatë **15 ditë** nga dita e publikimit.

2.2 Të drejtë për pjesëmarrje në ankandin publik kanë të gjithë subjektet e interesuara juridike të cilët deri tek komisioni për ankand publik do të dorëzojnë dokumentacionin në vijim:

- Dokument për veprimtari të regjistruar, jo më të vjetër se 6 muaj;
- Vërtetim se nuk është hapur procedurë falimentimi, në origjinal ose kopje të vërtetuar në noter jo më të vjetër se 6 muaj
- Raport për bilancin e gjendjes dhe të dhënata nga bilanci i suksesit, në origjinal ose kopje të vërtetuar në noter jo më të vjetër se 6 muaj;
- Certifikatë për tatime dhe kontribute të paguara, në origjinal ose kopje të vërtetuar në noter jo më të vjetër se 6 muaj
- Fletëpagesë për depozitë të paguar.
- Klubet sportive duhet të dorëzojnë së bashku me fletëparaqitjen "Vendim për sport" të dhënë nga Agjencia për të rinj dhe sport si dhe gjendjen aktuale nga Regjistri qendror jo më të vjetër se 6 muaj nga dita e parashtrimit.

3. Dokumentacioni dorëzohet në zarf të mbyllur me shenjë "mos hap" dhe me shenjë "për shpallje për dhënie me qira të sallës" dhe numër të shpalljes, dhe dorëzohen përmes postës në adresën "Dimçe Mirçev" nr. 3 – Shkup, ose në arkivin e fakultetit. Ofertuesi që nuk ka dorëzuar dokumentet e nevojshme nuk do të ketë të drejtë të marr pjesë në ankandin publik. Dokumentet e dorëzuara në shpallje nuk do të kthehen.

4. Koha e fillimit të ankandit publik:

Ankandit publik për dhënie të terminëve në sallë e fizkulturës, do të mbahet më datë 21.9.2018 në ora 11⁰⁰, në lokalet e fakultetit me kohëzgjatje prej 30 minutave.

5. Depozitë

5.1 Depozita për pjesëmarrje në ankandin publik është **60.000,00** denarë që duhet të paguhet deri në ditën e përfundimit të shpalljes në xhirologarinë e Fakultetit me numër 160010309378818, shifra e të hyrave 723019, programi 41. Paga e realizuar pas kalimit të afatit do të konsiderohet si e vonuar dhe personat të cilët nuk kanë bërë pagesë në kohë në pajtim me afatin e caktuar nuk kanë drejtë të marrin pjesë në ankandin publik. Depozita për pjesëmarrje në ankandin publik nuk kthehet.

6. Mënyra e realizimit të ankandit publik dhe zgjedhja e ofertuesit më të volitshëm:

6.1. Ankandit publik mund të fillojë me së paku një pjesëmarrës i cili përmbushë kushtet e theksuara në shpallje dhe ofron çmimin fillestar. Pjesëmarrësi në ankandin publik i cili ofron çmimin më të lartë merr statusin e ofertuesit më të volitshëm.

7. Kohëzgjatja e qirasë:

7.1. Hapësira jepet me qira në periudhë prej një viti. Marrëveshja me ofertuesin më të volitshëm do të nënshkruhet në afat prej 8 ditëve nga vendimi përfundimtar për miratim të propozim listës. Nëse ofertuesi më i volitshëm nuk interesohet për të lidhur marrëveshjen, marrëveshje do të lidhet me ofertuesin me radhë në listë.

Fakulteti i edukatës fizike, sport dhe shëndet – Shkup Komisioni





THIRRJE PËR SHPREHJE TË INTERESIT TË FIRMAVE KONSULENTE

Projekti i USAID për integrim ndëretnik të rinjve në arsim ka nevojë për subjekte të licencuara dhe të regjistruara juridike për projektim, revizion dhe mbikëqyrje, nga sfera e ndërtimit, elektroteknikës dhe makinerisë për përpilimin e dokumentacionit teknik, revizion të dokumentacionit teknik dhe mbikëqyrje profesionale gjatë realizimit të pozicioneve të projektuara.

Për këtë arsye shpallim thirrje publike për paraqitje të firmave të licencuara konsultante për projektim, revizion dhe mbikëqyrje gjatë realizimit (për objekte shkollore), ndërsa që shfaqin interesim për punë me Projektet e USAID për integrim ndëretnik të rinjve në arsim të paraqiten dhe të parashtrorin dokumentacionin në vijim:

- Formulari 1 – Letër për shprehje të interesit për bashkëpunim
- Formulari 2 – Regjistër të firmave konsultante me informacionet në vijim:
 - Të dhëna relevante për firmën;
 - Licencat e firmave për projektim, revizion të dokumentacionit teknik dhe mbikëqyrje dhe
 - Biografi - CV-a dhe autorizime për konsulentë/inxhinierë të punësuar (arkitektë, të ndërtimit, elektro-inxhinierë dhe inxhinierë të makinerisë) nga domeni i projektimit, revizionit të dokumentacionit teknik dhe mbikëqyrje profesionale.

Formularët 1 dhe 2 mund t'i merrni në <http://mk.mcgo.org.mk/jobs-tenders/>
Të gjitha dokumentet duhet të parashtrihen deri në Projektin e USAID për integrim ndëretnik të rinjve në arsim, Komponenti 3 – Stimul për shkollat/Renovim të shkollave në adresën në vijim:
F. Postal 82, 1020 Karposh, Shkup
me shenjë "për firma konsultante"
Informacione shtesë mund të merrni në e-mailin në vijim: lstarova@mcgo.org.mk.
Thirrja është e hapur 15 ditë nga dita e publikimit në shtypin ditor.



UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

Njoftim

Universiteti i Evropës Juglindore shpall thirrje publike për sa vijon:

- **Thirrje publike numër 01/092018 – Renovim të konvikteve të studentëve**

Të gjithë të interesuarit mund të marrin informata më të hollëshme në:
www.seeu.edu.mk/sq/information/tenders

REPUBLIKA E MAQEDONISË
UNIVERSITETI "SHËN KIRILI DHE METODI" – SHKUP
FAKULTETI PËR MEDICINË VETERINARE
SHKUP



REPUBLIC OF MACEDONIA
UNIVERSITY "SS. CYRIL AND METHODIUS"
SKOPJE
FACULTY OF VETERINARY MEDICINE
SKOPJE

LAJMËRIM

Në pajtim me vendimin e Këshillit mësimor-shkencor të Fakultetit të medicinës veterinare në Shkup nr. 0202-1453/3 të datës 03.09.2018, informojmë se më datë **19.09.2018** (e mërkurë) me fillim në ora **11.00** në lokalet e Fakultetit të medicinës veterinare në Shkup, në mesonjëtorin nr. 2, Ivica Gjurovski, doktor i medicinës veterinare, publikisht do të mbrojë disertacionin e doktoratës me titull: "Analiza patohistologjike dhe imunohistokimike e antitropave në zorrën e trashë të mive me kolitit të shkaktuar dhe të trajtuar me simbiotik me mikroapsolla".

Dekan,
Prof. D-r Llazo Pendovski

PSE E ZGJODHA MAN UNITEDIN E JO MAN CITYN!

“Mendoj se ishte natën para se City ta transferonin Robinhon nga Real Madridi dhe agjenti im më tha: ‘Berba, edhe një klub tjetër të kërkon’. Unë i thashë: ‘do të shkojmë në Man United’, ndërsa ai më tha: ‘por, ata do të të japin më shumë para’”

Ish-sulmuesi i Manchester Unitedit, Dimitar Berbatov, ka bërë të ditur se ishte i interesuar vetëm për “Djajtë e kuq” pas interesimit të tyre, dhe se e kishte refuzuar një ofertë edhe më të mirë nga Manchester City.

Ish-trajneri i Manchester Unitedit, Alex Ferguson, e transferoi Berbatovin për 33.2 milionë euro nga Tottenhami në ditën e fundit të afatit kalimtar të verës në vitin 2008, por edhe rivalët e tyre të qytetit, Manchester City, kishin shprehur interesimin e tyre për sulmuesin. Megjithatë, Berbatovi ishte i interesuar vetëm për “Djajtë e kuq”, pasi që kishte qenë tifoz i këtij klubi që nga koha kur kishte qenë fëmijë.

“Nuk mendoj se transferimi



në City kishte qenë aq afër, që të jem i sinqertë. Agjenti im më tregoi për interesimin e tyre, por unë i thashë: ‘Mos më bezdis duke më treguar për klubet e tjera, unë do të shkoj në Manchester United, për shkak të historisë, lojtarëve, traditës dhe gjithçka tjetër’, ka thënë Berbatov. “Mendoj se ishte natën para se City ta transferonin Robinhon nga Real Madridi

dhe agjenti im më tha: ‘Berba, edhe një klub tjetër të kërkon’. Unë i thashë: ‘do të shkojmë në Man United’, ndërsa ai më tha: ‘por, ata do të të japin më shumë para’”.


“Nganjëherë, nuk janë të rëndësishme vetëm paratë. Unë nuk isha i interesuar për klubet e tjera. Për mua, ishte vendimi i duhur sepse të luaj për klubit më

të madh ishte ëndrra ime, veçanërisht kur vjen nga Evropa Jugore, nga një qytet i vogël, dhe askush tjetër nuk e ka bërë para teje. Ishte një ndjenjë e mrekullueshme”. Berbatovi e ka fituar titullin e Premierligës dy herë gjatë katër viteve që kishte luajtur për Manchester Unitedit, si dhe e kishte fituar “Këpucën e artë” në sezonin 2010/2011.



Mancini ngre alarmin tek të “kaltrit”

Pak ditë nga debutimi në Ligën e Kombeve, trajneri i Italisë Roberto Mancini i bëri thirrje klubeve që të aktivizojnë më shumë talentet e rritur në shtëpi. Përzgjedhësi i kombëtares së futbollit ngriti alarmin për lënien në hije të lojtarëve me potencial të madh, përballë fluksit të huajve në serinë A. Sipas tij, të dhënat tregojnë se kurrë më parë, lojtarët e moshave nuk kanë patur kaq pak minuta në klubet respektive.



Markizios zgjedh Zenitin e Shën Petërburgut

Klaudio Markizios është zyrtarisht një futbollist i Zenit të Shën Peterburgut në Rusi. Ish futbollisti i Juventusit, ka firmosur një kontratë 2-vjeçare me klubin nga Rusia. Ish Mesfushori bardhezi, prishi kontratën me “Zonjën e Vjetër” më 17 gusht për të vijuar karrierën jashtë Italisë. Lajmin e ka publikuar vetë klubi rus në faqen zyrtare. Markizios i ka pëlqyer projekti i Zenitit. Aktualisht Zeniti kryeson Premier Ligën ruse me 16 pikë të grumbulluara në 6 javë ndërsa do të marrë pjesë edhe në fazën e grupeve të Europa Ligë. Në këtë aventurë të re 32-vjeçari do të mbajë veshur fanellën me numër 10. Me Zenitin, Markizios do të përfitojë 3 milionë euro plus bonuset në sezon.

Mourinho pajtohet me 1 vit burg me kusht

Trajneri i Manchester Unitedit, Jose Mourinho, e ka pranuar dënimin me një vit burgim me kusht, në kuadër të një marrëveshjeje për pranimin e fajësisë me prokurorët spanjollë, pas akuzave për mashtrim tatimor. Trajneri portugez e ka pranuar dënimin me burgim gjashtë mujor për secilën nga dy krimet financiare që është akuzuar, pasi i ka pranuar shkeljet në kuadër të marrëveshjes me prokurorët, raporton gazeta e respektuar spanjolle “El Mundo”. Gjykata në Madrid, e cila e ka udhëhequr hetimin kriminal ndaj Mourinhos - Pozeulo de Alarcon Court Number Four - pritet të informohet për marrëveshjen në ditët në vazh-

dim. Gazeta spanjolle raporton se 55-vjeçari, e ardhmja e të cilit në Manchester United është në pikëpyetje pas fillimit zhgënjës këtë sezon, po ashtu është pajtuar ta paguajë një gjobë prej 1.98 milionë euro për 60% të shumës për të cilën i ka mashtruar autoritetet tatimore. Në Spanjë, personat që kryejnë krim për herë të parë nuk shërbejnë burg normalisht për dënime prej dy apo më pak vite—që nënkupton se Mourinho se dënimi me një vit burg që Mourinho e ka pranuar për dy pikat e aktakuzës për mashtrim tatimor më gjashtë do të suspendohet për një datë më vonë, pasi gjykata është informuar për situatën. Prokurorët e aku-



zojnë Mourinhon se ia ka borxh shtetit spanjoll mbi 2 milionë euro, të cilat s’i ka deklaruar për të drejtat e imazhit më 2011 dhe 2012, në kohën kur ishte trajneri i Real Madridit.

MESSI PËR RONALDON: Nuk e imagjinoja, Reali më i dobët pa të

Rrëfëhet Lionel Messi. Ylli i Barcelonës në një intervistë për “Catalunya Radio”, foli për herë të parë për largimin e Cristiano Ronaldos nga Reali i Madridit. Ylli argjentinas ka mbetur shumë i surprizuar nga vendimi i luzitanit për t’u larguar nga Los Blancos dhe për të zgjedhur pikërisht Juventusin. “Më habiti, nuk e imagjinoja dot të ikte nga Reali i Madridit, apo më pak të shkante te Juventus, pasi kishin

kaq shumë ekipe që e donin. Nëse Reali është një nga skuadrat më të mira në botë, është e qartë se me mungesën e Ronaldos, kjo i bën ata më pak të mirë, dhe tani, kjo e bën Juven favorite për të fituar në Champions”, deklaroi Messi. Ai përshkroi edhe ndjesinë e të mbajtur shiritin e kapitenit në krah të Barcelona dhe përse ka vendosur të qëndrojë gjithmonë te blaugranat. “Për mua është krenari që të jem kapi-

ten i Barcelonës për gjithçka që do të thotë. Mënyra ime e veprimit nuk do të ndryshojë fare dhe jashtë fushës, unë kam qenë tashmë një kapiten pak kohë më parë, por jo si kapiten i parë. Kam gjithçka këtu. Kam qenë në Barcelonë që 13 vjeç, te skuadra më e mirë në botë, dhe një nga qytetet më të mira në botë. Fëmijët e mi kanë lindur këtu, dhe nuk kam pse të shkoj diku tjetër”, shtoi Messi.



FILLIMI I FUNDIT I MURINJOS?



Gjatë përballjes së Manchester United me Burnley-n këtë të diel, menaxheri Jose Mourinho ishte nën trysni më të madhe se kurrë. Pas humbjeve të njëpasnjëshme nga Brighton e Tottenham, e sidomos kundër këtyre të fundit, që me fitoren 0-3 i dhanë Murinjos humbjen më të thellë në shtëpi për të gjithë karrierën, dhe shtatë golat e pësuar në tre ndeshjet e këtij sezoni, ai do të kishte qenë po njësoj i ekspozuar ndaj kritikave, edhe pa ligjëratën plot emocione që erdhi pas humbjes me Spurs. Mourinho këmbënguli në një konferencë për shtyp të mbajtur këtë të premte se ai mbetet një nga menaxherët më të mirë në botë, por BBC Sports bëri një vlerësim të situatës së 55-vjeçarit.

CILA ËSHTË SITUATA NË OLD TRAFFORD?

Eparë nga jashtë, duket kaotike dhe e çorientuar. Megjithatë, burime nga brenda Old Trafford këmbëngulin se realiteti është më i qetë. Kjo mund të jetë e vërtetë, por burime të tjera e kanë përshkruar atmosferën në dhomën e zhvishjeve si të zymtë. Kjo gjë pritet pas humbjeve të njëpasnjëshme, sidomos humbjes 3-0 në shtëpi kundër një prej rivalëve më të mëdhenj.

Por më shqetësuese janë deklaratat nga burimet e sigurta, që thonë se askush nuk dëshiron të mbajë përgjegjësi për situatën në të cilën klubi gjendet tani; që lojtarët janë të çorientuar nga zgjedhjet e gabuara të Murinjos, si dhe që disa nuk kanë dëshirë të luajnë për këtë menaxher në plan afatgjatë.

POZVILLOHET NDNJË LUFTË PËR PUSHETET?

Nëse po, Hoze Mourinho do ta humbasë. Zëvendësudrejtori ekzekutiv, Ed Uduard, është përgjegjës për menaxhimin e përditshëm të Old

Trafford. Po ashtu, ai komunikon çdo ditë me pronarët e klubit, familjen Glazer. Duke qenë përgjegjësi kryesor për kalimin e pronësisë së plotë të Manchesterit te familja Glazier, në vitin 2005, ai ka fituar besimin e plotë të familjes e cilajeton në Florida e që qëndron larg vëmendjes së mediave. Është e pamendueshme që ata të zgjedhin Murinjon para atij.

Murinjoja e di këtë. Megjithatë, kanë ide të ndryshme për sa i përket strategjisë për formimin e skuadrës. Murinjoja do të konkurrojë tani dhe mendon se lojtarët cilësorë, me shumë përvojë, janë mënyra e saktë që duhet të ndiqet. United ose nuk mundet, ose nuk do ta financojë një projekt të tillë. Sidomos kur nuk kanë garanci për sukses. Figura të njohura të klubit besojnë se duhet të ndërtohet një farë ndryshimi, dhe që duhet të përfshijë zhvillimin e lojtarëve të rinj.

A OFRON ZGJIDHJE MURINJO?

Shkurt, nëse përgjigjja është që të vendoset Ander Herrera si qendërmbrojtës, siç bëri Murinjoja kundër Tottenhamit, atëherë mund të themi se në këtë rast po bëhen pyetjet e gabuara. Pas mposhtjes 3-0, portugezi tha që nuk e dinte se cila ishte dyshja më e mirë për qendërmbrojtjen. Është gjë shumë e rëndë, meqenëse tani është në sezonin e tretë, dhe ai është përgjegjës për blerjen Eric Baillyt dhe Victor Lindelof, si dy prej pesë mundësive që kishte për të zgjedhur. Ka pasur sugjerime që Murinjoja mund të ketë qenë duke luajtur lojëra, për t'i treguar Uduardit se pse kishte pasur të drejtë të kërkonte përforsime në mbrojtje, të cilat, për arsye të ndryshme, nuk

Pak janë vëzhguesit me përvojë të United që mund ta mbrojnë Murinjon që tani, në fillim të sezonit tjetër, jo më deri në vitin 2021, kur i mbaron kontrata që u nënshkrua këtë janar. Disa shohin pikëpamjen apokaliptike, e thonë që situata është bërë aq negative, aq helmatisëse, sa ndeshja në Burnley mund të ketë qenë e fundit e Murinjos, dhe që duartrokitja e zgjatur në Streford End, pas mposhtjes së të hënës, mund të jetë lamtumira e tij në Old Trafford

i erdhën. Nëse është e vërtetë, kjo do të ishte një strategji e rrezikshme në nivel ekstrem. Akuzat e tjera të hedhura herë pas here kundër Murinjos janë që ai nuk i zhvillon lojtarët, as nuk u jep besim të rinjve. Kur United kishte nevojë të dëshpëruar për një gol të hënën, sulmuesi i Anglisë, Marcus Rashford, u mbajt në stol ndërsa Marouane Fellaini jo. Kjo gjë u pa si negative. Megjithatë, kjo bën që të mos shihet përmirësimi domethënës i bërë në Murinjon nga Xhesi Lingard.

DHESI E ANALIZONI KTHIMIN E LUKE SHOUT TE EKUPI I ANGLISË?

Shou ka qenë disa herë në qendër të akuzave të Murinjos në dy vitet e fundit. Megjithatë, tani po luan me një nivel që s'e ka pasur as kur erdhi nga Southampton, në vitin 2014. A është kjo një përgjigje ndaj "dashurisë së ashpër" të menaxherit? Apo është thjesht rastësi?

ATËHERË? A ËSHTË KY FUNDI I LOJËS SË MURINJOS?

Pak janë vëzhguesit me përvojë të United që mund ta mbrojnë Murinjon që tani, në fillim të sezonit tjetër, jo më deri në vitin 2021, kur i mbaron kontrata që u nënshkrua këtë janar. Disa shohin pikëpamjen apokaliptike, e thonë që situata është bërë aq negative, aq helmatisëse, sa ndeshja në Burnley mund të ketë qenë e fundit e Murinjos, dhe që duartrokitja e zgjatur në Streford End, pas mposhtjes së të hënës, mund të jetë lamtumira e tij në Old Trafford. Ky nuk është vlerësimi i bërë nga njerëz në klub, prej ku burimet thonë se bordi ka ende besim se Murinjoja mund ta ndryshojë situatën.

As familja Glazer, as Uduard nuk reagan që me shenjat e para të telasheve, kur në krye ishin David Moyes dhe Louis van Gaal. Kështu

që pak gjasa ka që të ndodhë tani. Megjithatë, një humbje e tretë e Premier League, diçka që nuk ndodhte që nga Dhjetori 2015, do të sillte një vëmendje të paimagjinueshme mbi Murinjon dhe Uduardin, dhe do t'i çonte drejt një ndarjeje ndërkombëtare, duke e lënë United të dergjej në mënyrë të sikletshme në zonën e ftohtë.

POCILI ËSHTË ROLI I ANTONI MARTIAL NË GJITHË KËTË?

Murinjoja ishte dakord ta linte Antoni Martialin të largohej nëse këtë verë i vinte një ofertë e mirë. Shefi i United beson se Martial shkon dem në ndeshjet e mëdha, dhe në një botë ideale Murinjoja do të kishte marrë Uillianin e Çelsit, apo Perisiçin e Interit në vendin e tij. Megjithatë, Uilliani është 30 vjeç dhe Perisiçi 29. Çmimi për secilin prej tyre këtë verë do të ketë qenë më shumë se 60 milionë paundë. Ndryshe nga ata, Martiali është 22 vjeç. Tottenham shfaqti interes ta merrte, por do t'u duhej të kthenin 36 milionë paundët që paguan për të në vitin 2015. Uduardi i bllokoi këto dhe këtë javë u mësua që United po negocionjë me francezin për një kontratë pesë-vjeçare. Por, burime nga united thonë që thjesht po mbrojnë interesat financiare?

Ata thonë që Murinjoja është mbajtur i informuar për situatën, duke lënë të kuptohet se deri tani nuk është rënë dakord për asgjë, dhe edhe sikur të kishin rënë dakord, nuk do të thotë që Martial mund të shitet. Megjithatë, teksa Martialit i kanë mbetur dy vite në kontratë dhe zgjatja e saj do t'ia dobësonte pozitën për blerje me klube të mira, kjo duket më shumë si shprehje e qëllimeve për planet në të ardhmen, gjë që, edhe një herë, do të ishte në rrezik me perspektivën e tanishme që ka Murinjoja. (BBC)



Koha, e mërkurë, 5 shtator 2018



DASHI 21. mars - 20. prill

Një ditë jo fort e mirë kjo për të lindurit e kësaj shenje pasi partneri/ja juaj do të jetë shumë i irrituar sot. Bëni sa të mundni për t'i qetësuar. Beqarët duhet të jenë të duruar nëse duan të gjejnë personin e përshtatshëm. Në planin financiar gjërat do shkojnë mirë sipas parashikimit të yjeve.



DEMI 21. prill - 21. maj

Shijojeni këtë ditë të hënë. Do të jetë e mbushur me komunikime të këndshme dhe të dobishme për ju që jeni në një marrëdhënie. Koha është e shenjtë për ju. Beqarët do e kalojnë jetën sentimentale në plan të dytë. Financat do jenë mjaft delikate.



BINJAKET 22. maj - 21. qershor

Mundësi të reja do t'ju japin shansin të dilni nga "rutina" në të cilën jeni zhytur ju të dashuruarit. Mos prisni shumë prej të tjerëve, por organizohuni dhe relaksohuni. Beqarët do kenë një ditë të ndërlikuar dhe nuk do mendojnë për dashurinë. Buxheti nuk do jetë i kënaqshëm gjatë kësaj periudhe.



GAFORRJA 22. qershor - 22. korrik

Një ditë e mirë për juve. Marrëdhënia me partnerin/en do të vazhdojë të bëhet gjithnjë e më e ngrohtë. Është një ditë e mirë për të përfunduar punët e lëna përgjysmë. Beqarët do jenë joshës, prandaj do arrijnë ta bëjnë për vete cilindo person që do pëlqejnë. Financat nuk do jenë mirë.



LUANI 23. korrik - 22. gusht

Do të ndiheni shumë të frymëzuar sot i cili do të vihet në plan të parë të ditës. Pavarësisht sesa shumë punë keni për të bërë, do të gjeni kohë edhe për partnerin/en. Beqarët do i japin prioritet absolut jetës sentimentale dhe do afrohen mjaft me një person fantastik. Në planin financiar fati do jetë në anën tuaj.



VIRGJERESHA 23. gusht - 23. shtator

Një ditë me ulje dhe ngritje kjo e sotmja. Pavarësisht se do të prireni drejt vetmisë sot, nuk do të ndiheni shumë të rënë moralisht. Megjithatë sot është një ditë e mirë për ta kaluar me njeriun e zemrës. Beqarët do kenë ndryshime drastike të statusit dhe takime të veçanta. Financat do jenë në ditë të mirë.



PESHORJA 24. shtator - 23. tetor

Ju jeni mjaft dyshues por ju këshillojmë që t'i lini mënjanë dyshimet. Përfitoni nga dëshira juaj për të planifikuar gjithçka dhe kthejeni gjërat lidhur me partnerin/en në avantazhin tuaj. Beqarët do realizojnë takime të veçanta, por nuk do ndihen gati për lidhje. Gjendja e financave do jetë e mirë.



AKREPI 24. tetor - 22. nëntor

Tregohuni të kujdesshëm dhe të vëmendshëm ndaj partnerit/es suaj sot. Mbani mend faktet interesante që t'i përdorni. Beqarët nuk duhet të kenë frikë të fillojnë një lidhje. Buxheti për fat të mirë do fillojë të stabilizohet.



SHIGJETARI 23. nëntor - 21. dhjetor

Sot ndiheni shumë joshës dhe në humor të mirë. Personi i zemrës mund t'ju kushtojë vëmendje të veçantë dhe kjo do t'ju pëlqejë shumë. Beqarët do arrijnë të afrohen me personin që pëlqejnë dhe do ja shprehin ndjenjat. Në planin financiar gjërat do jenë të ekuilibruara.



BRICJAPI 22. dhjetor - 20. janar

Dashuria dhe martesja janë në mendjen tuaj prej disa kohësh për ju që jeni në një marrëdhënie. Kujdesuni që të nxirrni në pah virtetet tuaja. Beqarët do kenë mundësi të reja për të krijuar lidhje. Në planin financiar do dini si ti menaxhoni të ardhurat.



UJORI 21. janar - 19. shkurt

Një ditë mjaft e mirë. Po ndiheni shumë mirë, veçanërisht të shëndetshëm, energjik dhe tërheqës ju të dashuruarit. Partneri/ja do t'jua bëjë ditën shumë të këndshme. Beqarët duhet të tregohen më të duruar në mënyrë që te gjejnë personin më të mirë për ta. Kujdes financat.



PESHQIT 20. shkurt - 20. mars

Sot do të kaloni një ditë të mirë, sidomos në çift. Ngrohtësia juaj e natyrshme për partnerin/en do të jetë më se e dukshme gjatë kësaj të hëne. Shijojeni sa më shumë ditën. Beqarët duhet të jenë gati dhe të kujdesshëm pasi rrethohen nga persona mjaft interesante. Në planin financiar gjërat nuk duken edhe aq mirë por ju do të keni ndihmë.

shumë i lehtë

4	5				6	7	2
	3				9	8	
			5		1		
9	7	3			6		
		1			2	5	3
			3	4			
	8		7			3	
3	9		1			2	8

PËRKUJTIM



Nazife Abdiji
21.03.1948-05.09.2017

Kalo një vit që ty u largove nga kjo botë dhe ne të kujtojmë me mall. Muajt dhe vitet kalojnë por dashuria dhe mungesa për ty nuk shuhet, ajo shtohet çdo ditë shumë e më shumë. Na mungon prania jote, por gjithmonë do të mbetesh në zemrat tona.

**U presh në parajsë e shtrenjta Nëna e jonë!
E përkujton me mall familja Abdiji-Bogovinë**

KOHA	ARTISTJA SHQIPTARE NË FOTO	PISTË AEROPLANESH (SH)	SHABLLON, KLIGHE	KOHA	TITULLI QË IA DHA KONGRESI AMERIKAN ARTISTES SONË	ZYRTAR QË INSPEKTON VEPRIMTARI (SH)	NË TV ITALIAN
MASOIVE				AKTORI AMERIKAN RIÇARD			
SINDROMI DËMSHËM NEUROLOGJIK				RIBONUCLEIC ACID			
NËSI PËR NATJEN E VIDEO SINAULEVE				BUNARI			
GRUP KËNGËTARËSH				P			
ADOBE DIGITAL EDITIONS				ACCELERATED PROCESSING UNIT			
RAPERI GJERMAN KARLO VAGBEL	ZOTI KRYESOR SIPAS MITOLOGJISË NORDIKE	SHKRONJË GREKE	ZBULIME, KRUMJE	SH	ITALIA	LLOJ PALLTOJE SOUTH DAKOTA	
PJESË E LËVIZSHME E MOTORIT			LËSHON ZË TË LARTË KËNGËT ITALIAN, FILIPO NEVANI				SHKRYMTARI NË RILINDAS, DELVINA
NISËSHTËJA				FOTOMODELLJA AMER. ADRI			
ISH PORTJERI GJERMAN MAJER (SHQ.)			ISH (HUAJ) HEROI 'BJESHËVE TË NEMURAJ'			MONEDHA TURKE TEZGAJH (SHQ.)	
DD	DOKUMENTARI I ARTISTES NË FOTO JO ZGJATJE						
IMPULSI	ELEGANT DRAMË E ARTISTES NË FOTO		MURGUJ I KRISHTERË LLOJ GURI TË ÇMUESHËM				
I BIE NË SGEPT ÇUKIT		AD ACTA. ISH VOZITËSI AUSTRIAK, NIKI		UNI (SH)			KALIMI QYTET NË FRANCË
LUOHESË			NORMATË SË DREJTËS ZAKONORE GJERMANA				OKSIGJENI QYTET NË GRECI AKTORI DHE REGJISORI FRANCEZ, ZHAK
KOHA	ZAKONI LUKRECI					NËSI METRIKE NË MUZIKË NGYRË QIELLI TË MBYLLUR	
TATUAZH			POSEDON LUMË NË AUSTRI			QYTET NË TURQI UNITED KINGDOM	
NË ELEMENT KIMIK (R)				NË LLOJË BOKHODI (SH) NË ROMAK			
SHAKISTI HOLANDEZ, JAN (SHQ.)					PRATI		

ZGJIDHJET: MAS, GIR, RET, RNA, IRE, PUSI, KOR, APU, ADE, IEN, KRO, SH, SAKO, ROTOR, PISKET, AMIDONI, DEVON, SEPI, EKS, LIRA, NT, NUK JE, VETËM, I, SHIK, EREMITI, QUK, AA, EGO, TK, ISHULL, KANUN, O, TRADITIA, TAKT, TATU, KA, BURSA, IRIDI, RUFLETET, TIMANI, KUSARI.

“KAM VETËM PAK DITË JETË...” PREZANTUESJA E LAJMEVE JEP LAJMIN E HIDHUR

Prezantuesja e lajmeve në BBC Radio 5 Live, Rachel Bland, e cila ka kancer të pakurueshëm, zbuloi në rrjetet sociale se ka vetëm pak ditë jetë. 40-vjeçarja u diagnostikua me kancer gjiri në Nëntor të 2016-s. Muajin e shkuar ajo tha se ishte në luftë me kohën për të publikuar një libër kujtimesh për djalin e saj 2 vjeç, Freddie dhe se besonte se kishte “më pak se një vit” jetë. Prezantuesja drejton programin radiofonik “You, Me and the Big C”, sëbashku me Deborah James



dhe Lauren Mahon. Në një postim në Twitter të hënën, 40-vjeçarja tha se dyshja do të vijonte drejtimin e programit.



“Kam frikë se koha ime ka ardhur miqtë e mi. Dhe krejt papritur. Kam vetëm pak ditë jetë, është vërtetë surreale. Faleminderit shumë për të gjithë mbështetjen që më keni dhënë”, shkroi Bland. Lajmin e hidhur e përcolli edhe vetë BBC në një shkrim të botuar këtë të hënë.



Pse femrat bëjnë gjumë më të keq se meshkujt?!

Mënyra se si jetojmë ka ndryshime mes meshkujve dhe femrave. Dallimet janë shumëplanëshe dhe një prej tyre është edhe tek gjumi. Hulumtuesit kanë zbuluar se femrat përgjithësisht bëjnë gjumë më të keq se meshkujt. Sociologët Ruppner Lea dhe David J. Maume kanë arritur në konkluzionin se meshkujt dhe femrat e përfuturojnë në mënyrë të ndryshme edhe momentin e pushimit. Çrregullimet në gjumë përfuturohen ndryshe në varësi të seksit që njerëzit i përkasin sipas sociologëve. Femrat zakonisht bëjnë gjumë më të keq se meshkujt të cilët nga ana e tyre, e shohin gjumin si “ilaç” për të “shëruar” lodhjen e për të qenë gati për punë ditën tjetër. Ndërkohë, gratë kanë detyrimet e tyre edhe natën kur duhet të kujdesen për fëmijët. Përfundimisht, gratë kanë stresin e detyrimeve familjare gjatë gjithë kohës, e kjo nuk i lë ato të bëjnë gjumë të qetë. Por, sociologët kanë arritur në konkluzionin se ky fenomen i gjumit te gratë po shkon drejt zbutjes te shoqëritë më të emancipuar. Cilësia e gjumit përmirësohet me kushtin që koncepti i barazisë gjinore të njohë zhvillime të mëtejshme.

Edhe uji mund të shkaktojë vdekje, duhet ta dini

Uji është një ndër elementët kryesorë jetësorë, pa të cilin asgjë nuk do të ekzistonte. Po, mjekët paralajmërojnë se uji mund të jetë i rrezikshëm për shëndetin e njeriut. Por ka raste kur pirja e tepërt e ujit mund të jetë vdekjeprurëse. Kur kjo ndodh, uji rrjedh nga gjaku në inde dhe qeliza të tjera. Organi kryesor i prekur nga kjo është truri. Ai enjtit ndjeshëm dhe njeriu bëhet konfuz, ka dhimbje koke dhe të përziera. Deri më tani, disa dhjetëra persona kanë humbur jetën nga intoksikimi i ujit. Të gjithë prej tyre janë sportistë që merren kryesisht me vrap. Njerëz të tjerë të rrezikuar nga intoksikimi i ujit janë ata që marrin barna për urinimin dhe ata që vuajnë nga veshkat. Ekspertët thonë se ata që merren me aktivitetet



fizik siç është vrap, ecja e shpejtë e të tjera si këto, duhet të pinë ujë me elektrolite ose të konsumojnë kripë.

Agjencia daneze RITZAU aktivizon robotët gazetarë

Agjencia e lajmeve Ritzau nga Danimarka dhe gazetaret lokale kanë zhvilluar një robot sportiv i cili shkruan raportet e përpunuara pas çdo loje lokale. Raportet përshtaten ashtu që njëri i drejtohet ekipit nikoqir, ndërsa tjetri ekipit mysafir. Ritzau ka publikuar se si shërbimi është hapi i rëndësishëm për zhvillimin e mëturjes së agjencisë në gazetarinë robotike. Më herët agjencia e ka nisur shërbimin e financave të

robotit nën emrin Autoflash. Drejtori për zhvillim Kristoffer Gravgaard ka deklaruar se agjencia pret reagimet nga lexuesit. “Sporti lokal është i rëndësishëm, por është misioni i pamundur të mbulohej të gjitha ekipet me përcjellje të gazetarëve. Andaj jemi të kënaqur me këtë zgjidhje me robotin dhe dëshirojmë të shohim se si lexuesit tanë e pranojnë këtë shërbim”, ka thënë kryeredaktori Lars Jespersen për gazetën Nordjyske.



70 - Ushtria romake nën udhëheqjen e Titusit okupon dhe plaçkit Jerusalemin.

1497 - Lundruesi Perkin Warbeck shpallet Mbret Riçardi IV i Anglisë.

1652 - Beteja e Monte Christo-s: Flota holandeze në krye me J van Galen mund flotën angleze.

1701 - Gjermania, Anglia dhe Holanda nënshkruajnë marrëveshje kundër Francës.

1813 - Përdoret për herë të parë shenja "Uncle Sam" në SHBA.

1822 - Brazili shpall pavarësinë nga Portugalia (Dita Kombëtare).

1923 - Formohet Interpol-i në Vjenë.

1940 - Traktati i Krajovës: Bullgaria merr Dobrudhën Jugore nga Rumania humb.

1947 - Beteja mes Hindusëve dhe myslimanëve në New Delhi.

1950 - Mbyllet manastiret në Hungari.

1977 - Etiopia ndërpret marrëdhëniet diplomatike me Somalinë.

2005 - Mbahen zgjedhjet e para presidenciale në Egjipt.

Çaji që ndihmon në trajtimin e kancerit

Për një kohë të gjatë është njohur për përfitimet shëndetësore që ofron, madje edhe për ndihmesën që jep në humbje të peshës. Tani çaji i gjelbër japonez (matcha) mund të përdoret edhe për trajtimin e kancerit, kjo sipas studimeve të realizuara së fundmi. Testimet në laborator kanë treguar se ky çaj mund t'i mbajë qelizat e kancerit “në gjumë”, duke ua ndërprerë furnizimin me energji. Hulumtuesit nga Universiteti Salford i kanë quajtur këto gjetje tejet të rëndësishme, përdërisa shkencëtarët ende janë në kërkim të një kure për kancer.



BURRI I TURPËRUAR

Burri i ankohet gruas sapo hyn në shtëpi: - U turpërova keq fare sot grua!

-Pse, çfarë të ndodhi?, pyet gruaja - Me futi njëri dorën sot në xhep në autobus dhe nuk me gjeti kokërr denari!



Kurrë mos i ndaj hallet e tua me të tjerët. 20% të tyre as nuk u bëhet vonë, dhe 80%-shi tjetër është i kënaqur që i ke ato halle! (Lou Holtz)



KALENDARI HISTORIK 5 SHTATOR



A E DINI SE...



BARSOLETA



THËNIA E DITËS